



AGJENCIA E SIGURIMIT TË CILËSISË NË ARSIMIN E LARTË

RAPORTI I VLERËSIMIT TË JASHTËM

Programi i Studimit të Ciklit të Parë Bachelor në:

“Shkenca të Rehabilitimit”

Universiteti i Sporteve të Tiranës

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm:

Prof. Asoc. Irena Kola

Prof. Asoc. Enkelejd Mëhilli

Shtator / 2023

TABELA PËRMBLEDHËSE E TË DHËNAVE TË PROGRAMIT TË STUDIMIT**Bachelor në "Shkenca të Rehabilitimit"**

1	IAL aplikues:	Universiteti i Sporteve të Tiranës
2	Njësia bazë që e ofron:	Departamenti i Shkencave Biomjekësore dhe Humane
3	Emërtimi i programit të studimit:	Bachelor në "Shkenca të Rehabilitimit"
4	Urdhëri/VKM i licencimit:	Urdhër MASR, Nr. 245 datë 22.07.2020
5	Urdhëri/VKM i riorganizimit:	-
6	Forma e regjistrimit të diplomës:	-
7	Urdhëri/VBA i akreditimit të parë:	-
8	Cikli i studimit:	Cikli i parë
9	Kohëzgjatja e programit të studimit:	3 vite
10	Kreditet në total (ECTS):	180 kredite
11	Forma e studimit:	Kohë të plotë
12	Gjuha (shqip/tjetër):	Shqipe
13	Programi ofrohet në bashkëpunim me institucione të tjera:	Jo
14	Diplomë e përbashkët (shëno emërtimin):	Jo
15	Diplomë e dyfishtë (shëno emërtimin):	Jo
16	Niveli në kornizën kombëtare të kualifikimeve:	Niveli 6
17	Stafi akademik PAE/PAK për programin e studimit:	21 PAE / 5 PAK Bazuar në ngarkesën mësimore rezulton: 95 % PAE / 5 % PAK
18	Numri i studentëve:	2020-2021; 24 studentë; 2021-2022; 83 studentë; 2022-2023; 78 studentë;
19	Komente / të tjera:	




PËRMBLEDHJE E TË DHËNAVE PËR PROGRAMIN NË PROCES TË VLERËSIMIT TË JASHTËM

Universiteti i Sporteve, Tiranë është një Institucion publik i Arsimit të Lartë i krijuar me VKM Nr. 123 Prot. datë 17.02.2010 dhe i akredituar me VBA Nr. 2, datë 07.01.2022. Ky Universitet është hapur bazuar në Akademinë e Edukimit Fizik dhe Sporteve “Vojo Kushi” që prej vitit 1960. Dega e Edukimit Fizik ku ky Institucion ka zanafillën vjen që prej vitit 1958 bazuar në Institutin e “Histori Filologjisë”. Vendimi Nr. 57, datë 29.1.2020 “PËR DHËNIEN E STATUSIT TË VEÇANTË UNIVERSITETIT TË SPORTEVE TË TIRANËS SI INSTITUCIONI I VETËM PUBLIK I ARSIMIT TË LARTË NË FUSHËN E SPORTIT NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË” i jep status të veçantë këtij institucioni. Fakulteti i Shkencave të Rehabilitimit është hapur me urdhërin Nr. 495, datë 11.10.2019 të Ministrit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë. Programi i studimit Bachelor në “Shkenca të Rehabilitimit” është hapur me Urdhër të MAS Nr 245 datë 22.7.2020. Ky program studimi kalon procesin e akreditimit për herë të parë, ndërsa Institucioni është i akredituar nga ASCAL për një periudhë 6 (gjashtë) vjeçare deri më 06/01/2028. Fakulteti i Shkencave të Rehabilitimit ka në përbërje të vet tre departamente:

1. Departamenti i Shkencave Biomjekësore dhe Humane;
2. Departamenti i Kineziologjisë;
3. Departamenti i Rehabilitimit;

Departamenti i Shkencave Biomjekësore dhe Humane i cili ofron programin e studimit Bachelor në “Shkenca të Rehabilitimit” në vitin aktual ka në përbërjen e vet 7 personel akademik efektiv (PAE), nga ku: 3 Doktor Shkencash, dhe 4 me Master Shkencor, ndërsa numri i personelit akademik me kontratë (PAK) është 3 nga ku: 2 Doktor Shkencash dhe 1 me Master Shkencor. Programi i studimit ofrohet sipas Sistemit European të Transferimit të Krediteve (ECTS) dhe për të fituar këtë diplomë duhen 180 kredite (ECTS). Kohëzgjatja e studimeve është 3 vite akademik dhe forma e studimit është me kohë të plotë. Programi i studimit Bachelor në “Shkenca të Rehabilitimit” është në përputhje me Ligjin e Arsimit të Lartë 80/2015 si dhe aktet nënligjore.



PËRSHKRIMI I PROCESIT TË VLERËSIMIT TË JASHTËM;

Procesi i vlerësimit të jashtëm për akreditimin e programit të studimit Bachelor në “Shkenca të Rehabilitimit” ofrohet nga Departamenti i Shkencave Biomjekësore dhe Humane, Fakulteti i Shkencave të Rehabilitimit në Universitetin e Sporteve të Tiranës, filloi me marrjen e dokumentacionit të ofruar nga institucioni, si dhe ndarjen e punës për përgatitjen e pyetjeve dhe kërkesave për dokumentacion shtesë. ASCAL bazuar në “Manualin për Procedurat dhe Afatet për Vlerësimin e Cilësisë në kuadër të Akreditimit të Institucioneve të Arsimit të Lartë dhe programeve të studimit 2017”, ka përzgjedhur dy vlerësues të jashtëm për të shqyrtuar dokumentacionin e përcjellë nga Universiteti i Sporteve, për të kryer vizitën në institucion dhe për të përpiluar raportin e vlerësimit të jashtëm.

Në kuadër të procesit të vlerësimit të jashtëm është përgatitur agjenda nga ASCAL dhe është kryer vizita në datat 7-8 Qershor 2023. Dy ekspertët e përzgjedhur shoqëroheshin nga një specialist i ASCAL. Grupi i vlerësimit të jashtëm ka në përbërje Prof.As. Irena Kola dhe Prof.As. Enkelejd Mëhilli. Gjatë gjithë fazës së vlerësimit të jashtëm, ky grup pune u asistua edhe nga Koordinatorja Teknike e ASCAL, Znj. Majlinda Demirneli.

Bazuar në agjendën e përgatitur nga ASCAL u zhvilluan takimet me Drejtuesin e Njesisë Kryesore dhe të Njesisë Bazë, grupin e vlerësimit të brendshëm, anëtarë të stafit akademik dhe studentët. Duke patur parasysh që GVB si dhe stafi akademik ishin të njëjtit persona u vendos që të zhvillohej një takim dhe jo dy të ndryshëm. Paralelisht, u zhvillua vizita në sekretarinë mësimore si dhe në ambientet e Fakultetit. Gjatë vizitës në Fakultet u panë klasa, laboratorë të ndryshëm si dhe biblioteka. Kohëzgjatja e takimeve ishte ajo e parashikuara. Me qëllim përmbylljen e takimeve brenda një dite në agjendë kishte disa ndryshime ndërsa takimet u përfunduan përtej orës së parashikuar.

GVJ zhvilloi takime me përfaqësues të Drejtorisë së Burimeve Njerëzore, Arkiv/Protokollit ku diskutoi mbi çështje të ndryshme ndërsa më pas zhvilloi një takim ku merrnin pjesë përfaqësues të Drejtorisë Juridike dhe i Zhvillimit të Kurrikulave, dhe përfaqësues të Drejtorisë së Marrëdhënieve me Jashtë, Publikun dhe Studentët. Me përfundimin e takimeve, GVJ takoi Drejtuesin e Departamentit ndërsa eksperti i ASCAL do të informonte koordinatoren Institucional mbi disa dokumenta shtesë. Në përfundim të vizitave, ekspertët në bazë të dokumentacionit të dorëzuar, takimeve të zhvilluara si dhe vizitës në ambientet e Institucionit hartuan Raportin e Vlerësimit të Jashtëm.

Universiteti i Sporteve të Tiranës është njohur me Draft-Raportin e Vlerësimit të Jashtëm më datë 30.08.2023, përmes sistemit AMS, si dhe në formë zyrtare me anë të shkresës me Nr. 64/15 Prot, datë 30.08.2023. Universiteti i Sporteve të Tiranës përcjell në ASCAL më datë 04.09.2023, me anë të shkresës me Nr. 2059/1 Prot, datë 01.09.2023, “Kthim përgjigje”, ku konfirmon dakortësinë me vlerësimin e kryer nga Ekspertët e Jashtëm. Në këtë mënyrë Draft Raporti merr formën e tij përfundimtare si Raport i Vlerësimit të Jashtëm.

I. OFRIMI I PROGRAMIT TË STUDIMEVE

Standardi I.1	
Institucioni i arsimit të lartë ofron programe studimi në përputhje me misionin dhe qëllimin e tij, me fushën akademike të njësisë kryesore dhe bazë përgjegjëse për programin e studimit, e që synon ruajtjen e interesave dhe vlerave kombëtare.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni i arsimit të lartë ofron programe studimi që nuk bien ndesh me interesat kombëtare dhe synojnë ruajtjen dhe konsolidimin e vlerave akademike e kulturore kombëtare.	Programi i studimit Bachelor në “Shkenca të Rehabilitimit” ofrohet nga Universiteti i Sporteve të Tiranës (UST). Ky program studimi është në harmoni me interesat kombëtare si dhe misionin dhe objektivat e IAL-së. Paralelisht, ky program studimi ofrohet në përputhje me Ligjin e Arsimit të Lartë 80/2015, me Statutin dhe Rregulloren e IAL-së si dhe me Rregulloren e Njësisë Kryesore dhe Njësisë Bazë. Sipas Rregullores së programit të studimit, ky program ka si objektivi të formojë profesionistë që të jenë në gjendje të perballojnë futjen e metodave dhe teknologjive të reja e komplekse në fushën e rehabilitimit si dhe ka për qëllim të formojë rehabilitues profesionistë me njohuri të thella për trupin e njeriut dhe për faktorët e ndryshëm që risin rrezikun. <i>Ref. Nr. 4 “Rregullorja e programit të studimit neni 1, 3</i>
Kriteri 2. Programi i studimit hartohet dhe ofrohet në përputhje me qëllimet dhe misionin e institucionit, si dhe fushën e veprimtarisë.	Ky program studimi është hartuar dhe ofrohet në përputhje me qëllimet dhe misionin e UST. UST ka si mision kryesor ti shërbejë shoqërisë nëpërmjet arsimit, hulumtimit, inovacioneve, nxitjes së zhvillimit individual për transformimin e jetëve, sigurimin e suksesit të studentëve në një mjedis global. Si qëllim kryesor, UST ka ofrimin e mësimdhënies cilësore dhe përmirësimin e kurrikulave për rritjen e dijeve të studentëve të vet. Ky program studimi ka si objektivi aftësimin e studentëve në përdorimin e teknologjisë dhe metodave modern komplekse. Programi i studimit Bachelor në “Shkenca të Rehabilitimit” ofrohet në përputhje me fushën e veprimtarisë së IAL-së. UST-ja është përgjegjëse për ofrimin e të gjitha programeve të studimit me kohë të plotë, programe studimi me karakter profesional, programe studimi në të tria ciklet e studimit, në fushën e edukimit fizik e sporteve, aktivitetit fizik për shëndet, rekreacionit e rehabilitimit, miratuar në përputhje me aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi.

	<p><i>Ref. Nr. 4, Rregullorja e programit të studimit, neni 3</i></p> <p><i>Ref. Nr. 5, Objektivat e UST</i></p> <p><i>Ref. Nr. 17, Statusi i vecantë i UST</i></p>
<p>Kriteri 3. Programi i studimit hartohet dhe ofrohet në përshtatje dhe në zbatim të strategjisë për zhvillim, të Statutit dhe Rregullores së Institucionit si dhe me fushat e drejtimet akademike të tij.</p>	<p>Ky program studimi është hartuar dhe ofrohet në përshtatje me fushat dhe drejtimet e Institucionit si dhe në bazë të akteve dhe vendimeve të brendshme të tij. Sipas planit strategjik të UST, ky institucion synon të mbetet model i arsimit të lartë publik i karakterizuar nga përgatitje rigoroze akademik dhe kërkim i thelluar. UST është përgjegjëse për ofrimin e të gjitha programeve të studimit në fushën e edukimit fizik e sporteve, aktivitetit fizik për shëndetin, rekreacionit e rehabilitimit si dhe menaxhimit sportive. Programi i studimit është në përshtatje me statutin e UST.</p> <p><i>Ref. Nr. 6, Plani strategjik i UST</i></p> <p><i>Ref. Nr. 7, Statuti i UST, neni 10</i></p> <p><i>Ref. Nr. 8, Rregullorja e UST, neni 4</i></p>
<p>Kriteri 4. Institucioni demonstroi se ka përvojën, kapacitetet dhe burimet e duhura në fushën akademike specifike për ofrimin e një programi studimi në atë fushë.</p>	<p>UST është një Institucion i Arsimit të Lartë i tipit Universiteti i hapur me vendimin e Këshillit të Ministrave Nr. 123, datë 17.02.2010 “Për krijimin e Universitetit të Sporteve të Tiranës”. Ky Universitet është hapur bazuar në Akademinë e Edukimit Fizik dhe Sporteve “Vojo Kushi” që prej vitit 1960. Dega e Edukimit Fizik ku ky Institucion ka zanafillën vjen që prej vitit 1958 bazuar në Institutin e “Histori Filologjisë”.</p> <p><i>Ref. Nr. 1, FSHR, Urdhër hapje</i></p> <p><i>Ref. Nr. 7, Statuti i UST, neni 10</i></p> <p><i>Ref. Nr. 17, Statusi i vecantë i UST</i></p> <p><i>Ref. 26.2, Infrastruktura e laboratorëve</i></p>
<p>Kriteri 5. Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit duhet të jetë në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësisë kryesore / bazë, përgjegjëse për programin e studimit, sipas klasifikimit/kodifikimit të programeve të studimit sipas direktivave dhe udhëzimeve kombëtare e evropiane.</p>	<p>Fusha e përgjithshme si dhe fusha specifike e programit të studimit është në përputhje me fushën akademike të Njësisë Kryesore dhe Bazë që ofrojnë këtë program studimi. Njësia Kryesore (Fakulteti i Shkencave të Rehabilitimit) e cila ofron këtë program studimi ka në përbërje të saj Departamentin e Shkencave Biomjekësore dhe Humane. Sipas nenit 5 të Rregullores së Njësisë Kryesore, departamentet janë ato njësi të cilat zhvillojnë mësimdhënien dhe punën kërkimore shkencore në fusha të përafërta me Njësinë Kryesore si dhe grupojnë disiplina mësimore respektive. Sipas VKM-së Nr. 57, datë 29.01.2020, programet e studimeve në UST hartohen nga njësitë bazë dhe paraqiten për miratim në Senatin Akademik. Senati shpall publikisht programet e akredituara të studimeve që ofrojnë njësitë e universitetit para fillimit të aplikimeve për pranime në universitet. Paralelisht, ky program studimi ofrohet</p>

	<p>në përputhje me Rregulloren e Njësive Bazë (Departamenti i Disiplinave Shkencave dhe Humane). Së fundmi, ky program studimi është hartuar sipas klasifikimit/kodifikimit të programeve të studimit sipas direktivave dhe udhëzimeve kombëtare/ndërkombëtare.</p> <p><i>Ref. Nr. 1, FSHR, Urdhër hapje</i></p> <p><i>Ref. Nr. 4, Rregullore e Programit të studimit</i></p> <p><i>Ref. Nr. 9, MAS, Kodifikimi i programeve</i></p> <p><i>Ref. Nr. 10, Rregullorja e Fakultetit të Shkencave të Rehabilitimit</i></p> <p><i>Ref. Nr. 17, Statusi i vecantë i UST</i></p>			
Konkluzione	<p><i>Programi i studimit Bachelor në "Shkenca të Rehabilitimit" ofrohet nga Universiteti i Sporteve të Tiranës (UST). Ky program studimi është në harmoni me interesat kombëtare si dhe misionin dhe objektivat e IAL-së. Programi ofrohet bazuar në aktet ligjore e nënligjore si dhe aktet e hartuara dhe miratuara nga vet institucioni. Institucioni ka eksperiencën dhe kapacitetet e duhura për ofrimin e këtij program studimi si dhe ka filluar procesin për klasifikimin/kodifikimin sipas direktivave kombëtare dhe ndërkombëtare. GVJ mendon se ky standard përmbushet plotësisht.</i></p>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Në përputhje	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi I.2	
Institucioni i arsimit të lartë siguron marrëdhënie bashkëpunimi me institucione, kompani, palë të treta, aktorë të biznesit vendas dhe/ose të huaj në funksion të realizimit të programit të studimit, në kuadër të aftësisht profesional, kërkimit shkencor dhe mobilitetit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni për hartimin, mbikëqyrjen dhe mbarëvajtjen e programit, siguron marrëdhënie të frytshme bashkëpunimi brenda institucionit nëpërmjet ndarjes së detyrave mes njësive e personelit, marrjes së	<p>UST është i organizuar në Njësi Kryesore dhe Njësi Bazë. Njësia Kryesore bashkërendon mësimdhenien, kërkimin shkencor dhe zhvillimin kulturor në fusha mësimore-shkencore të përaferta ose të ndërthurura. Fakulteti i Shkencave të Rehabilitimit ka në përbërjen e vet tre njësi bazë:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Departamentin e Shkencave Biomjekësore dhe Humane; 2. Departamentin e Kineziologjise; 3. Departamentin e Rehabilitimit;

M. [Signature]

[Signature]

<p>përgjegjësi përkatese dhe analizës së vazhdueshme të punës së tyre.</p>	<p>Paralelisht, Njësia Kryesore ka strukturat ndihmës akademike si në nivel Fakulteti ashtu dhe në nivel Departamenti. Qëllimi i tyre është bashkëpunimi dhe koordinimi për ofrimin e programeve të studimit. Sipas statutit të UST, Fakulteti bashkërendon mësimdhënien dhe kërkimin shkencor në fusha të përbashkëta (<i>neni 11</i>) ndërsa departamenti (<i>neni 13</i>) zhvillon mësimdhënien dhe punën kërkimore shkencore duke përfshirë fusha të përafërta dhe grupon disiplinat mësimore përkatese. Sipas <i>pikës 4 të nenit 13</i>, Departamenti është përgjegjës për programet që ofron vet si dhe ato në bashkëpunim me njësi të tjera. Sipas Rregullores së Njesisë Kryesore (<i>neni 8</i>), dekanati koordinon gjithë veprimtarinë e departamenteve që ka në përbërje të vet. Dekani është autoriteti përgjegjës për veprimtaritë e Njësive Bazë dhe organeve të njësive kryesore si dhe zgjidh mosmarrveshjet midis tyre.</p> <p><i>Ref. Nr. 7, Statuti i UST, neni 10, neni 13</i></p> <p><i>Ref. Nr. 8, Rregullorja e UST, neni 8</i></p> <p><i>Ref. Nr. 10, Rregullorja e Fakultetit të Shkencave të Rehabilitimit, neni 8, neni 9</i></p>
<p>Kriteri 2. Për realizimin e objektivave e procesit mësimor e formues të studentëve, institucioni vendos marrëdhënie bashkëpunimi me institucionet homologe brenda dhe/ose jashtë vendit, aktorët e biznesit vendës dhe/ose të huaj.</p>	<p>Bashkëpunimi me IAL vendase e të huaja është një nga prioritetet strategjike të UST. Me qëllim zhvillimin e procesit mësimor dhe formues të studentëve UST ka vendosur marrëdhënie bashkëpunimi me Institucione publike/private brenda dhe jashtë vendit. Këto bashkëpunime fokusohen në zhvillimin e leksioneve, praktikave apo bashkëpunimeve për projekte kërkimore edhe/ose zhvillimore. Sipas <i>nenit 7</i> të Statutit, UST gëzon liri akademike, autonomi financiare si dhe organizative. Sipas <i>nenit 11, pika 5</i> Fakulteti po ashtu ka të drejtë të lidhi marrveshje me njësi të tjera vendase ose të huaja për realizimin e misionit të tyre. Në bazë të dokumentave të dorëzuara, UST ka lidhur marrveshje bashkëpunimi me IAL-vendase dhe të huaja përfshirë këtu Institucione nga Rumania, Austria, Italia etj. Në takimet e zhvilluara me Drejtuesin e Njesisë Kryesore dhe atë Bazë, u raportua se ndërkombëtarizimi dhe bashkëpunimi me Institucione të huaja është një prioritet për ata.</p> <p><i>Ref. 6. Plani Strategjik i Zhvillimit të UST, 2021-2026</i></p> <p><i>Ref. Nr. 7, Statuti i UST, neni 6, neni 7, neni 11</i></p> <p><i>Ref. Nr. 11, Tabelat përmbledhëse</i></p> <p><i>Ref. Nr. 19, Universiteti Foro Italico, Rome, Itali</i></p> <p><i>Ref. 19.1. UST-Shoqata, Progetto Filippide</i></p> <p><i>Ref. 40. Marrveshje bashkëpunimi me Universitete të huaja</i></p>

	<p><i>Ref. 39. Marrëveshje bashkëpunimi me Universitete dhe organizata Shqiptare</i></p> <p><i>Vizita në Institucion</i></p>			
<p>Kriteri 3. Për realizimin e programit të studimit, institucioni nënshkruan marrëveshje të posaçme me institucione, institute kërkimore, kompani të fushës përkatëse për realizimin e praktikave profesionale, klinike, praktikave të punës apo stazhit etj.</p>	<p>Me qëllim realizimin e programit të studimit, UST ka nënshkruar marrëveshje bashkëpunimi me qendra të ndryshme rehabilitimi, klinika private si dhe institucione të ndryshme kombëtare, përfshirë këtu Qendrën Spitalore Nën Tereza, Spitalin Universitar të Traumës, Poliklinika e Specialiteteve etj. Këto marrëveshje u japin mundësinë studentëve të zhvillojnë pjesë të programit të tyre mësimor (praktika).</p> <p><i>Ref. Nr. 11, Tabelat përmbledhëse</i></p> <p><i>Ref. 35. Marrëveshjet me Spitalet dhe Klinikat për realizimin e praktikave</i></p>			
<p>Kriteri 4. Në mënyrë periodike, njësia përgjegjëse për programin e studimit harton raporte analitike të përfitimeve nga marrëveshjet e bashkëpunimit në funksion të realizimit të programit të studimit.</p>	<p>Njësia Bazë në bazë të legjislacionit në fuqi harton raportin vjetor i cili bën pjesë në raportin e Njësisë Kryesore dhe në të cilin përfshihen edhe bashkëpunimet e ndryshme. Në këtë raport përfshihet edhe një relacion mbi zhvillimin e praktikave klinike të studentëve. Nga drejtoria e Marrdhënieve me Jashtë, Publikun dhe Studentët na u raportua se hartimi dhe nënshkrimi i marrëveshjeve zhvillohet në bazë të nevojave të institucionit dhe jo thjesht për të rritur numërin e marrëveshjeve.</p> <p><i>GVJ sugjeron se në raportet e ardhshme është e nevojshme përfshirja e një sektori specifik me rezultatet konkrete të marrëveshjeve aktive (si psh. ecuria, problematikat etj.).</i></p> <p><i>Ref. 12. FSHR. Analiza Vjetore 2021-2022</i></p> <p><i>Vizita në institucion</i></p>			
<p>Konkluzione</p>	<p><i>Bashkëpunimi me IAL vendase e të huaja është një nga prioritetet strategjike të UST. Me qëllim zhvillimin e procesit mësimor dhe formues të studentëve UST ka vendosur marrdhënie bashkëpunimi me Institucione publike/private brenda dhe jashtë vendit. Këto marrëveshje u japin mundësinë studentëve të zhvillojnë pjesë të studimeve të tyre (praktika). <u>Nuk u prezantua një raport konkret mbi implementimin e këtyre marrëveshjeve dhe GVJ konsideron si të rëndësishme dicka të tillë në të ardhmen. GVJ mendon se ky standard përmbushet plotësisht.</u></i></p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>		<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				<p>X</p>

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
I				X

II. ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMIT TË STUDIMIT TË CIKLIT TË PARË BACHELOR

Standardi II.1	
Programi i studimit organizohet në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore kombëtare në fuqi.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Programet e studimit janë të organizuara në lëndë e module. Elementet që përbëjnë strukturën e programit të studimit, janë përcaktuar qartë në përputhje me legjislacionin vendas në fuqi dhe me Sistemin Evropian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS).</p>	<p>Programi i studimit Bachelor në "Shkenca të Rehabilitimit" është i organizuar në lëndë e module. Të gjitha këto janë përcaktuar në bazë të legjislacionit në fuqi si dhe të Sistemit European të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve. Për të përmblytur këtë program studimi, studentët duhet të mbledhin 180 kredite (ECTS) në total. Numri i krediteve për lëndë varion ndërsa provimi përfundimtar ka 6 kredite.</p> <p><i>Ref. 4. Rregullorja e Programit të Studimit;</i> <i>Ref. Nr. 8, Rregullorja e UST, neni 79, neni 80;</i> <i>Ref. 36. Model, Plan Mësimor 2021-2022, Bachelor në "Shkencat e Rehabilitimit";</i></p>
<p>Kriteri 2. Programi i studimit synon formimin e shprehive të veçanta në larmi të gjerë profesionale e specialitetesh, jep njohuri të përparuara në një fushë studimi ose punësimi, ku përfshihet të kuptuarit kritik të teorive dhe parimeve akademike të fushës, zhvillon njohuri, aftësi dhe kompetenca të përparuara në një fushë akademike ose profesionale, të nevojshme për zgjidhjen e problemeve komplekse</p>	<p>Programi i studimit "Bachelor" në "Shkenca të Rehabilitimit", i cili zgjat tre vite akademike, ka si objektiv të formojë profesionistë të pajisur me shprehitë bazë shkencore dhe praktike në fushën e rehabilitimit. Kursi i studimit të diplomes "Shkenca të Rehabilitimit", synon të formojë profesionistë që të jenë në gjendje të përballojnë futjen e metodave dhe teknologjive të reja e komplekse në fushën e rehabilitimit dhe ka për qëllim të formojë rehabilitues profesionistë me njohuri të thella për trupin e njeriut, për faktorët e ndryshëm që risin rrezikun për tu prekur nga semundje të ndryshme, llojet me kryesore të dëmtimeve dhe procesin e parandalimit, rehabilitimit dhe përmirësimit të aftësive lëvizore të jetës së përditshme, rehabilitimit pas dëmtimeve apo traumave të ndryshme fizike si aksidenteve në punë e jashtë punës, dëmtimeve sportive; dhe rehabilitimin nga semundje të ndryshme kronike si rehabilitim kardiak për pacient me</p>

<p>dhe të paparashikueshme në një fushë të specializuar studimi ose profesionale.</p>	<p>semundje kardiovaskulare, rehabilitim fizik për të gjitha llojet e dëmtimeve të aparatit muskuloskeletor, etj.</p> <p>Plani mësimor përfshin zhvillimin e lëndëve me karakter teorik si dhe praktikë mësimore. Kombinimi i teorisë me praktikën u jep studentëve mundësinë të zhvillojnë njohuri, aftësi dhe kompetenca në fushën e fizioterapisë. Të gjitha këto u japin mundësinë të zgjidhin probleme komplekse në këtë fushë specifike me qëllim ushtrimin e profesionit në të ardhmen në mënyrë sa më të mirë.</p> <p><i>Ref. 4. Rregullorja e Programit te Studimit;</i></p> <p><i>Ref. 14. Suplementi i Diplomës. FSHR. Bachelor ne Shkencat e Rehabilitimit (Fizioterapi);</i></p> <p><i>Ref. 15. Model, Programi i lëndës, Praktikë 1, 2022-2023;</i></p> <p><i>Ref. 36. Model, Plan Mësimor 2021-2022, Bachelor në "Shkencat e Rehabilitimit (Fizioterapi)";</i></p>
<p>Kriteri 3. Programet e studimit kanë të përcaktuar qartë veprimtaritë formuese duke grupuar lëndët/modulet sipas kategoritë të përcaktuara dhe me ngarkesën përkatëse në kredite.</p>	<p>Programi i studimit ka në total 180 kredite (ECTS). Lëndët/modulet janë të ndara në pesë kategori ku përfshihen lëndë bazë (19% e krediteve), lëndë karakterizuese (51% e krediteve), lëndë ndërdisiplinore/integruese (13% të krediteve), lëndë plotësuese (10-15% të krediteve dhe detyrime përmblyëse (3% të krediteve). Në cdo vit akademik studentët mund të marrin 60 kredite në total (30 në secilin semestër). Secili kredit është i barabartë me 25 orë mësimore (përfshirë këtu leksione, seminare, detyra etj.).</p> <p><i>Ref. 4. Rregullorja e Programit te Studimit;</i></p> <p><i>Ref. Nr. 8, Rregullorja e UST, neni 80, neni 85;</i></p> <p><i>Ref. 36. Model, Plan Mësimor 2021-2022, Bachelor në "Shkencat e Rehabilitimit (Fizioterapi)";</i></p>
<p>Kriteri 4. Programi i studimit ka të përcaktuara ngarkesën në kredite për realizimin e praktikës profesionale dhe të detyrimeve përmblyëse.</p>	<p>Ky program studimi është hartuar në përputhje me legjislacionin në fuqi si dhe të gjitha VKM-të dhe udhëzimet specifike të Ministrisë së Arsimit dhe Sportit. Totali i krediteve për këtë program studimi është 180 ECTS. Sipas parashikimeve në planin mësimor, Praktika 2 dhe Praktika 3 ka 8 kredite secila, ndërsa praktika 1 pesë (5) kredite. Studentët (<i>sipas nenit 15 pika 1 e Rregullores së Programit</i>) kanë detyrimin e kryerjes 100% të orëve të praktikës mesimore. Studentët më qëllim përfundimin e sukseshëm të këtij program studimi janë të detyruar të japin provimin përfundimtar i cili ka 6 kredite. Në bazë të <i>Nenit 19</i>, studimet e ciklit të parë "Bachelor në "Shkenca të Rehabilitimit", përmblyen me</p>


Adresa: "Rruga e Durrësit"
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

Web site: www.ascal.al

E-mail: info@ascal.al




	<p>provim të përgjithshëm përfundimtar dhe në përfundim të tyre lëshohet diplomë "Bachelor në "Shkenca të Rehabilitimit". Studenti nuk mund të futet në provimin final pa shlyer më parë të gjitha detyrimet dhe pa fituar numrin e krediteve të parashikuara në planin mesimor. Programi i provimit të përgjithshëm përfundimtar përfshin lendë të ndryshme nga fushat kryesore që mbulon programi i studimit Bachelor në "Shkenca të Rehabilitimit" (Neni 19 neni 20).</p> <p><i>Ref. 4. Rregullorja e Programit të Studimit;</i> <i>Ref. Nr. 8, Rregullorja e UST, neni 82;</i> <i>Ref. 36. Model, Plan Mësimor 2021-2022, Bachelor në "Shkencat e Rehabilitimit (Fizioterapi)";</i></p>
<p>Kriteri 5. Forma e organizimit të studimeve, pranimi i studentëve dhe financimi në institucionet e arsimit të lartë me status të veçantë realizohen në përputhje me ligjin e arsimit të lartë dhe specifikat përkatëse, të përcaktuara me udhëzime të ministrisë përgjegjëse për arsimin.</p>	<p>UST ka status të veçantë në bazë të ligjit të Arsimit të Lartë Nr. 80/2015 si dhe të VKM-së Nr. 57, datë 29.1.2020. Sipas statutit të UST (neni 72), format e studimit janë me kohë të plotë dhe kohë të zgjatur ndërsa pranimi i studentëve zhvillohet me vendime të brendshme të Institucionit. Pas propozimeve nga Njësia Bazë, Senati Akademik miraton kuotat e pranimeve të cilat duhet të jenë në përputhje me standartet e përcaktuara. Kuotat e pranimit llogariten mbi bazën e studentëve aktivë që ndjekin programet e studimit. UST miraton kriteret e pranimit për studentët në bazë të legjislacionit në fuqi. Financimi i UST zhvillohet në bazë të legjislacionit në fuqi, përfshirë këtu statusin e veçantë që ky Institucion ka.</p> <p><i>Ref. 7. Statuti i UST;</i> <i>Ref. Nr. 8, Rregullorja e UST, neni 87;</i> <i>Ref. 16. Kriteret e Pranimit të Studentëve;</i> <i>Ref. 17. Statusi i Veçantë UST. VKM-Nr. 57, datë, 29.01.2020;</i></p>
<p>Kriteri 6. Programet e studimit Bachelor, që ofrohen në të njëjtën fushë studimi, cikël si dhe me të njëjtën emërtesë, duhet të kenë përmbajtje të ngjashme në nivel, së paku 70 për qind.</p>	<p>Programi i studimit Bachelor në Shkenca të Rehabilitimit është i ngjashëm në nivel më të lart se 70% me programin e studimit Bachelor në "Fizioterapi" i cili ofrohet nga Universiteti i Mjeksisë, Fakulteti i Shkencave Mjekësore Teknike, Tiranë.</p> <p>Për hartimin e këtij program studimi u morr parasysh programi i FSHMT si dhe programe të ngjashme jashtë Shqipërisë. Paralelisht, programe të ngjashme të cilat ofrohen në Universitete Europiane, (më specifikisht Poloni) janë marrë parasysh për hartimin e këtij programi.</p>




	<p><i>Ref. 18, Plani mësimor i FSHMT, UMT;</i> <i>Ref. 36. Model, Plan Mësimor 2021-2022, Bachelor në "Shkenca e Rehabilitimit (Fizioterapi)";</i> <i>Vizita në Institucion</i></p>			
<p>Kriteri 7. Programi i studimit shoqërohet me kodin përkatës, sipas fushës së studimit dhe klasifikimeve të bëra publike nga ministria përgjegjëse për arsimin. Më tej kryhet kodifikimi i lëndëve të programit.</p>	<p>Kodifikimi i programit është në proces dhe nuk është përfunduar akoma. Në përfundim të kodifikimit të programeve të studimit në rang kombëtar, do të kodifikohen respektivisht dhe lëndët/modulet në këtë program studimi. Ky proces nuk është përfunduar pasi pritet realizimi i tij nga MAS, bazuar edhe në udhëzimin e publikuar.</p> <p><i>Takim me Dekanin/Drejtuesin e Departamentit;</i> <i>Ref. Nr. 9, Udhëzimi i MAS Nr. 31;</i></p>			
<p>Kriteri 8. Programet e studimit mund të jenë edhe programe të përbashkëta midis dy ose më shumë institucioneve të arsimit të lartë, vendas dhe të huaj, në përputhje me legjislacionin në fuqi.</p>	<p>Ky nuk është një program i përbashkët. Në bazë të <i>Nenit 50 dhe nenit 70</i> të Rregullores së Njesisë Kryesore, ofrimi i programeve të përbashkëta është një nga objektivat e UST. Për këtë arsye, UST ka nënshkruar marrveshje bashkëpunimi me Institucione publike dhe private si brenda ashtu dhe jashtë vendit. Kjo është dhe një nga Prioritetet Strategjike (Nr. 5 – Ndërkombëtarizimi) të UST. Gjatë vizitës në Institucion, u informuam nga Drejtuesi i Njesisë Kryesore se po punohet në këtë drejtim për ofrimin e programeve të përbashkëta.</p> <p><i>Ref. Nr. 6, Plani strategjik i zhvillimit;</i> <i>Ref. Nr. 8, Rregullorja e UST, neni 50, neni 70;</i> <i>Ref. Nr. 19, Universiteti Foro Italico, Rome, Itali</i> <i>Ref. 19.1. UST-Shoqata, Progetto Filippide</i> <i>Ref. 40. Marrveshje bashkëpunimi me Universitete të huaja</i> <i>Ref. Nr. 11, Tabelat përmbledhëse</i> <i>Vizita në Institucion</i></p>			
<p>Konkluzione</p>	<p><i>Programi i studimit Bachelor në Shkenca të Rehabilitimit është i organizuar në lëndë e module. Ky program zgjat tre vite akademike dhe ka në total 180 kredite (ECTS). Ky program është hartuar në përputhje me legjislacionin në fuqi si dhe të gjitha VKM-të dhe udhëzimet specifike. GVJ mendon se ky standard përmbushet plotësisht.</i></p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>		<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				X

Standardi II.2

Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush kërkesat ligjore dhe standardet e cilësisë për këto njësi.

Kriteret**Vlerësimi i ekspertëve**

Kriteri 1. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush detyrimet e përcaktuara në legjislacionin në fuqi për organizimin dhe strukturën akademike, stafet akademike vlerësimin dhe akreditimin.

Sipas dokumentave në RVB, me Vendim Nr. 2, datë 07.01.2022 të Bordit të Akreditimit, UST është akredituar në nivel Institucional për 6 (gjashtë) vite duke përmbushur kërkesën ligjore për akreditim institucioni.

Njësia kryesore përgjegjëse për ofrimin e programit të studimit është Fakulteti i Shkencave të Rehabilitimit i cili, duke qenë i organizuar në 3 departamente si më poshtë plotëson kriteret e kërkuara sipas kuadrit ligjor në fuqi sipas të cilit një Fakultet organizohet në të paktën tre njësi përbërëse nga të cilat të paktën dy janë departamente.

1. Departamentin e Shkencave Biomjeksore dhe Humane;
2. Departamentin e Kinziologjise;
3. Departamentin e Rehabilitimit;

Fakulteti i Shkencave të Rehabilitimit në vitin akademik 2022-2023 është i përberë nga Personeli Akademik Efektiv (PAE) në nivel fakulteti (21 pedagogë PAE) dhe 5 Personel Akademik me Kontratë, të cilët kanë kualifikimin si më poshtë.

Kualifikimi i stafit	Fakulteti i Shkencave të Rehabilitimit	
	PAE	PAK
Prof.Dr	1	-
Prof.Asoc	2	-
Dr/PhD	6	3
Dr në proc	2	-
Msc	10	2
Gjithsej	21	5

Departamenti i Shkencave Biomjeksore dhe Humane si njësi bazë përgjegjëse për programin e studimit në vitin akademik 2022-2023 ka këtë paraqitje:

Kualifikimi i stafit	Departamenti i Shkencave Biomjeksore dhe Humane	
	PAE	PAK
Prof.Dr	-	-
Prof.Asoc	-	-
Dr/PhD	3	2
Dr në proc	2	-
Msc	2	1
Gjithsej	7	3

	<i>Ref. Nr. 11, Tabelat përmbledhëse</i> <i>Vizita në Institucion</i>			
Kriteri 2. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush detyrimet e përcaktuara në legjislacionin në fuqi, duke angazhuar personel ndihmës akademik /administrativ për realizimin e praktikave mësimore, laboratorike e klinike, etj.	<p>Departamenti i Shkencave Biomjeksore dhe Humane i cili ofron këtë program studimi ka në përbërjen e vet 1 personel ndihmës akademik i cili asiston në ofrimin e këtij program studimi.</p> <p><i>GVJ sugjeron rritjen e numrit të personelit ndihmës akademik.</i></p> <p><i>Ref. Nr. 11, Tabelat përmbledhëse</i></p>			
Kriteri 3. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin për çdo program studimi cakton një person në rolin e koordinatorit të programit të studimit, i cili është përgjegjës për ecurinë dhe zhvillimin e programit dhe praktikave profesionale në përputhje me objektivat e tij.	<p>Sipas <i>Nenit 13</i> i Rregullores së Njesisë kryesore përcaktohen të gjitha dispozitat dhe detyrimet e koordinatorit të programit të studimit. Ky person i cili duhet të jetë anëtar efektiv i departamentit propozohet nga Drejtuesi i Njesisë Bazë dhe emërohet/shkarkohet nga Drejtuesi i Njesisë Kryesore.</p> <p>Me vendimin Nr. 18 datë 14.10.2022 Nr. 1574/1 Prot. është marrë vendimi nga Drejtuesi i Njesisë Kryesore për koordinatorin e programit të studimit Bachelor në “Shkenca të Rehabilitimit”.</p> <p><i>Ref. Nr. 10, Rregullorja e Fakultetit të Shkencave të Rehabilitimit, neni 13;</i></p> <p><i>Ref. 20. Vendimi për emërimin e koordinatorit të programit të studimit;</i></p>			
Konkluzione	<p><i>Departamenti i Shkencave Biomjeksore dhe Humane i cili ofron këtë program studimi i përmbush të gjitha detyrimet sipas përcaktimeve ligjore e nënligjore. Departamenti ka në përbërjen e vet staf akademik me kohë të plotë dhe me kontrat si dhe staf administrativ. Paralelisht, në Rregulloren e Njesisë Kryesore përcaktohen detyrimet dhe përgjegjësitë e koordinatorit të programit të studimit. Rritja e numërit të stafit ndihmës akademik si dhe përfitimi i titujve akademik nga anëtarët e Departamentit është e nevojshme. GVJ mendon se ky standard përmbushet plotësisht.</i></p>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Niveli i përmbushjes	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi II.3

Programi i studimit është i detajuar, informues, i strukturuar dhe organizuar në përputhje me parashikimet dhe objektivat formuese të programit të ciklit të parë.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Njësia kryesore/bazë, përgjegjëse për programet e studimit të ciklit të parë, disponojnë informacionet e nevojshme për organizimin, strukturën dhe përmbajtjen e programeve të studimeve.</p>	<p>Njësia Bazë disponon të gjithë informacionin e nevojshëm për organizimin, strukturën dhe përmbajtjen e këtij programi studimi. Në vizitën e zhvilluar në Institucion u raportua se pranë Njesisë Bazë disponohet i gjithë dokumentacioni i nevojshëm përfshirë këtu planin mësimor, syllabuset, tezat e provimeve etj.</p> <p><i>Vizita në Institucion</i></p>
<p>Kriteri 2. Programi i studimit përmban planin mësimor, ku përfshihet informacioni i nevojshëm për ndarjen e lëndëve në semestra, ngarkesën mësimore të lëndëve/moduleve, orët në auditor/jashtë auditorit.</p>	<p>Programi i studimit përmban të gjithë informacionin e nevojshëm. Ky program studimi ka 180 ECTS të ndara në tre vite (60 kredite në vit – 30 kredite për semestër).</p> <p>Informacion mbi ngarkesën mësimore, modulet, orët në auditor dhe jashtë tij janë të detajuara. Plani mësimor për programin e studimit Bachelor në “Shkenca të Rehabilitimit” është i ndarë në lëndë bazë, karakterizuese, ndërdisiplinore, plotësuese dhe detyrimet përmbledhëse.</p> <p><i>Ref. Nr. 11, Tabelat përmbledhëse;</i> <i>Ref. Nr. 4, Rregullore e Programit të studimit;</i> <i>Ref. 36. Model, Plan Mësimor 2021-2022, Bachelor në “Shkencat e Rehabilitimit (Fizioterapi)”;</i></p>
<p>Kriteri 3. Programi i studimit përmban të gjitha informacionet e nevojshme për studentët që lidhen me kriteret e përgjithshme dhe specifike të pranimit, transferimit dhe ekuivalentimit të studimeve.</p>	<p>Në rregulloren e programit të studimit (<i>neni 5</i>) përfshihen të gjitha kriteret dhe procedurat specifike për pranimin e studentëve. <i>Nenet 6-10</i> detajojnë të gjitha procedurat për transferimin e studimeve dhe njohjen e krediteve. Institucioni, në bazë të propozimeve të Njesisë Bazë miraton kriteret e pranimit dhe i publikon ato. Informacion mbi transferimin e studentëve përfshihen po ashtu edhe në rregulloren e Institucionit (<i>neni 78</i>) si dhe në rregulloren e Njesisë Kryesore (<i>nenet 73-75</i>). Deri në këtë moment nuk ka patur transferime apo ekuivalentime të studimeve.</p> <p><i>Ref. Nr. 4, Rregullore e Programit të studimit;</i> <i>Ref. Nr. 8, Rregullorja e UST;</i></p>




	<p><i>Ref. Nr. 10, Rregullorja e Fakultetit të Shkencave të Rehabilitimit;</i></p> <p><i>Ref. 16. Kriteret e Pranimit të Studentëve;</i></p>			
<p>Kriteri 4. Programi i studimit përmban informacionet e nevojshme për programet lëndore (syllabuset) për secilën lëndë për praktikat, seminarët apo orët e laboratorit, si dhe të gjithë komponentët formues të programit brenda dhe jashtë auditorit në përputhje me formatet e miratuara.</p>	<p>Programi i studimit përmban të gjitha informacionet e nevojshme për syllabuset, për praktikat mësimore, seminarët, punën individuale etj. Të gjitha këto janë në koherencë dhe në përputhje me legjisllacionin në fuqi. Syllabuset janë të hartuara në bazë të udhëzimit përkatës.</p> <p><i>Ref. Nr. 4, Rregullore e Programit të studimit;</i></p> <p><i>Ref. 32. Model Programi Lënde;</i></p> <p><i>Ref. Syllabuset;</i></p>			
<p>Kriteri 5. Përmbajtja e programit të studimit është në përmirësim dhe përditësim të vazhdueshëm dhe në fillim të çdo viti akademik miratohen ndryshimet eventuale dhe arkivohet dosja e plotë.</p>	<p>Ky është një program i ri studimi dhe studentët do të diplomohen për herë të parë këtë vit akademik. Në diskutimet e zhvilluara me Drejtuesit e Njësisë Kryesore/Bazë si dhe me pedagogët e programit, ata raportuan se rregullisht e shikojnë përmirësimin e programit si dhe në raportin vjetor përfshijnë informacionin e duhur. Paralelisht, ata na informuan se në fund të diplomimit me ndihmën e alumnit do të shikojnë rregullime të ndryshme që programi mund të ketë nevoj.</p> <p><i>Vizita në Institucion</i></p>			
<p>Konkluzione</p>	<p><i>Njësia Bazë disponon të gjithë informacionin e nevojshëm për organizimin, strukturën dhe përmbajtjen e këtij program studimi. GVJ mendon se ky standard përmbushet plotësisht.</i></p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>		<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				<p>X</p>

Standardi II.4

Struktura, organizimi dhe përmbajtja e programeve të studimit është në përputhje me objektivat formuese, nivelin e kualifikimit sipas Kuadrit Kombëtar dhe Evropian të Kualifikimeve, rezultateve të të nxënit dhe vazhdimin të studimeve, kompetencave në përputhje me kërkesat e tregut të punës.

Kriteret

Vlerësimi i ekspertëve

Kriteri 1. Emërtimi, përmbajtja e veprimtarive,


Ky është një program i ri studimi i cili zgjat tre vite akademike, ka si objektivi të formojë profesionistë të pajisur me shprehitë

<p>shpërndarja e lëndëve dhe praktikave, mundësojnë, thellirn të njohurive dhe aftësive për studime të mëtejshme dhe/ose punësimin e studentëve.</p>	<p>bazë shkencore dhe praktike në fushën e rehabilitimit. Kursi i studimit të diplomës "Shkenca të Rehabilitimit", synon të formojë profesionistë që të jenë në gjendje të përballojnë futjen e metodave dhe teknologjive të reja e komplekse në fushën e rehabilitimit dhe ka për qëllim të formojë rehabilitues profesionistë me njohuri të thella për trupin e njeriut, për faktorët e ndryshëm që risin rrezikun për tu prekur nga semundje të ndryshme, llojet më kryesore të dëmtimeve dhe procesin e parandalimit, rehabilitimit dhe përmiresimit të aftësive lëvizore të jetës së përditshme, rehabilitimit pas dëmtimeve apo traumave të ndryshme fizike si aksidenteve në punë e jashtë punës, dëmtimeve sportive; dhe rehabilitimin nga semundje të ndryshme kronike si rehabilitim kardiak për pacient me semundje të zemrës, rehabilitim fizik për të gjitha llojet e dëmtimeve të aparatit muskuloskeletor, etj.</p> <p>Në këtë moment nuk ofrohet master për vazhdimin e studimeve por gjatë takimeve na u konfirmua se studentët pas përfundimit të studimeve do të kenë mundësinë të vazhdojnë studime të ciklit të dytë të cilat do ti ofroj Institucioni në këtë fushë.</p> <p><i>Vizita në Institucion</i></p> <p><i>Ref. Nr. 4, Rregullorja e programit të studimit;</i></p>
<p>Kriteri 2. Lëndët/modulet, shpërndarja në vite e semestra, vlerësimi në kredite e orë mësimore mundëson arritjen e objektivave formues të programit të studimit dhe rezultateve të pritshme të të nxënit.</p>	<p>Ndërthurja e lëndëve të përgjithshme me lëndët më specifike klinike shpërndarja në vite e semestra, mundësojnë formimin profesional dhe shkencor të studentëve. Plani mësimor mundëson arritjen e objektivave formues të programit të studimit. Plani mësimor është i ndarë në lëndë/module me kredite specifike. Në syllabuset e lëndëve përcaktohen qartë kreditet dhe orët brenda dhe jashtë auditorit, objektivat e përgjithshme dhe specifike si dhe rezultatet e pritshme të të nxënit.</p> <p><i>Ref. Nr. 4, Rregullore e Programit të studimit;</i></p> <p><i>Ref. 36. Model, Plan Mësimor 2021-2022, Bachelor në "Shkencat e Rehabilitimit (Fizioterapi)";</i></p> <p><i>Syllabuset e moduleve/lëndëve të këtij program studimi;</i></p>
<p>Kriteri 3. Struktura e programit, lëndët, raporti teori praktikë është në përputhje me profilin e programit të studimit dhe</p>	<p>Në programin e studimit rezultojn, se raporti teori praktikë është i përafërt me programet ndërkombëtare. Gjatë takimit me stafin drejtues dhe akademik u deklarua se programi është i njëjtë me programe të ngjashme ndërkombëtare dhe kombëtare, U deklarua se ky program është i ngjashëm me programin e</p>




<p>e përafërt me programe të ngjashme ndërkombëtare.</p>	<p>Fizioterapisë në Universitetin e Mjeksisë si dhe me programe të ngjashme në Poloni.</p> <p>Në total ky program studimi përfshin:</p> <ul style="list-style-type: none"> - 1123 orë leksione; - 297 orë seminare; - 30 orë ushtrime/detyra kursi; - 552 orë laborator dhe praktikë e klinikë profesionale; - Orët totale në auditor janë 2002 ndërsa ato për studim individual 2498. <p><i>Ref. Nr. 4, Rregullore e Programit të studimit;</i></p> <p><i>Ref. 36. Model, Plan Mësimor 2021-2022, Bachelor në "Shkencat e Rehabilitimit (Fizioterapi)";</i></p> <p><i>Vizita në Institucion;</i></p>
<p>Kriteri 4. Ndarja sipas veprimtarive formuese dhe raportet midis formimit teorik dhe praktik mundësojnë arritjen e objektivave formues, transferim të studimeve, mobilitet dhe punësim në përfundim të studimeve.</p>	<p>Plani mësimor i programit të studimit Bachelor në "Shkenca të Rehabilitimit" përfshin veprimtari formuese dhe plani mësimor parashikon lëndë bazë, karakterizuese, ndërdisiplinore, plotësuese dhe detyrime përmbledhëse midis formimit teorik dhe praktik duke mundësuar arritjen e objektivave formues, transferim të studimeve, mobilitet dhe punësim në fushën e rehabilitimit/fizioterapisë.</p> <p>Transferimi i studimeve është i mundur ndërsa mobilitetet jashtë Shqipërisë në këtë program studimi mund të realizohen. Duke patur parasysh që ky është një program i ri, nuk kishte deri në këtë moment asnjë transferim apo mobilitet të studentëve. Institucioni raportoi se do të ndjekti procedurat për mobilitetin e studentëve edhe në këtë program studimi, ashtu si ka zhvilluar për programet e tjera të cilat ofron dhe ka një numër të konsiderueshëm mobilitetesh.</p> <p><i>GVJ konsideron si të rëndësishme mobilitetin e studentëve jashtë Shqipërisë dhe beson se IAL-ja duhet të punoj më fort drejt këtij drejtimi për këtë program studimi.</i></p> <p><i>Ref. Nr. 4, Rregullore e Programit të studimit;</i></p> <p><i>Ref. 36. Model, Plan Mësimor 2021-2022, Bachelor në "Shkencat e Rehabilitimit (Fizioterapi)";</i></p> <p><i>Vizita në Institucion;</i></p> <p><i>Dok. Shtesë: Listen e mobiliteteve (hyrëse dhe dalëse) të stafit akademik dhe studenteve.pdf (Nr. 2);</i></p>

<p>Kriteri 5. Syllabuset (programet e lëndëve /moduleve) përditësohen në mënyrë të vazhdueshme për marrjen e kompetencave në përputhje me kërkesat e tregut të punës, duke përfshirë literaturën bazë dhe ndihmëse të viteve të fundit.</p>	<p>Gjatë takimit në Institucion u raportua së syllabuset rishikohen në fillim të çdo semestri akademik. Ato miratohen nga titullari i lëndës dhe më pas nga drejtuesi i departamentit. Literatura e përfshirë u raportua se është ajo e 5-10 viteve të fundit. Pedagogët raportuan se është e vështirë të gjendet literature në gjuhën shqipe dhe se në rastet më të shumta ata u përcjellin studentëve leksionet e prezantuara ne ppt. si dhe detajime të leksionit në formë ëord/pdf. Kjo procedurë u raportua dhe nga studentët e këtij program studimi.</p> <p>Pavarësisht këtyre, në syllabuset e dlorëzuara, në disa lëndë u vërejt një literaturë më e vjetër dhe <u>GVJ sugjeron që në periudhën në vijim të ketë një përditësim.</u></p> <p><i>Vizita në Institucion;</i> <i>Ref. Syllabuset;</i></p>
<p>Kriteri 6. Përmbajtja e programit të studimit garanton përftimin e dijeve, aftësive dhe kompetencave të synuara.</p>	<p>Përmbajtja e programit synon të ndihmojë studentët në përfitimin e dijeve, të cilat kanë si qëllim arritjen e aftësisive dhe kompetencave, të cilat duhet të përputhen me përmbylljen e ciklit të parë. Përmbajtja e programit synon të ndihmojë studentët në përfitimin e dijeve, të cilat kanë si qëllim arritjen e aftësisive dhe kompetencave, të cilat duhet të përputhen me përmbylljen e ciklit të parë. Modulet/lëndët e përfshira në këtë plan mësimor u garantojnë studentëve të përfitojnë dije, aftësi dhe kompetenca të cilat ata do ti ushtrojnë gjatë punësimit të tyre. Të gjitha syllabuset e dorëzuara përfshinin në përmbajtjen e tyre objektivat e mësimnxënies si dhe aftësitë dhe kompetencat e synuara. Krahas njohurive shkencore teorike synohet aftësimi praktik i studentëve nëpërmjet laboratorëve dhe praktikave. Si përfundim synohet që studenti të përvetësojë njohuri shkencore, aftësi praktike dhe klinike. Të gjitha këto janë në unison me objektivat e programit të studimit.</p> <p><i>Ref. Nr. 4, Rregullore e Programit të studimit;</i> <i>Ref. 36. Model, Plan Mësimor 2021-2022, Bachelor në "Shkencat e Rehabilitimit (Fizioterapi)";</i> <i>Syllabuset e moduleve/lëndëve të këtij program studimi</i></p>
<p>Kriteri 7. Përmbajtja e programit të studimit mundëson vijimin e mëtejshëm të studimeve dhe/ose punësimin e studentëve në përshtatje</p>	<p>Ky është një program i ri studimi dhe në këtë moment nuk kemi rezultate mbi punësimin apo vijimin e mëtejshëm të studimeve nga studentët. <i>Për këtë arsye janë në proces procedurat për regjistrimin e të diplomuarve pranë urdhërit të infermierit.</i> Nga ana tjetër, studentët e diplomuar këtë vit do të kenë mundësinë</p>




me pritshmëritë e kërkesat e tregut e punës.	nëse dëshirojnë të vazhdojnë studimet e ciklit të dytë në këtë fushë.			
	<i>Vizita në Institucion;</i>			
Konkluzione	Ky është një program i ri studimi i cili zgjat tre vite akademike, ka si objektiv të formojë profesionistë në fushën e rehabilitimit. Plani mësimor i programit të studimit parashikon lëndë bazë, karakterizuese, ndërdisiplinore, plotësuese dhe detyrime përmbledhëse midis formimit teorik dhe praktik duke mundësuar arritjen e objektivave formues, transferim të studimeve, mobilitet dhe punësim. Duke patur parasysh që është një program i ri studimi, nuk kemi për momentin transferime apo mobilitete të studentëve ndërsa literature në disa syllabuse duhet përditësuar. GVJ mendon se ky standard përmbushet plotësisht.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi II.5	
Institucioni i arsimit të lartë nxit përfshirjen e studentëve dhe partnerëve, rrjeteve dhe organizmave të tjera në hartimin dhe përmirësimin e vazhdueshëm të programit të studimit dhe realizimin me sukses në përputhje me objektivat e tyre.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Për përmirësimin e përmbajtjes së programit të studimit dhe për përshtatjen sa më mirë me kërkesat e tregut të punës, gjatë hartimit dhe ecurisë së programit të studimit, njësitë përgjegjëse konsultohen dhe marrin parasysh propozimet e institucioneve partnere, të diplomuarve, dhe aktorëve të tjerë nga tregu i punës.	Ky është një program i ri studimi dhe përmirësimi i përmbajtjes së tij nuk është zhvilluar ende pasi këtë vit do të diplomohet brezi i parë. Në takimet e zhvilluara u raportua se ky program studimi është hartuar në bazë të nevojave të tregut të punës si dhe është i ngjashëm në nivele të larta me programe të njëjta të cilat ofrohen brenda dhe jashtë Shqipërisë. IAL-ja raportoi bashkëpunim të mirë me aktorë të tregut të punës si dhe platformën www.alumni.ust.edu.al/ të cilën ka krijuar për të siguruar feedback virtual nga partner privat si dhe për publikimin e mundshëm të vendeve të punës. Paralelisht, ata raportuan se do të krijohet edhe në këtë program studimi (si në programet aktuale) një database me të gjithë të diplomuarit me qëllim mbajtjen e kontakteve. <i>Vizita në Institucion</i>
Kriteri 2. Institucioni nxit dhe përfshin në diskutime studentët dhe strukturat e	Institucioni nxit dhe përfshin studentët në strukturat e veta. Studentët janë pjesë e Senatit Akademik si dhe marrin pjesë në komisione të ndryshme të ngritura në procese të ndryshme.

<p>tyre, mban kontakte dhe konsultohet vazhdimisht me studentët e diplomuar, për përmirësimin e programit të studimit, dhe reflektimin kur ato janë në ndihmë të përmirësimit të programit të studimit.</p>	<p>Studentët janë të përfshirë në komisionin e cilësisë si dhe një student ishte pjesë e grupit të punës për hartimin e raportit të vlerësimit të brendshëm. Gjatë takimit me studentët ata raportuan përfshirje në takime/diskutime të ndryshme si dhe pohuan se pedagogët marrin mendimin e tyre për çështje të ndryshme. Konsultimi me studentët e diplomuar nuk është ende i mundur pasi këtë vit do të diplomohet brezi i parë. Drejtuesit e njësive Kryesore dhe Bazë si dhe Sektori i Karrierës, Alumnit dhe Marrëdhëniet me Studentët raportuan dëshirën dhe vullnetin e tyre për të mbajtur kontakte të vazhdueshme me të diplomuarit në kuadër të përmirësimit të programit të studimit. Deri në këtë moment sektori i alumnit zhvillon aktivitete të ndryshme me të diplomuar të programeve të tjera që institucioni ofron, diçka që do të vazhdojë edhe për këtë program.</p> <p><i>Ref. 3. Urdher Rektori për ngritjen e GVB;</i> <i>Ref. 23.3. Rregullore për Sigurimin e Cilësisë, neni 10;</i> <i>Ref. 23.6. Për ngritjen e NJSBC;</i> <i>Vizita në Institucion;</i> <i>Dok. Shtesë: Liste të aktiviteteve të sektorit të alumnit.pdf (Nr. 6);</i></p>
<p>Kriteri 3. Njësia përgjegjëse përmirëson, përditëson, përshtat programin e studimit në përputhje me propozimet dhe zhvillimet e fundit në fusha të ndryshme në bashkëpunim me rrjete profesionistësh, shoqata, urdhra profesionale (veçanërisht në fushën e mjekësisë) dhe institucione publike e private.</p>	<p>Hapa të tilla nuk janë zhvilluar deri në këtë moment pasi ky është një program i ri studimi dhe ende nuk janë diplomuar student. Institucioni raportoi se do të ketë bashkëpunime të ngushta me rrjete profesionistësh dhe në bazë të zhvillimeve të fushës së rehabilitimit/fizioterapisë do të përshtasë dhe përditësojë programin e studimit Bachelor në “Shkenca të Rehabilitimit”.</p> <p><i>Vizita në Institucion</i></p>
<p>Konkluzione</p>	<p><i>Ky është një program i ri studimi dhe përmirësimi i përmbajtjes së tij nuk është zhvilluar ende pasi këtë vit do të diplomohet brezi i parë. Institucioni nxit dhe përfshin studentët në strukturat e veta. Studentët janë pjesë e Senatit Akademik si dhe marrin pjesë në komisione të ndryshme të ngritura në</i></p>




	<i>procese të ndryshme. GVJ mendon se ky standard përmbushet plotësisht.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës II	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Adresa: "Rruga e Durrësit"
 Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
 Tel:+355 (04) 222-43423

Web site: www.ascal.al

E-mail: info@ascal.al

III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT

Standardi III.1	
Institucioni i arsimit të lartë garanton procesin e të nxënit, aftësimin profesional e shkencor me metodat dhe praktikat më të mira me në qendër studentin, që sigurojnë arritjen e rezultateve.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Format e mësimdhënies, mësimnxënies dhe transmetimit të dijeve e njohurive janë leksionet, seminarët, punët laboratorike, detyrat e kursit/estetë, projektet, praktikat profesionale e klinike, orët e hapura dhe çdo formë tjetër e miratuar nga institucioni.</p>	<p><i>Neni 84</i> i Rregullores së UST përcakton qartë format e mësimdhënies, mësimnxënies dhe transmetimit të dijeve e njohurive tëk studentët. Sipas këtij neni, veprimtaritë formuese, që karakterizojnë këtë program studimi, përbëhen nga përberesit mësimore të cilët ndahen në:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Mesim në auditor, si leksione, seminare, ushtrime, ushtrime fizike në terrene sportive, laboratore, forma të kontrollit të vazhdueshem dhe seanca të praktikave profesionale, të zhvilluara në auditor; 2. Studim individual, si studim e punim relacionesh, detyrash apo projektesh; 3. Përgatitje për provime; 4. Përgatitje e tezës së diplomës; 5. Veprimtari të tjera, si praktika profesionale, praktikë në terren apo stazh pranë subjekteve publike ose private; <p>Ndarja e oreve mësimore në auditor ne orë për leksione, seminare, ushtrime e laboratore, përcaktohen në planin mësimor të programit të studimit. <i>Neni 4</i> i rregullores së programit të studimeve përcakton po ashtu veprimtaritë formuese të programit të studimit Bachelor në “Shkenca të Rehabilitimit”. Paralelisht, UST organizon rregullisht orë të hapura për rritjen e njohurive dhe aftësive të stafit akademik edhe studentëve.</p> <p><i>Ref. 4. Rregullorja e Programit te Studimit, neni 4;</i> <i>Ref. 8. Rregullorja e UST, neni 84;</i> <i>Ref. 36. Model, Plan Mësimor 2021-2022, Bachelor në “Shkenca të Rehabilitimit (Fizioterapi)”;</i> <i>Ref. 24. Tabela e Leksioneve te hapura;</i></p>
<p>Kriteri 2. Personeli akademik respekton dhe u përgjigjet larmisë dhe nevojave të studentëve, duke ofruar forma,</p>	<p>Institucioni referon se, personeli akademik respekton diversitetin e nevojave të studentëve duke operuar me forma, mënyra, metoda e mundësi alternative të mësimdhënies me qëllim gjithëpërfshirjen. Studentët kanë mundësi të marrin pjesë në konsultime që organizohen nga personeli akademik</p>

<p>mënyra, metoda e mundësi alternative të mësimdhënies e mësimnxënies.</p>	<p>për të përvetësuar konceptet themelore të lëndëve. Personeli akademik mundohet ti përgjigjet nevojave të studentëve duke u ofruar mënyra e metoda alternative të mësimdhënies. Pedagogët raportuan se leksionet i zhvillojnë duke përdorur mjete teknologjike (poëer point prezantime, videoprojektor, etj), ndërsa një pjesë të leksioneve i dërgon të detajuara edhe në forma alternative si ëord/pdf etj. Gjatë vizitës në UST u pa se klasat ishin të pajisura me videoprojektor. Paralelisht, u raportua se ata u ofrojnë studentëve edhe adresa elektronike e ëebbsite të cilat përfshijnë raporte, artikuj, si dhe gjëra të tjera të nevojshem të cilat ndihmojnë studentët në nevojat e tyre për të përmirësuar njohuritë dhe aftësitë e tyre në këtë fushë. Këto u konfirmuan dhe gjatë takimit me studentët.</p> <p><i>Vizitë në Institucion;</i></p>
<p>Kriteri 3. Institucioni mbështet personelin akademik në përmirësimin e kompetencave didaktike dhe në përputhje me rezultatet e pritshme të të nxënit.</p>	<p>Në vizitën në institucion të GVJ, Institucioni referon se mbështet dhe ofron mundësinë e mobilitetit të personelit akademik dhe ndihmës akademikë pranë universiteteve partnere, për përmirësimin e kompetencave didaktike. Në universitetet partnere, pedagogët kanë mundësi të trajnohen si dhe të zhvillojnë leksione. Pedagogë të departamentit kishin kryer vizita dhe mobilitete jashtë Shqipërisë. UST po ashtu organizon rregullisht ëorkshope dhe leksione të hapura të cilat u japin mundësinë pedagogëve të rrisin aftësitë e tyre didaktike.</p> <p><i>Institucioni nuk ka ndonjë plan specifik edhe/ose udhëzues për përmirësimin e kompetencave didaktike të personelit dhe GVJ sugjeron se hartimi i një plani të tillë do ishte pozitiv.</i></p> <p><i>Ref. 24. Tabela e Leksioneve te hapura;</i></p> <p><i>Vizita në Institucion;</i></p> <p><i>Dok. Shtesë: Listen e mobiliteteve (hyrëse dhe dalëse) të stafit akademik dhe studenteve (Nr. 2);</i></p>
<p>Kriteri 4. Personeli akademik i angazhuar në mësimdhënien në program është kompetent në shpjegimin e njohurive dhe koncepteve, përdor metoda të ndryshme të mësimdhënies interaktive dhe diskutime me në</p>	<p>Instituciononi referon se, ka të përcaktuara kriteret e detajuara për rekrutimet e personelit të angazhuar në mesimdhënien akademike si atë me kohë të plotë, por dhe ate me kohë të pjesshme. Institucioni ka miratuar rregullore specifike për rekrutimin e personelit akademik dhe ndihmës akademik ndërsa në takimin e zhvilluar me përfaqshues së Burimeve Njerëzore u raportua e gjithë procedura. Me qëllim rekrutimin e personelit akademik me kohë të plotë u raportua se gjatë intervistës së punësimit, zakonisht kandidatët prezantojnë një</p>

<p>qendër studentin, nxit te student mendimin krijues, atë kritik si dhe autonominë e përgjegjshmërinë</p> <p>Në të njëjtën kohë siguron udhëheqjen, mbështetjen dhe ndërtimin e marrëdhënieve të respektit të ndërsjellë mes tyre.</p>	<p>leksion pranë komisionit me qëllim të prezantojnë aftësitë e tyre didaktike. Përsa i përket personelit akademik të angazhuar në mësimdhënie nëse është kompetent në shpjegimin e njohurive e koncepteve dhe përdor metoda të ndryshme të mësimdhënies sipas tematikave dhe profilit, në vizitën që u bë në Institucion pedagogët referuan që mundoheshin ta zhvillonin leksionin në mënyrë interaktive me diskutime me referime të ndryshme. Paralelisht, studentët vlersojnë stafin dhe programin e studimeve përmes pyetësorit që zhvillohet. Studentët raportuan se gjatë leksioneve ata marrin pjesë në mënyrë aktive ndërsa pedagogët i përfshin në diskutime për çështje të lëndës.</p> <p><i>Ref. 37. Rregullorja e rekrutimit të personelit akademik, ndihmës akademik dhe administrative;</i></p> <p><i>Vizita në Institucion;</i></p>
<p>Kriteri 5. Njësia përgjegjëse për ofrimin e programit të studimit, vlerëson dhe përmirëson format e metodat e mësimdhënies në mënyrë periodike, duke përfshirë studentët në këtë proces dhe duke reflektuar mendimet e këshillat e tyre.</p>	<p>UST organizon periodikisht pyetësorin e studentëve me qëllim vlerësimin e pedagogëve. Në bazë të këtij aktiviteti merren masa të cilat pasqyrohen në raportin vjetor. Paralelisht, Drejtuesi i Njesisë Bazë përmes një instrumenti standard vlerëson pedagogët që japin leksion në këtë program studimi. <i>Pavarësisht këtyre, nuk u përmendën aktivitete specifike të tjerë për përmirësimin e mësimdhënies.</i></p> <p><i>Ref. 21. FSHR, BA, Model pyetësor i studenteve për të vlerësuar stafin;</i></p> <p><i>Ref. 22. Model pyetesori per vleresimin e stafit akademik nga pergjegjesi i departamentit;</i></p> <p><i>Ref. 23. Raportimi-i-NJSBC-per-muajin-Shtator-28.09.2022;</i></p> <p><i>Ref. 23.3. Rregullore per Sigurimin e Cilesisë;</i></p>
<p>Kriteri 6. Institucioni organizon struktura/ njësi në nivel institucional që promovojnë përmirësimin e vazhdueshëm të mësimdhënies, koordinojnë dhe bashkërendojnë me njësitë kryesore/bazë aktivitetet në kuadër të përmirësimit të cilësisë së mësimdhënies. Strukturat</p>	<p>Institucioni referon se, ka në përbërje të tij struktura akademike dhe ndihmës akademike me qëllim funksione të ndryshme përfshirë këtu kurrikulat, alumni, projektet, cilësinë etj. Në takimet e zhvilluara këto struktura nuk raportuan aktivitete specifike për përmirësimin e vazhdueshëm të mësimdhënies. Drejtorja e Marrëdhënieve me Jashtë, Publikun dhe Studentët raportoi aktivitete me zhvillimin e leksioneve të hapura dhe mobilitetin e pedagogëve. Nga ana tjetër, përfaqësuesit e Njesisë së Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë raportuan zhvillimin e pyetësorit si një nga aktivitetet kryesore për përmirësimin e mësimdhënies. Njësia në bazë të rregullores së vet bashkëpunon me Njësitë Kryesore/Bazë në procesin e</p>

<p>dhe njësitë përgjegjëse mbështesin eksperimentimin dhe zhvillimin e metodave të reja inovative të mësimdhënies, trajnojnë vazhdimisht personelin akademik për përmirësimin e aftësive të mësimdhënies dhe zbatimin të metodave të reja.</p>	<p>përmirësimin të mësimdhënies. Njësia Bazë përmes drejtuesit të departamentit mbështet përdorimin e metodave inovative, ndjek zhvillimin e orëve të mësimin nga pedagogët si dhe inkurajon studentët të raportojnë problematika të mundshme. Personeli akademik vlerësohet rregullisht edhe nga Drejtuesi i departamentit (jo vetëm për mësimdhënien) përmes një instrumenti të miratuar. <u>Angazhimi më i madh i strukturave ndihmësakademike është i nevojshëm në përmirësimin e vazhdueshëm të mësimdhënies.</u></p> <p><i>Ref. 8. Rregullorja e UST-së, neni 8;</i> <i>Ref. 31. Plan Veprim i NJSCB. Manuali i NJSBC;</i> <i>Vizita në Institucion;</i> <i>Dok. Shtesë: Formulari i vlerësimit të punedhënies.docx (Nr. 10);</i></p>			
<p>Konkluzione</p>	<p><i>Format e mësimdhënies, mësimnxënies dhe transmetimit të dijeve e njohurive janë leksionet, seminarët, punët laboratorike etj. Ndërsa pedagogët përdorin metoda alternative e inovative për mësimdhënien. Institucioni mbështet stafin akademik për përmirësimin e aftësive didaktike. <u>Hartimi i një plani specifik për këtë është e nevojshme sipas GVJ.</u></i></p> <p><i>Në kuadër të përmirësimit të mësimdhënies, UST organizon periodikisht pyetësorin e studentëve me qëllim vlerësimin e pedagogëve. GVJ mendon se ky standard përmbushet kryesisht.</i></p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
<p style="text-align: center;">X</p>				

<p>Standardi III.2</p>	
<p>Institucioni harton rregullore dhe procedura të posaçme të testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale dhe garanton zbatimin e tyre.</p>	
<p>Kriteret</p>	<p>Vlerësimi i ekspertëve</p>
<p>Kriteri 1. Kriteret dhe mënyra e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale përcaktohen në Rregulloren e programit të</p>	<p>Institucioni në rregulloren e vet ka përcaktuar qartë kriteret dhe mënyrën e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale. <i>Neni 81</i> i Rregullores së Institucionit paraqet qartë këtë ku thuhet se kontrolli i dijeve realizohet nëpërmjet testimeve, testeve me shkrim e me gojë, eseve, detyrave të kursit, punëve në grup, projekteve, prezantimeve, praktikave dhe tezave të diplomës. Kontrolli i dijeve shërben për</p>

<p>studimit/Rregulloren e Institucionit/rregullore të posaçme, bëhen publike dhe njihen nga studentët.</p>	<p>vlerësimin e progresit të studentit dhe mat përvetësimin e objektivave formuese e të kompetencave profesionale të programit nga studenti. Në rregulloren e programit të studimit përcaktohet se kontrolli i dijes së një lende, e cila realizohet gjatë sezonit të provimeve, mund të bëhet nëpërmjet: 1) Provimit me shkrim; 2) Provimit me gojë; 3) Vlerësimit të një projekti; 4) Kombinimit të formave të mësipërme: me shkrim, me gojë, me projekt.</p> <p>Format e kontrollit të dijeve (si punë laboratorike, praktikat ushtrimore, praktikat klinike punët laboratorike, konsultimet, praktikat profesionale, detyrat dhe projektet e kursit etj), reflektohen në grafiket përkates të detyrimeve, të cilet hartohen nga departamenti Kalendari i ketyre formave te kontrollit te dijeve shpallet jo me vone se dy jave pas fillimit te semestrit.</p> <p><i>Ref. 4. Rregullorja e Programit te Studimit, neni 13;</i> <i>Ref. 8. Rregullorja e UST-së, neni 81;</i></p>
<p>Kriteri 2. Në fillim të çdo lënde/moduli studentët informohen me metodologjinë e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore të parashikuara në syllabuset e lëndëve/moduleve nga titullari i lëndës/modulit.</p>	<p>Gjatë vizitës në institucion, në takimin me pedagogët, ata referuan se, në fillim të çdo semestri studentët njihen me syllabusin e lëndës, modulën në të cilin përcaktohen në mënyrë të detajuar mënyra e kontrollit dhe format, informohen me metodologjinë e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore të parashikuara në syllabuset e lëndëve/moduleve nga titullari i lëndës/modulit.</p> <p>Studentët po ashtu njihen me mënyrën e vlerësimit të dijeve, së bashku me afatet kur duhet të plotësohet secili detyrim deri në përfundim të zhvillimit të lëndës. Studentët po ashtu pohuan se gjatë fillimit të moduleve/lëndëve pedagogu respektiv i informon ata mbi metodologjinë e testimit e vlerësimit të njohurive.</p> <p><i>Vizita në Institucion;</i></p>
<p>Kriteri 3. Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore realizohet në forma dhe mënyra të ndryshme, duke i dhënë mundësi studentit të demonstrojë njohuritë dhe kompetencat e fituara.</p>	<p>Testimi i vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore realizohet në forma dhe mënyra të ndryshme, duke i dhënë mundësi studentit të demonstrojë njohuritë dhe kompetencat e fituara. Provimet zhvillohen me shkrim dhe në varësi të specifikave të lëndës, provimi mund të jetë dhe me gojë. Paralelisht, pedagogët në disa raste raportuan se gjatë zhvillimit të lëndës vlerësojnë studentët dhe performanca e tyre merret parasysh në notën përfundimtare të studentit. Po ashtu, disa pedagogë raportuan se u japin</p>

	<p>studentëve detyra kursi (individuale ose në grup) mbi të cilat ata vlerësohen.</p> <p><i>Syllabuset;</i></p> <p><i>Vizita në Institucion;</i></p>
<p>Kriteri 4. Njësia bazë/Personeli akademik vlerëson dhe përmirëson format e metodat e mësimdhënies në mënyrë periodike, duke përfshirë studentët në këtë proces dhe duke reflektuar mendimet e sugjerimet e tyre.</p>	<p>UST ka në përbërjen e vet Njësinë e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë. Ajo realizon periodikisht vlerësimin e pedagogëve nga studentët. Në përfundim të lëndëve studentët vlerësojnë pedagogun e lëndës duke dhënë rekomandimet respektive. Në përfundim të këtij procesi, Njësia harton një raport i cili i përcillet Rektorit të Institucionit. Paralelisht, format e metodat e mësimdhënies vlerësohen edhe nga drejtuesi i njësisë kryesore. U raportua se në bazë të rezultateve njësitë respektive mundohen të zgjidhin problematikat e ndryshme.</p> <p><u><i>Nuk u raportua hartimi i një plan veprimi specifik mbi rezultatet e këtyre metodave të vlerësimit.</i></u></p> <p><i>Ref. 4. Rregullorja e Programit të Studimit, neni 13;</i></p> <p><i>Ref. 8. Rregullorja e UST-së, neni 81;</i></p> <p><i>Vizita në Institucion;</i></p>
<p>Kriteri 5. Institucioni mundëson përdorimin e metodave të shumëllojshme dhe fleksible pedagogjike, të përshtatshme e në përputhje me rezultatet e pritshme të të nxënit, objektivat formues dhe kërkesat e punëdhënësve. Format dhe metodat e mësimdhënies inkurajojnë sensin e autonomisë të studentit, duke siguruar në të njëjtën kohë udhëzimin dhe mbështetjen nga mësimdhënësi dhe ndërtimin e marrëdhënieve të respektit të ndërsjellë mes tyre.</p>	<p>UST inkurajon përdorimin e metodave të shumëllojshme dhe fleksible pedagogjike. Këto metoda të ndryshme i japin mundësinë studentëve të rrisin njohuritë dhe aftësitë e tyre. Organizimi i leksioneve të hapura si dhe mobilitetet Erasmus i japin mundësinë stafit akademik të përmirësojë aftësitë akademike dhe didaktike si dhe ndërtimin e marrëdhënieve të respektit dhe mbështetjes së studentëve. Paralelisht, studentët kanë mbështetjen e pedagogëve të tyre në raste se ata kanë pyetje apo paqartësi.</p> <p><i>Ref. 24. Tabela e Leksioneve të hapura;</i></p> <p><i>Vizita në Institucion;</i></p>

Konkluzione	<i>Institucioni në rregulloren e vet ka përcaktuar qartë kriteret dhe mënyrën e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale. Në fillim të çdo semestri studentët njihen me syllabusin e lëndës, modulit në të cilin përcaktohen në mënyrë të detajuar mënyra e kontrollit dhe format. Testimi i vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore realizohet në forma dhe mënyra të ndryshme, duke i dhënë mundësi studentit të demonstrojë njohuritë dhe kompetencat e fituara. GVJ mendon se ky standard përmbushet plotësisht.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht	X

Standardi III.3	
Institucioni siguron vlerësim të drejtë dhe transparent, bazuar në meritën e çdo studenti duke përfshirë dhe procesin e ankimimit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale realizohet gjatë gjithë vitit akademik dhe reflektohet në vlerësimin përfundimtar, të parashikuara në syllabuset e lëndëve/moduleve nga titullari i lëndës/modulit.	Në rregulloren e programit të studimit përcaktohet se kontrolli i dijës së një lende, e cila realizohet gjatë sezonit të provimeve, mund të bëhet nëpërmjet: 1) Provimit me shkrim; 2) Provimit me gojë; 3) Vlerësimit të një projekti; 4) Kombinimit të formave të mësipërme: me shkrim, me gojë, me projekt. Në vizitën në Institucion GVJ mori informacion në lidhje me vlerësimin e njohurive të studentëve. Ata referuan se provimi përfundimtar ishte mënyra e vlerësimit të studentit. Ata referuan se ky provim kishte vlerësimi për performancën e studentit, provimi bëhet me shkrim por kishin pedagogë që preferonin provimin me gojë ose në mënyrë të kombinuar. Gjithashtu dhe detyrat e kursit ishin pjesë e vlerësimit përfundimtar të studentit. Syllabuset e pedagogëve prezantojnë qartë mënyrën se si do të zhvillohet testimi dhe vlerësimi i studentëve. <i>Ref. 4. Rregullorja e Programit të Studimit, neni 13; Vizita në Institucion;</i>
Kriteri 2. Institucioni vë në zbatim sisteme elektronike të testimit dhe vlerësimit, të cilat shmangin forma të ndryshme abuzimi dhe rrisin transparencën.	Institucioni përveç metodave tradicionale të testimit dhe vlerësimit ka filluar të përdorë dhe sisteme elektronike. Në kuadër të kësaj UST zbaton dhe sistemin e automatizuar të korigjimit të provimeve, në sajë të projektit CLEANSCORE të financuar nga AADF. Në takimin me pedagogët ata pohuan se nuk e kishin përdorur ende këtë sistem.

	<p><u>Implementimi i projektit CleanScore edhe në këtë program studimi është i nevojshëm.</u></p> <p><i>Ref. 33. Marrëveshja e bashkëpunim me “Fondacion Shqiptaro-Amerikan për Zhvillim”;</i></p> <p><i>Ref. 33.1. Per korrigjimin e provimeve me CleanScore;</i></p> <p><i>Vizita në Institucion;</i></p>
<p>Kriteri 3. Vlerësimi përfundimtar i lëndës bëhet në përputhje me syllabusin dhe bazën ligjore në fuqi.</p>	<p>Kontrolli përfundimtar i dijeve mund të zhvillohet me provim i cili mund të jetë testim fizik, test me shkrim; me gojë ose i kombinuar (me shkrim e gojë). Zgjedhja e formës së provimit bëhet nga pedagogu/et i lëndës, pasqyrohet në programin lendor (syllabus) dhe në rregulloren e program të studimit si dhe ju bëhet e ditur studentëve që në fillim të semestrit. Vlerësimi i njohurive të studentit bëhet duke përdorur sistemin shqiptar të vlerësimit me 10- të nota, nga 1-shi tek 10-ta, ku 10-ta është vlerësimi maksimal. Me këtë sistem bëhet vlerësimi në të gjitha format e kontrollit të përdorura. Nota minimale kaluese është 5 (pesë). Institucioni referon që, vlerësimi përfundimtar i lëndës bëhet në përputhje me syllabusin si dhe sipas rregullores së UST, rregullores së Njësisë Kryesore dhe rregullores së programit të studimeve. Pedagogët referuan se vlerësimi i studentëve zhvillohet në bazë të legjislacionit në fuqi ndërsa studentët raportuan se ai zhvillohet në bazë të syllabusit dhe asaj çfarë pedagogu i ka informuar në orën e parë të leksionit.</p> <p><i>Ref. 4. Rregullorja e Programit te Studimit, neni 13;</i></p> <p><i>Ref. 8. Rregullorja e UST-së, neni 82;</i></p> <p><i>Vizita në Institucion;</i></p> <p><i>Syllabuset;</i></p>
<p>Kriteri 4. Vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale shoqërohet me komente/feedback (nëse është i nevojshëm) dhe lidhet me këshilla mbi procesin e të nxënës për të ndihmuar studentin të përmirësohet në të ardhmen.</p>	<p>Pedagogu u bën me dije studentëve rezultatet e provimit në përfundim të provimit me gojë dhe për provimin me shkrim, brenda 5 ditëve pune nga data e zhvillimit të tij. Studentet informohen mbi rezultatet e provimit në librezën e tyre elektronike, por nëse nuk e kanë marrë këtë informacion për arsye të ndryshme, mund të informohen pranë sekretarisë. Në rastet se studentët kanë paqartësi mbi vlerësimin e tyre, mund të konsultohen me pedagogun e lëndës.</p> <p><i>Ref. 8. Rregullorja e UST-së, neni 104;</i></p>




<p>Kriteri 5. Njësitë përgjegjëse dhe personeli akademik shmangin/nuk lejojnë plagjiaturën, kopjimin në provime dhe detyra.</p>	<p>Provimet dhe riprovimet në të gjitha ciklet e studimeve zhvillohen sipas afateve të caktuara në strukturën e vitit akademik. Komisioni i provimit të një lende (moduli) përbehet nga jo më pak se dy vetë, nga të cilët njëri duhet të jetë pedagogu i ledes (modulit). Nëse titullari i lendes apo anëtari tjetër, për arsye madhore, nuk mund të marrin pjesë në provim, përgjegjësi i departamentit cakton me shkrim pedagogun që do t'i zëvendësojë. Ndalohet hyrja në provim e personave të jashtëm, qofshin dhe anëtarë të stafit akademik të universitetit, me perjashtim të drejtuesit të Departamentit, të Njësise Kryesore, anëtarëve të Rektoratit dhe personave të tjerë të autorizuar me shkrim nga dekani ose rektori për të kryer kontroll. Pedagogët referuan se nuk lejohet në asnjë moment kopjimi dhe komunikimi me student të tjerë si dhe në detyrat e kursit nuk lejojnë plagjiaturën. Student konsiderohet ngelës nëse kopjon ose mashtron me mjete ndihmëse jo të lejueshme (në këtë rast ai përjashtohet nga provimi).</p> <p><i>Ref. 8. Rregullorja e UST-së, neni 99, neni 102;</i> <i>Vizita në Institucion;</i></p>
<p>Kriteri 6. Rezultatet e kontrollit të dijeve dhe aftësive profesionale bazohen në meritë dhe jepen në kohë sipas përcaktimeve në rregulloret përkatëse.</p>	<p>Pedagogu u bën me dije studentëve rezultatet e provimit në përfundim të provimit me goje dhe për provimin me shkrim, brenda 5 ditëve pune nga data e zhvillimit të tij. Studentët vlerësohen në bazë të njohurive dhe aftësive të tyre të demonstruara në provim apo në praktikën e zhvilluar.</p> <p><i>Ref. 8. Rregullorja e UST-së, neni 104;</i></p>
<p>Kriteri 7. Institucioni garanton të drejtat e studentëve për t'u njohur me vlerësimin, kërkesën për rishikim të vlerësimit në përputhje me rregullat që përfshihen në statut, rregulloret dhe procedurat e vlerësimit.</p>	<p>Pedagogu u bën me dije studentëve rezultatet e provimit në përfundim të provimit me goje dhe për provimin me shkrim, brenda 5 ditëve pune nga data e zhvillimit të tij. Studentet informohen mbi rezultatet e provimit në librezën e tyre elektronike, por nëse nuk e kanë marrë këtë informacion për arsye të ndryshme, mund të informohen pranë sekretarisë. Sipas <i>nenit 102</i> të Rregullores së UST, studenti ka të drejtë të ankohet në rast se ndaj tij janë shkelur rregullat procedurale gjatë zhvillimit të provimit ose për vlerësim të pamërituar.</p> <p><i>Ref. 8. Rregullorja e UST-së, neni 102;</i></p>
<p>Kriteri 8. Çdo kërkesë, ankimim, shqyrtohet nga komisioni i vlerësimit dhe</p>	<p>Ankesa bëhet me shkrim brenda 2 ditëve të punës nga dita e shpalljes së rezultatit të provimit, dhe i drejtohet profesorit të lendës dhe dekanit të fakultetit. Dekani është autoriteti që</p>

më pas nga komisioni i posaçëm. Procedura e ndjekur duhet të jetë transparente për palët e përfshira, dokumentohet dhe arkivohet.

përcakton nëse ankesa e studentit është e drejtë apo jo dhe merr vendimin përkates brenda dy diteve të punes nëse studenti nuk bie dakord me vlerësimin e profesorit pas rishikimit të lëndes. Ky vendim është i formës së prerë. Në rast se vërtetohen praktika që bien ndesh me dispozitat e kësaj rregulloreje, atëherë, me propozimin e përgjegjësit të departamentit, dekani vendos për ndryshimin e komisionit të provimit dhe për ridhënien e provimit brenda ditës ose të nesërmen, pas përfundimit të tij.

Ref. 8. Rregullorja e UST-së, neni 102;

Konkluzione

Në rregulloren e programit të studimit përcaktohet se kontrolli i dijes së një lende, e cila realizohet gjatë sezonit të provimeve, mund të bëhet nëpërmjet: 1) Provimit me shkrim; 2) Provimit me gojë; 3) Vlerësimin të një projekti; 4) Kombinimit të formave të mësipërme. Institucioni përveç metodave tradicionale të testimit dhe vlerësimin ka filluar të përdorë dhe sisteme elektronike. Pedagogu u bën me dije studentëve rezultatet e provimit Brenda afateve të caktuara ndërsa studentët kanë të drejtën të ankimojnë vlerësimin në rast se konsiderojnë të padrejtë. GVJ mendon se ky standard përmbushet plotësisht.

Shkalla e përmbushjes së standardit	Nu	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht

Standardi III.4

Institucioni ngre struktura të posaçme në nivel institucional, të cilat promovojnë rritjen e vetëdijes për përmirësimin e cilësisë së mësimdhënies dhe mësimnxënies në programet e studimit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Programi i studimit duhet të garantojë thellimin e njohurive, të zhvillojë aftësitë profesionale dhe të veçanta të studentëve.	Programi i studimit Bachelor në "Shkenca të Rehabilitimit" garanton thellimin e njohurive dhe aftësive profesionale të studentëve. Ky program ka si objektivi të formojë profesionistë të pajisur me shprehitë bazë shkencore dhe praktike në fushën e rehabilitimit. Kursi i studimit të diplomes "Shkenca të Rehabilitimit", synon të formojë profesionistë që të jenë në gjendje të përballojnë futjen e metodave dhe teknologjive të reja e komplekse në fushën e rehabilitimit dhe ka për qëllim të formojë rehabilitues profesionistë me njohuri të thella për trupin e njeriut, për faktorët e ndryshëm që risin rrezikun për tu prekur nga semundje të ndryshme, llojet me kryesore të

	<p>dëmtimeve dhe procesin e parandalimit, rehabilitimit dhe permiresimit të aftësive lëvizore të jetës së përditshme, rehabilitimit pas demtimeve apo traumave të ndryshme fizike si aksidenteve në punë e jashtë punës, dëmtimeve sportive; dhe rehabilitimin nga semundje të ndryshme kronike si rehabilitim kardiak për pacient me semundje kardiovaskulare, rehabilitim fizik për të gjitha llojet e dëmtimeve të aparatit muskuloskeletor, etj. Programi i studimit i jep mundësinë studentëve të marrin njohuri teorike e praktike përmes lëndëve/moduleve të cilat ata zhvillojnë gjatë studimeve.</p> <p><i>Ref. 4. Rregullorja e Programit të Studimit;</i></p>
<p>Kriteri 2. Programi i studimit garanton zhvillimin e aftësive të veçanta në fushën e teknologjisë së informacionit, humane, sociale, komunikimit dhe ndërveprimit.</p>	<p>Programi i studimit u ofron mundësinë studentëve të marrin njohuri në fushën e biostatistikës dhe informatikës si dhe në fusha të veçanta të karakterit humane e sociale ku përfshihen lëndë si Psikologji Sportive, Psikopatologji në Sport dhe Gjuhë e huaj.</p> <p><i>Ref. 4. Rregullorja e Programit të Studimit;</i></p>
<p>Kriteri 3. Kompetencat dhe aftësitë që fiton studenti, të paraqitura në programin e studimit dhe syllabuset e çdo lënde, analizohen e shqyrtohen në përfundim të lëndës. Personeli akademik vë në pah çështjet më të rëndësishme dhe orienton studentët për zbatimin e tyre dhe për detyrimet përmblyëse.</p>	<p>Pedagogët gjatë vizitës së GVJ, referojnë se, në fund të semestrit, pas mbarimit të lëndës pedagogu përveçse mundëson që studentët të arrijnë aftësitë, gjithashtu dhe të njohin çështjet më të rëndësishme të trajtuara gjatë semestrit, të paraqitura në programin e studimit dhe syllabuset e secilës lënde. Studentët mund të zhvillojnë pyetje të ndryshme ndërsa pedagogët zakonisht i orjentojnë duke diskutuar me ta pikat më të rëndësishme.</p> <p><i>Vizita në Institucion;</i></p>
<p>Kriteri 4. Mësimdhënia realizohet mbi bazë kompetencash që t'u japë studentëve mundësi të zhvillojnë njohuritë e marra në laboratorë dhe praktikat profesionale. Personeli akademik mbështet diskutimet dhe punën në grup në</p>	<p>Studentët kanë mundësinë të aplikojnë njohuritë e marra në laboratore e praktika të cilat zhvillojnë gjatë studimeve të tyre. Pedagogët raportuan se ata inkurajojnë diskutimet dhe pjesëmarrjen aktive në klasë të studentëve ndërsa studentët e pohuan këtë gjatë takimit të zhvilluar. Orët e seminare zhvillohen në mënyrën e diskutimeve dhe punës në grup ku studentët mundohen të zgjidhin raste specifike të dhëna. Mobiliteti i studentëve është i mundur por deri në këtë moment nuk janë zhvilluar mobilitete. Pedagogët përmes pjesëmarrjes së</p>




interpretimin dhe zgjidhjen e problemeve/çështjeve të caktuara; krijon klimë të përshtatshme për zhvillimin e ideve inovative, studime të përparuara kërkimore e shkencore dhe i mbështet ato; ndërthur format e mësimdhënies me institucionet bashkëpunuese për të mundësuar dhe rritur mobilitetin e studentëve.	tyre në kërkime shkencore përmirsojnë njohuritë e tyre dhe mundohen të zhvillojnë studime të përparuara kërkimore. <i>Vizita në Institucion;</i> <i>Dok. Shtesë: Liste te konferencave shkencore te organizuara bashkeorganizuar edhe ose aktivitete shkencore.pdf (Nr. 5);</i>
--	---

Kriteri 5. Personeli akademik, efektiv dhe me kontratë, realizon orë të hapura dhe seminare mbi zhvillime të reja të shkencës dhe teknologjisë brenda/jashtë strukturës së programit të studimit.	Institucioni zhvillon orë të hapura rregullisht me akademik të spikatur brenda ose jashtë vendit. Këto takime u japin mundësinë stafit akademik por edhe studentëve të njihen me zhvillime të reja të shkencës dhe teknologjisë brenda dhe jashtë strukturës së programit specifik të studimeve. <i>Ref. 24. Tabela e Leksioneve te hapura;</i> <i>Vizita në Institucion;</i>
--	---

Konkluzione	Programi i studimit Bachelor në “Shkenca të Rehabilitimit” garanton thellimin e njohurive dhe aftësive profesionale të studentëve. Programi i studimit u ofron mundësinë studentëve të marrin njohuri në fushën e biostatistikës dhe informatikës si dhe në fusha të veçanta të karakterit humane e sociale. Orë të hapura organizohen rregullisht nga Institucioni me qëllim rritjen e njohurive dhe aftësive të studentëve. <i>GVJ mendon se ky standard përmbushet plotësisht.</i>
--------------------	---

Shkalla e përmbushjes së standardit	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X

Standardi III.5	
Institucioni ndjek një procedurë të qartë të detyrimeve përmbyllëse të studentit në programin e studimit dhe e pajis atë me dokumentacionin përkatës.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve

<p>Kriteri 1. Institucioni harton rregullore të posaçme për provimin i përgjithshëm përfundimtar ose punimin e diplomës. Në rregulloren e programit të studimit përcaktohet pragu i notës mesatare që i jep të drejtën studentit për punim diplome dhe e bën atë publike.</p>	<p>Sipas planit mësimor, për përfundimin e studimeve Bachelor në "Shkenca të Rehabilitimit", studentët duhet të japin provimin përfundimtar. Ky provim ka 6 kredite. Programi i provimit të përgjithshëm përfundimtar përfshin lëndë të ndryshme nga fushat kryesore që mbulon programi i studimit Bachelor në "Shkenca të Rehabilitimit". Provimi realizohet përpara një komisioni të posaçëm, të përberë nga pedagogë efektiv dhe të ftuar, të fushave që mbulon programi i provimit. Anëtarët e komisionit propozohen nga njesitë baze të cilët mbulojnë lëndët e përfshira në provimin e përgjithshëm, dhe miratohen nga drejtuesi i FSHR-se. Detaje mbi organizimin e provimit final prezantohen tek <i>neni 20</i> i Rregullores së programit të studimit. Nuk parashikohet punim diplome për përfundimin e studimeve Bachelor për këtë program studimi.</p> <p><i>Ref. 4. Rregullorja e Programit të Studimit, neni 20, neni 21;</i> <i>Ref. 36. Model, Plan Mësimor 2021-2022, Bachelor në "Shkencat e Rehabilitimit (Fizioterapi)";</i> <i>Ref. 44. Temat e Provimit të Përgjithshëm Përfundimtar;</i></p>
<p>Kriteri 2. Strukturat përgjegjëse dhe personeli akademik asistojnë studentët, duke vënë në dispozicion informacione, udhëzime dhe materialet e nevojshme në funksion të detyrimeve përmblyëse.</p>	<p>Njësia bazë përgjegjëse e programit të studimit organizon konsultime me studentët për tematika të ndryshme të programit të provimit sipas një grafiku të miratuar prej saj dhe të shpallur në mjediset publike. Paralelisht, studentët kanë mundësi të zhvillojnë pyetje dhe konsultime me pedagogët përkatës në bazë të nevojave që ata kanë. Po ashtu Njësia Bazë miraton dhe publikon lëndët dhe tematikat përkatëse të provimit të diplomimit në bachelor. Detaje jepen edhe tek <i>neni 20 dhe 21</i> i Rregullores së programit të studimit.</p> <p><i>Ref. 4. Rregullorja e Programit të Studimit, neni 20, neni 21;</i> <i>Ref. 44. Temat e Provimit të Përgjithshëm Përfundimtar;</i></p>
<p>Kriteri 3. Komisioni i posaçëm për administrimin e provimit final bazohet në testimin e njohuritë e dhëna gjatë gjithë viteve akademike, duke përfshirë të gjitha lëndët/ modulet në bazë të rëndësisë dhe peshës specifike.</p>	<p>Programi i provimit të përgjithshëm përfundimtar përfshin lëndë të ndryshme nga fushat kryesore që mbulon programi i studimit Bachelor në "Shkenca të Rehabilitimit". Teza e provimit përmban pyetje nga të gjitha fushat/lëndët që përfshihen në programin e provimit. Njësitë bazë të përfshira në provimin e përgjithshëm përfundimtar hartojnë fondin e pyetjeve dhe i depozitojnë në Departament të paktën një javë para fillimit të sezonit të provimit. Fondi i pyetjeve duhet të jetë rreth 10 herë më i madh se numri përkatës i pyetjeve që përmban teza në fushën përkatëse.</p> <p><i>Ref. 4. Rregullorja e Programit të Studimit, neni 20, neni 21;</i></p>

	<i>Ref. 44. Temat e Provimit të Përgjithshëm Përfundimtar;</i>
<p>Kriteri 4. Personeli akademik/ Udhëheqësi i diplomës orienton dhe ndihmon studentët në përcaktimin e temave të punimit të diplomës. Udhëheqësi asiston studentin në nxjerrjen e rezultateve, përpunimin e tyre, si dhe në punimin e diplomës sipas udhëzuesve të miratuar. Ai garanton cilësinë e rezultateve dhe miraton ose jo nëse punimi është i plotë për t'u paraqitur para komisionit.</p>	<p>Ky program studimi nuk parashikon hartimin e një teme diplome për përfundimin e studimeve.</p>
<p>Kriteri 5. Njësia bazë asiston studentët për kryerjen e matjeve, analizave, testeve në mjediset e institucionit apo jashtë tij në bazë të temave dhe fushës së studimit.</p>	<p>Ky program studimi nuk parashikon hartimin e një teme diplome për përfundimin e studimeve. Në takimet e zhvilluara në UST, stafi akademik po hoi se përfshin student në studime e kërkime shkencore të cilat ai realizon. Studentët përfshihen në procedura si mbledhje të dhënash, ose asistim në procese të ndryshme të kërkimit. Kjo u konfirmua edhe nga studentët në takimin e zhvilluar me ta.</p> <p><i>Vizita në Institucion;</i></p>
<p>Kriteri 6. Në përfundim të provimit të përgjithshëm përfundimtar ose të mbrojtjes së diplomës, studenti vlerësohet me notë.</p>	<p>Në përfundim të provimit të përgjithshëm studentit vlerësohet me notë. Nota është mesatarizim i vlerësimit që ka dhënë çdo anëtar i komisionit. Kur studentit vlerësohet me notë pozitive, FSHR e pajis studentin e sapodiplomuar me diplomën "Bachelor ne "Shkenca te Rehabilitimit të shoqëruar me suplementin. Në rast se studentit vlerësohet me notë negative në provimin e përgjithshëm përfundimtar, ai mund të rihijë në provim brenda një afati kohor të caktuar, por pa tejkaluar afatin maksimal të përcaktuar në komizën ligjore në fuqi.</p> <p><i>Ref. 4. Rregullorja e Programit të Studimit, neni 21;</i></p>
<p>Kriteri 7. Në përfundim të studimeve, studentit pajiset me diplomën dhe suplementin e diplomës, të miratuara nga ministria përgjegjëse për arsimin. Në përfundim të</p>	<p>Në përfundim të studimeve studentit pajiset me diplomën dhe suplementin e diplomës të miratuara nga MAS. Në rregulloren e UST <i>nenet 106 dhe 107</i> përcaktohen qartë këto si dhe në rregulloren e Njesisë Kryesore <i>neni 63</i>.</p>

studimeve, studentit i vihet në dispozicion kopje e plotë zyrtare e programit të studimit të zhvilluar.	<p><i>Ref. 4. Rregullorja e Programit të Studimit, neni 21; Ref. 8. Rregullorja e UST-së, neni 106, 107;</i></p> <p><i>Ref. 13. Modeli i Diplomës. FSHR. Bachelor në Shkencat e Rehabilitimit (Fizioterapi);</i></p> <p><i>Ref. 14. Suplementi i Diplomës. FSHR. Bachelor në Shkencat e Rehabilitimit (Fizioterapi);</i></p>			
Kriteri 8. Institucioni ruan në përputhje me legjislacionin në fuqi kopje të dokumentacionit të studentit dhe paraqet rast pas rasti informacione për studentin nëse kërkohen.	<p>Kopje e dokumentacionit ruhet në Institucion sipas legjislacionit në fuqi. Gjatë vizitës në UST, GVJ u informua dhe verifikoj në terren të gjithë dokumentacionin e disponueshëm që sekretaria mësimore kishte.</p> <p><i>Vizita në Institucion;</i></p>			
Konkluzione	<p><i>Për përfundimin e studimeve Bachelor në "Shkenca të Rehabilitimit, studentët duhet të japin provimin përfundimtar. Ky provim ka 6 kredite. Programi i provimit të përgjithshëm përfundimtar përfshin lëndë të ndryshme nga fushat kryesore që mbulon programi i studimit Bachelor në "Shkenca të Rehabilitimit". Procedura e organizimit të provimit është e pasqyruar në dokumentacionin e Institucionit. GVJ mendon se ky standard përmbushet plotësisht.</i></p>			
Shkalla e përmbushjes së standardit		Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës III		Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

IV. BURIMET NJERËZORE, FINANCIARE, INFRASTRUKTURA, LOGJISTIKA PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT

Standardi IV.1	
Personeli akademik që mbulon programin e studimit, përmbush standardet sasiore dhe ka kualifikimin e duhur e të posaçëm akademik në përputhje me fushën e programit për garantimin e standardeve të mësimdhënies të programit të studimit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Personeli akademik dhe ndihmës akademik, që angazhohet	GVJ gjatë vizitës në institucion si dhe në vëzhgimin e dokumentave konstaton se: personeli i angazhuar në zhvillimin e programit të studimit është me grada dhe tituj, dhe kualifikim

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

Web site: www.ascal.al

E-mail: info@ascal.al




në realizimin e programit të studimit, përmbushin kërkesat ligjore në fuqi, për nivelin e kualifikimit akademik, për drejtimin e programit, drejtimin dhe angazhimin në mbulimin e lëndëve/moduleve të programit, për fushën kërkimore ose eksperiencën praktike në përputhje me programin e studimit, natyrën dhe veçorinë e moduleve të tij.

të ciklit të dytë të studimeve, konform kërkesave të legjislacionit në fuqi, si edhe ka ekspertizën e nevojshme për zhvillimin e lëndëve ku është angazhuar. Personeli akademik i angazhuar për zhvillimin e lëndëve/moduleve është me grada e tituj, ose kualifikime të ciklit pasardhës (MSc.) Bazuar në DVV dhe informacionin e siguruar gjatë vizitës në IAL, GVJ konstaton se personeli akademik me kohë të plotë dhe me kohë të pjesshme i angazhuar në realizimin e programit të studimit Bachelor në “Shkenca të Rehabilitimit”, bazuar në tabelat 6.1-6.3 është: 1 – 6.3 është:

1. Për vitin akademik 2020- 2021 kanë dhënë mësim në këtë program studimi 10 pedagogë nga të cilët 7 PAE dhe 3 PAK (70 % /30 %)
2. Për vitin akademik 2021- 2022 kanë dhënë mësim në këtë program studimi 18 pedagogë nga të cilët 14 PAE dhe 4 PAK (77.7 % /22.3 %)
3. Për vitin akademik 2022 - 2023 kanë dhënë mësim në këtë program studimi 26 pedagogë nga të cilët 21 PAE dhe 5 PAK (80 % / 20 %):

Tituj/grada	2020 - 2021		2021 - 2022		2022 - 2023	
	PAE	PAK	PAE:	PAK:	PAE:	PAK:
Prof.Dr	1	0	2	0	1	0
Prof.As.Dr	0	0	1	0	2	0
Dr/PhD	3	1	6	3	8	2
Msc	3	2	5	1	10	3
Në total	7	3	14	4	21	5

Ndarja e lëndëve dhe ngarkesës mësimore është bërë në përputhje me fushën e ekspertizës të secilit prej tyre dhe specifikën e moduleve. Ref. Tabela 4 Gjithashtu, stafi akademik, është i përfshirë edhe në projektet e kërkimore kombëtare, që janë në përputhje me programin e studimit dhe ekspertizën e tyre të cilat mund të zhvillohen në kabinetet e Fiziotherapisë.

Ref. 11. Tabelat përmbledhëse për aneks RVB (Tabelat 1, 2,4dhe 6.1, 6.2, 6.3)

Kriteri 2. Personeli akademik efektiv duhet të mbulojë ngarkesën

Referuar informacionit të dhënë sipas tabelave 12.2 dhe 12.3, për ngarkesën mësimore të personelit akademik PAE dhe PAK

<p>mësimore për programin e studimit në përputhje me kornizën ligjore në fuqi.</p>	<p>rezultoi se raporti i ngarkesës mësimore (orë mësimore) PAE/PAK është si më poshtë:</p> <ul style="list-style-type: none"> • 2021-2022 92 % / 8 % • 2022-2023 95 % / 5 % <p>GVJ konstaton se, raporti personel akademik efektiv / student në nivel njësie kryesore për programin e studimit është rreth 1 me 35 studentë, raport ky në përputhje me standardin e shprehur në VKM Nr. 418, datë 10.05.2017, për fushën e Shkencave Mjekësore dhe Shëndetit.</p> <p><i>Ref. 11. Tabela përmbledhëse për aneks RVB (Tabela 12.2, 12.3)</i></p>
<p>Kriteri 3. Institucioni duhet të garantojë dhe të dëshmojë qëndrueshmërinë e personelit akademik efektiv të angazhuar në programin e studimit, për të gjithë periudhën e akreditimit, duke përfshirë kontratat e punësimit dhe mbulimin me sigurime shoqërore dhe shëndetësore.</p>	<p>GVJ gjatë vizitës në institucion dhe takimin me zyrën e burimeve njerëzore u konstatua se, institucioni ndjek procedura ligjore dhe transparente për rekrutimin dhe vlerësimin e personelit akademik efektiv të cilat janë të përfshira në Rregulloren për rekrutimin e personelit akademik. Pranë Zyrës së Burimeve Njerëzore ishte i gjithë dokumentacioni në lidhje me stafin akademik, atij ndihmës akademik dhe administrativ. Spas burimeve njerëzore punohet sipas Rregullosës së rekrutimit të personelit akademik, ndihmës akademik dhe administrativ. Model rekrutimi ju vu në dispozicion GVJ specifikisht një procedurë rekrutimi pedagog efektiv si më poshtë:</p> <p>Departamenti në baze të nevojave për staf, bazuar në programin dhe ngarkesën mësimore paraqet në dekanat kërkesën për staf, ku përcakton kriteret preferenciale, ndërsa institucioni përcakton kriteret e përgjithshme, pastaj përcillet kërkesa në Rektorat dhe më pas Burimet njerëzore e shpallin në faqen zyrtare kërkesën për këtë vend pune (me afatin e dorezimit të dokumentave, listën e dokumentave, kriteret preferenciale dhe kriteret e përgjithshme).</p> <p>I gjithë dokumentacioni dërgohet në institucion me postë; Zyra e burimeve njerëzore pas mbarimit të afatit të pranimit të dokumentave postare, hap zarfin dhe liston dokumentat për secilin kandidat (kush ka mangësi në dokumentacion në dosje nuk shqyrtohet). Institucioni ngre një komision Ad-HOC me 5 anëtar (1 nga rektorati, 2 nga dekanati, dhe 3 nga departamenti). Komisioni vlerëson të gjitha dosjet duke përpiluar një tabelë, bëhet rankimim dhe pastaj kalohet në intervistën me gojë që është një leksion në një nga gjuhët e BE (kryesisht anglisht). Pas shqyrtimit të dosjeve dhe intervistës shpallet fituesi i cili i dërgohet rektoratit për vazhdim procedure dhe lidhje kontrate.</p>




	<p>Burimet njerëzore informojnë të gjithë kandidatët, fitues dhe jo fitues për rezultatet e konkurimit. Dosja e PAE ruhet në zyrën e burimeve njerëzore, ndërsa për PAK ruhet në departament dhe plotësohen çdo vit me CV të re dhe aktivitete të ndryshme shkencore të realizuara nga çdo PAE apo PAK.</p> <p>Dosja përmban (CV, fotokopje e ID, raporti mjko-ligjor, lista e notave, diplomës, gradës, gjuhës së huaj të noterizuara, punime shkencore, dy referenca, vërtetim nëse ka qënë mësimdhënës, kontrata e lidhur me institucionin.</p> <p><i>Ref. 37. Rregullorja e rekrutimit të personelit akademik, ndihmës akademik dhe administrativ</i></p>
<p>Kriteri 4. Institucioni ndjek procedura rekrutimi dhe vlerësimi, mbështetur në kritere të përgjithshme dhe specifike të publikuara e që garantojnë të përzgjedhjen e personelit me nivelin e duhur të kualifikimit dhe në përputhje me natyrën, strukturën, modulet dhe përmbajtjen e programit të studimit.</p>	<p>Gjatë vizitës në institucion, takimit me drejtues të institucionit, zyrën e burimeve njerëzore GVJ-së, ju vendosën në dispozicion dosje të zgjedhura në mënyrë të rastësishme të stafit të rekrutuar në vite. U zgjodhën 2 dosje të PAE të vitit akademik 2021-2022. GVJ konstatoi se institucioni, harton procedura e kritere të posaçme e specifike për rekrutimin e personelit, të cilat janë pjesë e akteve rregullatore si dhe kodit të Punës së Republikës së Shqipërisë, kodin e Procedurave Administrative, LAL në Ligjin 80/2015, dhe Statutin e Rregulloret e UST-së. UST ka një strukturë të posaçme që merret me procedurën e rekrutimit të stafit (Zyra e Burimeve Njerëzore) dhe të gjitha vendet e lira ZBNJ i bën publike. Hapja e vendeve të lira për staf akademik bëhet bazuar në programin mësimor të diplomës Bsc në “Shkenca të Rehabilitimit”, ngarkesës mësimore, kohës vjetore të punës për personelin akademik në IAL-të publike ku përfshihen disa aspekte si: mësimdhënie; kërkim shkencor; kontribut institucional; kontribut profesional të stafit akademik. Kërkesa bëhet nga njësia bazë, dërgohet te dekani dhe më pas kërkesa dërgohet te rektori. Krahas kërkesës bëhen të qarta kriteret e përgjithëshme dhe specifike të kësaj kërkesë, moduli ku është i nevojshëm ky staf akademik. Përpilohen kriteret e pranimit, publikohen në faqen zyrtare on-line të institucionit së bashku me afatet e pranimit të dokumentacionit. Vëndi i lirë i punës shpallet në faqen zyrtare të institucionit dhe Buletinin e Njoftimeve Publike (APP). Dokumentat sipas deadline-ve pranohen vetëm me rrugë postare. Pastaj një komision add-hoc i ngritur nga Rektori i UST-së, vlerëson dosjet e kandidatëve, bëhet pikëzimi sipas një table dhe bazuar në pikët e grumbulluara si dhe prezantimin e një teme në gjuhë të huaj sipas modulit përkatës. Komisioni ad-hoc me 5 anëtar bazuar në këtë vlerësim bën renditjen e kandidatëve dhe shpallet fituesi. Informohet si kandidati fitues, por dhe kandidati/ët jo fitues, ku bëhet informimi dhe sqarimi për arsyen, pse nuk është</p>

		<p>i përzgjedhur. Pas shpalljes së fituesit i dërgohet rektoratit për vazhdim procedure dhe lidhje kontrate. Dosja e PAE ruhet në zyrën e burimeve njerëzore dhe përmban (CV europass, fotokopje e ID, raporti mjeko ligjor, lista e notave, diploma, grada, certifikat e gjuhës së huaj të noterizuara, punime shkencore, dy referenca, vërtetim nëse ka qënë mësimdhënës, kontrata e lidhur me institucionin).</p> <p><i>Ref. 7. Statuti i UST-së, Neni 53-57);</i></p> <p><i>Ref. 38. Model, Marrëveshje vjetore, Për organizimin e kohës vjetore të punës për personelin akademik në IAL-të publike. 2022-2023);</i></p> <p><i>Ref. 37. Rregullorja e rekrutimit të personelit akademik, ndihmës akademik dhe administrativ);</i></p> <p><i>Vizita në institucion;</i></p> <p><i>Dok. Shtesë: Kontratë pune, kohë të plotë dhe kohë të pjesshme.pdf (Nr. 3);</i></p>
<p>Kriteri 5. Institucioni siguron dhe garanton angazhimin e personelit ndihmës akademik të përshtatshëm dhe të mjaftueshëm për realizimin e orëve laboratorike dhe për mirëmbajtjen e laboratorëve e mjediseve të tjera mësimore, sipas natyrës specifike të programit të studimit.</p>		<p>GVJ gjatë takimit me drejtues të institucionit, takimin me stafin akademik dhe ndihmës akademik, konstatoi se, pranë çdo njësie bazë ka të angazhuar Personel Ndhmës Mësimor, përgjegjës për mirëmbajtjen e ambienteve laboratorike dhe ambienteve të tjera mësimore. Të drejtat dhe përgjegjësitë e personelit ndihmës mësimor janë të parashikuara në rregulloren e institucionit. Në rang fakultetit numërohen 3 (tre) personell ndihmës mësimor. Personel ndihmës mësimor në bashkëpunim me pedagogët e lëndëve siguron mirëmbajtjen e kabineteve për kryerjen e labortoreve, praktikave mësimore dhe bën grafik sipas orareve që të mos ketë mbivendosje të studentëve në të njëjtën orë. Performanca e tyre matet edhe me anë të pyetësorëve anonim që bëhen dy herë në vite, para sezonit të çdo semestri, si dhe performancës vjetore që bëhet nga shefi i Departamentit.</p> <p><i>Ref. 8. Rregullore e UST, Neni 28;</i></p> <p><i>Ref. 10. Rregullorja e FSHR, Neni 24;</i></p> <p><i>Ref.22. Model pyetësori për vlerësimin e personelit akademik dhe ndihmës akademik;</i></p> <p><i>Vizita në institucion;</i></p>
<p>Kriteri 6. Institucioni mbledh, ruan dhe përditëson çdo vit akademik të dhënat e personelit të angazhuar në programin e studimit, në</p>		<p>GVJ bazuar në RVB, dokumentacionin refrues të vënë në dispozicion si dhe takimit me drejtues të institucionit dhe Zyrën e Burimeve Njerëzore në Universitetin e Sporteve të Tiranës u konstatua se Zyra e Burimeve Njerëzore (ZBNJ) është njësia e ngarkuar me përgjegjësinë direkte për ruajtjen e të dhënave të personelit drejtues, akademik dhe administrativ. Zyra e BNJ</p>

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

Web site: www.asc.al

E-mail: info@asc.al




<p>përputhje me legjislacionin në fuqi për mbrojtjen e të dhënave personale. Këto të dhëna përfshijnë anëtarët e personelit akademik të përfshirë në program dhe të personit përgjegjës për organizimin e programit të studimit, angazhimin e çdo anëtari në çdo semestër dhe vit akademik, si dhe atë të personelit ndihmës dhe administrativ.</p>	<p>ruan dhe administron një informacion të hollësishëm për personelin. GVJ -së ju vunë në dispozicion nga Zyra e BNP, të dhënat të depozituara në formë të printuar dhe një pjesë e tyre dhe në formë elektronike. Pranë Zyrës së Burimeve Njerëzore gjendet i gjithë dokumentacioni në lidhje me stafin akademik efektiv, atij ndihmës dhe administrativ. Pranë zyrës së burimeve njerëzore ruhen dosjet e PAE, të cilat përcitësohen çdo fundviti akademik me aktivitetin shkencor dhe CV-të e stafit përkatës. Pranë departamenteve për 1 vit ruhet i gjithë dokumentacioni për personelin akademik me kontratë (PAK).</p> <p><i>Ref. 8. Rregullore e UST,</i></p> <p><i>Ref. 38. Model marrëveshje vjetore në IAL2022-2023</i></p> <p><i>Vizita në institucion</i></p>
<p>Kriteri 7. Institucioni, në marrëveshje e bashkëpunim me institucione të tjera të arsimit të lartë, përfaqësues biznesi e kompani, vë në dispozicion personelin e mjaftueshëm, të duhur e të kualifikuar për instruktimin, udhëheqjen dhe mbikëqyrjen e studentëve në praktikën profesionale, punimin e diplomës dhe veprimtari të tjera specifike sipas natyrës së programit të studimit.</p>	<p>GVJ gjatë vizitës në institucion konstatoi dhe ju vunë në dispozicion marrëveshje të bashkëpunimit me institucione të tjera të arsimit të lartë, sipas referencave përkatëse me: UMT, ZKM, marrëveshje bashkëpunimi me fondacionin Shqiptaro-Amerikan për zhvillim, SUT etj. Personeli akademik i institucionit mund të përmirësojë aftësitë e tij në mësimdhënie, kryesisht përmes periudhave të shkëmbimit të eksperiencës në universitete partnere, në kuadër të programeve Erasmus+, bashkëpunimeve me universitete e tjera si edhe përmes lektorëve të ftuar në kuadër të veprimtarive kualifikuese për stafin. Marrëveshje bashkëpunimi me universitete të huaja si: Mali i Zi, Poloni, Rumani, Budapest, Kasinos dhe Lazios Jugore, Rome, Itali, etj.</p> <p>GVJ bazuar në RVB, dokumentat si dhe vizita në institucion konstaton se FSHR vë në dispozicion personel të mjaftueshëm, të duhur e të kualifikuar për instruktimin, udhëheqjen dhe mbikëqyrjen e studentëve në praktikën profesionale me institucionet me të cilat ka marrëveshje bashkëpunimi. Studentët gjatë praktikave në këto institucione që kanë marrëveshje me UST, mbikëqyrjen nga stafi i rekrutuar (PAE/PAK/ mbikëqyrës të praktikave), dhe në fund paisen me një formular të performancës së praktikës, e cila i dorëzohet koordinatorit të programit Bsc “Shkencat e Rehabilitimit” dhe që ky formular i performancës së praktikave ndihmon edhe në vlerësimin me gojë që bëhet në institucion për lëndën e praktikës profesionale 1,2,3.</p> <p><i>Ref. 35. Marrëveshjet me Spitalet dhe Klinikat për realizimin e praktikave;</i></p>

	<p><i>Ref. 39. Marrëveshje bashkëpunimi me Universitete dhe organizata Shqiptare;</i></p> <p><i>Ref. 40. Marrëveshje bashkëpunimi me Universitete të huaja;</i></p> <p><i>Vizita në institucion;</i></p>			
<p>Kriter 8. Personeli mbikqyrës në ambientin pritës që angazhohet në realizimin e praktikave profesionale në bazë të marrëveshjeve, duhet të ndihmojë studentët në përmbushjen e detyrimeve /raportin përfundimtar të praktikës si dhe të marrë pjesë në procesin e vlerësimit të tyre për praktikën profesionale.</p>	<p>GVJ në takimin me stafin dhe me studentët u informua se, në kuadër të realizimit të praktikave klinike, UST dhe FSHR ka nënshkruar marrëveshje bashkëpunimi, sic u shprehëm edhe në kriterin 7, me qendra spitalore universitare, poliklinika dhe klinika private fizioterapie. Pedagogët përgjegjës për mbarëvatjen e këtyre praktikave në bashkëpunim me stafin e qendrave, ndihmojnë studentët në asimilimin sa më korrekt teorik e praktik të lëndëve praktike 1, 2, 3. Studentët priten në institucionet e kontraktuara nga mbikqyrësi (tutori i praktikës) dhe në fund të praktikës mbikqyrësi i praktikës plotëson një formular mbi performancën e studentit gjatë këtyre orëve të zhvilluara. Ky formular i plotësuar dhe firmosur i dorëzohet koordinatorit i cili ja jep komisionit që do të vlerësoj studentin për praktikën. Provimi është me gojë, para një komisioni që zgjidhet paraprakisht nga drejtuesi i departamentit dhe provimi i praktikës vlerësohet me notë. Paraprakisht studentit i jepet program i temave të praktikës.</p> <p><i>Ref. 35. Marrëveshjet me Spitalet dhe Klinikat për realizimin e praktikave;</i></p> <p><i>Takimi me studentët;</i></p> <p><i>Vizita në institucion;</i></p>			
<p>Konkluzione</p>	<p><i>GVJ konstaton se ky standart plotësohet pasi personeli akademik që mbulon programin e studimit, përmbush standardet sasiore dhe ka kualifikimin e duhur në përputhje me fushën e programit për garantimin e standardeve të mësimdhënies të programit të studimit. GVJ mendon se ky standart përmbushet plotësisht.</i></p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Në përmbushje</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				<p>X</p>

<p>Standardi IV.2</p> <p>Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion mjedise mësimore dhe infrastrukturën e përshtatshme për realizimin e procesit mësimdhënës të programit të studimit dhe për formimin praktik, të posaçme sipas natyrës dhe fushës së programit të studimit.</p>	
<p>Kriteret</p>	<p>Vlerësimi i ekspertëve</p>


Adresa: "Rruga e Durrësit"
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

Web site: www.ascal.al

E-mail: info@ascal.al






<p>Kriteri 1. Institucioni siguron mjediset e mjaftueshme dhe të përshtatshme për zhvillimin e veprimtarisë mësimore, në varësi të numrit të studentëve, grupeve mësimore, në përputhje me natyrën specifike të programit të studimit dhe moduleve përkatëse.</p>	<p>GVJ gjatë guidës në institucion vuri re se ky Institucion ka hapsirat e nevojshme për zhvillimin sa më bashkëkohor të programit mësimor si: Sallat e leksioneve, të seminareve, laboratorët, biblioteka, etj. Hapsirat mësimore janë pajisur me infrastrukturën e nevojshme didaktike për zhvillimin e leksioneve, seminareve, laboreve dhe orëve praktike. Sallat e leksioneve janë pajisur me PC dhe projektor për prezantimin e e leksioneve në Power Point.</p> <p><i>Vizita në institucion;</i></p>
<p>Kriteri 2. Mjediset mësimore si klasa, laboratorë, studio e mjedise të tjera, janë të pajisura me mjete elektronike dhe të teknologjisë së informacionit, që garantojnë realizimin e procesit mësimor teorik e praktik, përmes përdorimit të metodologjive e teknologjive bashkëkohore të mësimdhënies-mësimnxënies.</p>	<p>GVJ gjatë vizitës në institucion vuri re praninë e laboratorëve të posaçëm të rehabilitimit dhe të fizioterapisë. Këta laboratorë ishin të pajisur gjithsecili me pajisjet me të fundit të nevojshme për një mësimdhënie sa më interaktive dhe bashkëkohore (si psh. shkallët suedeze, pasqyra e posturës, lazer terapi, ultratingull, krevate rehabilitimi, infrared, etj). Gjithë kjo infrastrukturë është realizuar në vazhdimësi falë dhe rikonstruktionit përgjatë viteve në bazë të specifikave të programit të studimit Bsc në "Shkenca të Rehabilitimit", që ofron, i cili garanton infrastrukturën e nevojshme dhe cilësore për procesin e mësimdhënies dhe kryesisht të praktikave profesionale në këta laboratorë .</p> <p><i>Ref 26: Shkresa Nr 1584 Prot. 06/11/2018 (Të dhëna për infrastrukturën dhe labororet);</i></p> <p><i>Ref 26/2: Infrastruktura e laboratorëve, shtimi i laboratorit të rehabilitimit 2022(120 m2);</i></p> <p><i>Vizita në institucion;</i></p>
<p>Kriteri 3. Laboratorët, studiot, atelietë apo mjediset e tjera, sipas natyrës specifike të programit, përmbajnë aparaturat dhe mjetet e nevojshme e të përshtatshme për plotësimin e kërkesave të moduleve, aftësimin teorik e praktik dhe të objektivave formues të</p>	<p>GVJ gjatë guidës në institucion vuri re se: Laboratorët e ndryshëm si ai i anatomisë, laboratorit i fizioterapisë, laboratorit i rehabilitimit, laboratorit i biomekanikës, laboratorit biologjik dhe biokimik, laboratorit i fiziologjisë, sallat e fitnesit, palestrat, etj., janë të pajisur me pajisjet e nevojshme për zhvillimin e një procesi mësimor që përmbush objektivat formuese të lëndës specifike dhe të programit të studimit në përgjithësi. GVJ gjatë vizitës në laboratorin e biomekanikës, fiziologjisë, 2 laboreve të fizioterapisë konstatoi se ishin të pajisur me aparatura bashkëkohore sic u përmend dhe në kriterin e mësipërm, për të realizuar sa më cilësisht orët e praktikave dhe të laboreve.</p>




programit të studimit në tërësi.	<p>Ref 26: Shkresa Nr 1584 Prot. 06/11/2018 (Të dhëna për infrastrukturën dhe labororet);</p> <p>Ref 26/2: Infrastruktura e laboratorëve, shtimi i laboratorit të rehabilitimit 2022(120 m2);</p> <p>Vizita në institucion;</p>			
Kriteri 4. Institucioni i arsimit të lartë siguron së paku një laborator të teknologjisë së informacionit, të pajisur me programe profesionale sipas natyrës së programit të studimit që ofron.	<p>GVJ gjatë vizitës në institucion dhe bazuar në RVB konstatoi se, institucioni ka një laborator të informatikës (IT) i pajisur me 36 kompjutera me parametra teknike të standardeve bashkëkohore, ku janë instaluar të gjithë programet e nevojshme për të mundur zbatimin e programeve. Studentët kanë mundësi të realizojnë detyrat e kursit, të bëjnë praktika të ndryshme, si dhe aktivitete trajnuese në këtë laborator. Ky laborator ndihmon pedagogët/studentët të realizojnë punën e tyre kërkimore-shkencore dhe është në dispozicion gjatë gjithë orarit të punës.</p> <p>Vizita në institucion;</p>			
Konkluzione	<p>GVJ konkludon UST vë në dispozicion mjedise mësimore dhe infrastrukturën e përshtatshme për realizimin e procesit mësimdhënës të programit të studimit dhe për formimin praktik, të përshtatura me fushën e programit të studimit. GVJ mendon se ky standard përmbushet plotësisht.</p>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi IV.3	
IV.3 Programi i studimit duhet të përmbajë literaturën e nevojshme dhe të përditësuar në mbështetje të mësimdhënies dhe mjediset mbështetëse të mësimnxënies, (bibliotekën, mjedise të posaçme).	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Literatura bazë dhe ndihmëse e vënë në dispozicion të studentëve në gjuhën e programit të studimit (fizike dhe digjitale) garanton marrjen e dijeve dhe njohurive të nevojshme, të parashikuara në programin e studimit.	<p>GVJ bazuar në dokumentat e vëna në dispozicion, vizitën në institucion, në bibliotekë, takimin me stafin dhe studentët u informua se, studentët dhe stafi kanë në dispozicion një gamë të gjërë tekstesh fizike dhe on-line. Institucioni bazuar në planin mësimor/syllabuset sipas lëndëve të ndryshme ku kanë të përshkruar objektivat, temat, literaturën bazë të detyrueshme dhe literaturën e rekomanduar, përditësohen vazhdimisht librat fizik dhe on-line në bibliotekën e institucionit. Literatura e bibliotekës përditësohet bazuar në kërkesat e pedagogëve dhe të studentëve, çdo vit sipas ciklit të leksioneve që japin. Kërkesën për literaturën bazë dhe të rekomanduar e</p>

	<p>depozitajnë në Departament. Universiteti i Sporteve përveç literaturës fizike për të garantuar realizimin e njohurive dhe objektivave, të parashikuara në programin e studimit ka akses edhe në disa biblioteka online KOHA, u-library, ku studentët mund të lexojnë dhe të shkarkojnë shumë libra sipas udhëzimeve të pedagogëve të lëndëve dhe linkut që atyre ju jepet, sipas <i>Manual për përdorim i bibliotekës digitale</i>.</p> <p>Në bibliotekë ka një numër të madh librash të cilat janë kryesisht në dy gjuhë, anglisht dhe shqip dhe janë të grupuara sipas të lëndëve përkatëse.</p> <p><i>Ref. 27. Lista e teksteve periodikë, dhe literaturës, të përdorura si literaturë bazë dhe të rekomanduar;</i></p> <p><i>Ref. 11. Tabela përmbledhëse për aneks RVB (Tabela Nr. 17);</i></p> <p><i>Ref.30. Manual për përdorimin e bibliotekës digitale;</i></p> <p><i>Ref. 32. Model Programi Lënde. Lënda, Mjekësi Fizike, Diagnostikim, 2022-2023...pdf</i></p> <p><i>Vizita në institucion;</i></p>
<p>Kriteri 2. Njësia përgjegjëse duhet të raportojë përditësimet të literaturës me botime të viteve të fundit.</p>	<p>GVJ gjatë takimit me stafin dhe përgjegjësin e departamentit dhe vizitës në bibliotekë konstatoi se institucioni çdo vit prej buxhetit të institucionit të planifikuar për zërin Libra ekziston dhe Fondi i Bibliotekës i cili nevojitet për përditësimin e literaturës me botime të viteve të fundit. Në vitin 2020 kur është hapur diploma e programit të studimit Bachelor Shkenca të Rehabilitimit janë shtuar në fondin e bibliotekës edhe 179 tituj librash online dhe 278 libra. Në çdo vit në plan buxhetin e institucionit planifikohet edhe fondi për pasurimin e bibliotekës me libra dhe literaturë të 10 viteve të fundit.</p> <p>GVJ u informua se stafi akademik çdo fund viti akademik përditëson syllabusin, temat përkatëse, literaturën bazë dhe atë të rekomanduar, ciklin e leksioneve dhe bazuar në këtë përditësim bën dhe kërkesën për literaturë fizike apo on-line.</p> <p><i>Vizita në institucion;</i></p>
<p>Kriteri 3. Institucioni vë në dispozicion të studentëve bibliotekën mësimore, duke garantuar mundësinë e shfrytëzimit në mënyrë të barabartë nga studentët e programit të studimit.</p>	<p>GVJ konstatoi se UST vë në dispozicion të studentëve mjedise mbështetëse të mësimnxënies, bibliotekën mësimore. Biblioteka e UST-së është një hapësirë brenda mjedisve të universitetit. Ka një hapësirë prej 258.4 m² me 48 vende leximi. Përveç se hapësirë leximi, biblioteka shfrytëzohet nga studentët edhe për infrastrukturën kompjuterike përgjatë ditës në funksion të realizimit të detyrimeve të programit të studimit.</p> <p>Gjatë ditës dhe mbasditë sipas kërkesave të studentëve qëndron punonjësja e bibliotekës e cila vëzhgon dhe kujdeset për bibliotekën. Punonjësja e bibliotekës ka të rregjistruar të gjithë</p>

	<p>librat, të cilat ju vihen në dispozicion studentëve sipas kërkesave duke ju hapur një kartelë personale të bibliotekës.</p> <p>UST ka dhe një Manual për përdorimin e bibliotekës digjitale, ndësa KOHA dhe u-library mund të aksesohen kudo nga stafi dhe studentët e Universitetit të Sporteve. Studentët e pedagogët mund ta aksesojnë këtë bibliotekë pa pagesë përmes adresës së email.it të siguruar nga institucioni.</p> <p><i>Ref.30.Manual për përdorimine bibliotekës digjitale Vizita në institucion;</i></p>
<p>Kriteri 4. Biblioteka duhet të jetë e pajisur me fond fizik, si: tekste mësimore bazë, literaturë ndihmëse, e mjaftueshme në gjuhën shqipe dhe të huaja, libra apo revista shkencore të nevojshme, të mjaftueshme dhe e përshtatshme për mbulimin e të gjitha moduleve e veprimtarive mësimore sipas natyrës e specifikës së programit të studimit.</p>	<p>GVJ gjatë vizitës në institucion dhe takimin me stafin e bibliotekës u informua se Fondi i librave të bibliotekës numëron rreth 1442 tituj librash profesional sipas programeve të studimit, (në gjuhën shqipe dhe në gjuhë të huaj). Disa emra të librave profesionale ishin Anatomia, kinezologji, fiziologji, biomekanike, rehabilitimi në sporte, mjekësi sportive, rehabilitim në geriartri etj. Studentët dhe stafi akademik klanë të drejtë pa pagesë shfrytëzimin jo vetëm të literaturës fizike, por edhe on-line, për realizimin sa më të mirë të procesit mësimor dhe moduleve të programit Bsc “Shkencat e Rehabilitimit”.</p> <p>Biblioteka vihet në dispozicion të studentëve në orare shërbimi që janë në përshtatje me oraret e zhvillimit të procesit mësimor. Orari i Bibliotekës është 08:00-15:00, gjatë të cilit mund të shfrytëzohet nga studentët e të gjitha cikleve të studimit, pasi përkon me oraret e tyre të mësimi. Ky orar është i shkruar dhe në faqen zyrtare të fakultetit. Biblioteka për nevoja të studentëve në bazë të kërkesave të tyre, mund të shtyj orarin.</p> <p>Studentët dhe stafi kanë akses në revistat shkencore të universitetit që gjenden në web-site http://ust.edu.al/informacion-mbi-biblioteken/ të UST-së, në http://ust.edu.al/katalogu-online/ dhe http://ust.edu.al/foto-galeri/.</p> <p><i>Ref. 27. Lista e teksteve periodikë, dhe literaturës, të përdorura si literaturë bazë dhe të rekomanduar);</i></p> <p><i>Vizita në institucion;</i></p>
<p>Kriteri 5. Institucioni duhet të krijojë kushte për shfrytëzim të barabartë e pa pagesë për studentët në bibliotekat online të fushës së programit të studimit.</p>	<p>GVJ konstatoi se në të gjithë ambientet e UST, kishte internet wifi free dhe i aksesueshëm nga student dhe pedagogët e universitetit. Libraria është aktualisht e vetmja platformë online që shfrytëzohet nga studentët dhe pedagogët për të aksesuar, shkarkuar libra mësimore në format pdf, artikuj shkencorë, revista shkencore, etj. Studentët e pedagogët mund</p>

	<p>ta aksesojnë këtë bibliotekë pa pagesë përmes adresës së emailit të siguruar nga institucioni. UST i ofron stafit, studentëve U-Library, biblioteka online e ofruar nga Ministria e Arsimit Sportit në bashkëpunim me Universitetet publike shqiptare dhe Rrjetin Akademik Shqiptar.</p> <p>Studentët dhe stafi kanë akses edhe në revistat shkencore të universitetit që gjenden në web-site http://ust.edu.al/informacion-mbi-biblioteken/ të UST-së, në http://ust.edu.al/katalogu-online/ dhe http://ust.edu.al/foto-galeri.</p> <p><i>Ref. 11. Tabela përmbledhëse për aneks RVB (Tabela Nr. 17); Vizita në institucion;</i></p>
<p>Kriteri 6. Biblioteka duhet të jetë e pajisur me programe kompjuterike dhe pajisje të tjera teknike, që mundësojnë shfrytëzimin pa kufizim për të gjithë studentët.</p>	<p>Në takimin me studentët dhe stafin akademik, inspektimit të ambienteve të bibliotekës GVJ konstatoi, se institucioni ka një laborator të informatikës (IT) i pajisur me 36 kompjutera me parametra teknike të standardeve bashkëkohore, ku janë instaluar të gjithë programet të ndryshme, po ashtu edhe në bibliotekë ekziston një rrjet kompjuterik me programe specifike të lidhur në rrjetin LAN që bën të mundur aksesimin nga studentët e programit Bsc “Shkenca të Rehabilitimit”. Studentët gjatë qëndrimit në bibliotekë kanë mundësi të realizojnë detyrat e kursit, të bëjnë praktika të ndryshme, të marrin materiale didaktike nga pedagogët e tyre, të hedhura në rrjetin e brendshëm të UST. http://ust.edu.al/informacion-mbi-biblioteken/</p> <p><i>Vizita në institucion;</i></p>
<p>Kriteri 7. Biblioteka duhet të vihet në dispozicion të studentëve në orare shërbimi që janë në përshtatje me oraret e zhvillimit të procesit mësimor dhe përtej tyre, në përgjigje edhe të nevojave, numrit të studentëve dhe kapacitetit të saj.</p>	<p>GVJ në takimin me studentët dhe stafin akademik, stafin e bibliotekës si dhe inspektimit të ambienteve të bibliotekës konstatoi se biblioteka funksionon sipas një orari të paracaktuar, me grafik i cili afishohet në vende të dukshme, hidhet on-line në faqen zyrtare dhe informohen studentët. Orari i Bibliotekës është 08:00 - 15:00 nga dita e hënë deri ditën premte, gjatë të cilit mund të shfrytëzohet nga studentët e të gjitha cikleve të studimit, pasi përkon me oraret e tyre të mësimit. Ditët e pushimit, festive zyrtare nuk funksionon biblioteka fizike.</p> <p><i>Ref.30.Manual për përdorimin bibliotekës digjitale;</i></p> <p><i>Vizita në institucion;</i></p>
<p>Kriteri 8. Biblioteka dhe njësitë përgjegjëse të programit ndjekin dhe raportojnë për cilësinë e fondit fizik të bibliotekës</p>	<p>GVJ në takimin me drejtues të institucionit, me studentët me stafin akademik, me punonjësit e bibliotekës si inspektimit të ambienteve të bibliotekës vuri re një shfrytëzim maksimal të hapsirave të bibliotekës nga studentët dhe stafi akademik. Punonjësit e bibliotekës qëndrojnë në dispozicion të tyre për</p>

Adresa: “Rruga e Durrësit”
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

Web site: www.ascal.al

E-mail: info@ascal.al




<p>dhe fondit online (titujt kryesorë të pranishëm në shërbim të programit), përditësimin, shkallën e shfrytëzimit të fondit fizik dhe fondit online nga personeli akademik dhe studentët e programit, shfrytëzimi i sallave të studimit, duke nxjerrë në pah sa të efektshme kanë qenë përpjekjet për pasurimin e fondit fizik dhe atij online, cilat janë kërkesat për tituj, por edhe për performancën e personelit akademik.</p>	<p>hapjen e kartelave individuale për librat fizikë, ose për të ndihmuar në aksesimin online për literatura të ndryshme. GVJ u informua nga punonjësit e bibliotekës, se ata bëjnë raportin çdo fundviti mbi shfrytëzimin e kapaciteteve të bibliotekës, numrin e librave fizikë të qarkulluar nga studentët dhe stafi, shfrytëzimin e bibliotekës on-line, inventarizimin e librave fizikë si dhe kërkesa për fond bibliotekë (fizike dhe on-line), bazuar edhe në kërkesat e çdo departamenti sipas programeve, moduleve përkatëse. GVJ konstatoi se në raportin vjetor financiar ekziston dhe fondi i bibliotekës për zërin Libra, i cili miratohet nga Bordi i Administrimit.</p> <p><i>Ref. 27. Lista e teksteve periodikë, dhe literaturës, të përdorura si literaturë bazë dhe të rekomanduara;</i></p> <p><i>Vizita në institucion;</i></p>			
<p>Konkluzione</p>	<p><i>GVJ mendon se biblioteka e UST zotëron literaturë fizike dhe on line të nevojshme dhe të përditësuar në mbështetje të mësimdhënies si hapsirë të mjaftueshme në mbështetje të mësimnxënies, (bibliotekën, mjedise të posaçme). GVJ mendon se ky standard përmbushet plotësisht.</i></p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>		<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p> <p style="text-align: center;">X</p>

<p>Standardi IV.4</p>	
<p>Institucioni i arsimit të lartë disponon një sistem të brendshëm të menaxhimit institucional dhe e vë atë në dispozicion të administrimit, informimit dhe monitorimit të aktivitetit akademik, financiar e administrativ për programin e studimit.</p>	
<p>Kriteret</p>	<p>Vlerësimi i ekspertëve</p>
<p>Kriteri 1. Institucioni disponon sistem të menaxhimit nëpërmjet të cilit administrojnë të gjithë informacionin që lidhet me studentët dhe aktivitetin e tyre nga regjistrimi deri në diplomim në programin e studimit.</p>	<p>GVJ gjatë vizitës në institucion dhe takimin me sekretarinë mësimore u informua se, institucioni disponon sistem të menaxhimit dhe administrojnë të gjithë informacionin e studentëve nga regjistrimi deri në diplomim përmes sistemit PITAGORA në formë elektronike, por dhe me anë të rregjistrave nga momenti i regjistrimit deri në përmbylljen e plotë të programit të studimeve Bachelor. GVJ konstatoi se administrimi i informacionit të brendshëm kryhet jo vetëm nga Sistemi i PITAGORA në bashkëpunim me RASH, por dhe nga</p>

	<p>platforma on-line U-TRANSPARENCA, i cili është në bashkëpunim me AKSHI-n, me një kontratë pa limit.</p> <p><i>Ref. 11. Tabela përmbledhëse për aneks RVB (Tabela Nr. 17);</i></p> <p><i>Ref. 41. Akses online në systemin PITAGORA);</i></p> <p>https://ust.pitagora.rash.al/login?fac_id=10000</p> <p><i>Vizita në institucion;</i></p>
<p>Kriteri 2. Sistemi i brendshëm i menaxhimit administron informacionin, dokumentacionin dhe aktivitetin e personelit akademik, personelit ndihmësakademik, personelit administrativ dhe partnerëve të angazhuar në realizimin e programit.</p> <p>Kriteri 3. Sistemi i menaxhimit siguron akses të dedikuar në informacione e dokumente për të gjithë personelin dhe studentët e programit të studimit.</p>	<p>GVJ gjatë vizitës në institucion, takim me stafin e IT- së, studentët dhe stafin akademik të institucionit konstatoi se, sistemi për menaxhimin i Informacionit në institucion, si në cdo institucion të Arsimit të Lartë Publik realizohet nga Sistemi i PITAGORA.</p> <p>Ky sistem është i aksesueshëm nga, personeli akademik në ndihmë të procesit të mësimdhënies, studentët të cilëve ju mundëson përditësimin në kohë reale për procesin mësimor, vlerësime, frekuentim, programe lëndës, sylabusin etj.</p> <p>Në takimin me drejtues të institucionit si IT, GVJ u informua se institucioni është në proces të realizimit të një arkive digjitale për administimin e dokumentacionit të të gjitha drejtorive të UST-së. Po ashtu, GVJ gjatë vizitës në institucion konstatoi se sistemi Pitagorës është i aksesueshëm për, stafin akademik, ndihmës akademik, administratën kryesisht sekretarinë mësimore, studentët nga rregjistrimi në vitin e parë akademik deri në diplomim.</p> <p>Në sistem janë të hedhura të dhënat për strukturën akademike, të dhënat e studentit vlerësimet kohë pas kohe deri në diplomim pranimin. Sistemin elektronik të Pitgorës e përdor shumë dhe ndihmon në mbarëvajtjen dhe dokumentimin elektronik të punës edhe sekretaria mësimore, ku hedh të dhënat për studentët që nga regjistrimi, transferimet, vlerësimet sipas lëndëve dhe viteve, diplomimin etj. Drejtorja e financave ka akses në sistem për të dokumentuar menaxhimin e tarifave të programit të studimit; bursat;</p> <p><i>(Ref. 41. Akses online në systemin PITAGORA)</i></p> <p>https://ust.pitagora.rash.al/login?fac_id=10000</p> <p><i>Vizita në institucion;</i></p>
<p>Kriteri 4. Sistemi i menaxhimit ka të integruar platforma dhe module që mundësojnë forma të komunikimit interaktiv dhe shkëmbimit të</p>	<p>Gjatë guidës në institucion, në takimet e realizuara me stafin, studentët, sekretarinë, IT-in, GVJ konstatoi se institucioni për mbarëvajtjen e procesit mësimor, bashkëveprimin institucional staf akademik, ndihmës akademik, administratë dhe studentëve bëhet e mundur komunikimi dhe shkëmbimi i materialeve didaktike, publikimi i informacioneve të</p>


informacionit ndërmjet personelit akademik dhe studentëve.	ndryshme institucionale si: njoftime për pedagogët, apo dhe informacione të ndryshme midis pedagogut dhe studentëve. <i>Vizita në institucion;</i>			
Kriteri 5. Sistemi i menaxhimit garanton monitorim në kohë reale të aktivitetit akademik e administrativ dhe mundëson raportime individuale dhe të dhëna në kohë reale për organet dhe autoritetet drejtuese.	Në takimin me drejtues të institucionit dhe punonjësit e IT, u informuam se, sistemi i Pitagorës bën të mundur monitorimin e procesit të mësimdhënies, administrimin e provimeve dhe të vlerësimeve. Ky sistemi i menaxhimit garanton monitorim në kohë reale të aktivitetit akademik e administrativ dhe mundëson raportime individuale të çdo anëtarit të stafit akademik. Sistemi elektronik i informacionit gjithashtu shmanng vonesat në informim të studentëve për rezultatet e vlerësimit dhe rrit transparencën e mësimdhënies dhe të vlerësimeve përkatëse. Ky sistem me të dhënat e hedhura, gjithashtu ndihmon institucionin për një përpunim statistikor të të dhënave. <i>Vizita në institucion;</i>			
Kriteri 6. Informacionet që lidhen me programin e studimit, personelin akademik, aktivitetet e ndryshme, publikohen në faqen e internetit në të paktën dy gjuhë, ku njëra prej tyre është gjuha shqipe.	GVJ gjatë vizitës në institucion, takimit me stafin, studimin e faqes zyrtare të institucionit konstaton se, institucioni ka në administrim faqen zyrtare www.ust.edu.al dhe FSHR faqen zyrtare https://fshr.ust.edu.al informacioni në faqen zyrtare të institucionit është në gjuhën shqipe dhe po punohet për faqen zyrtare në gjuhën angleze. GVJ konstaton se institucioni, krahas sistemit të Pitagorës, përdor dhe platformën elektronike të U-Transparencës, e cila është një tjetër hapësirë elektronike ku shfaqen informacione dhe vendime të ndryshme të institucionit. <u><i>GVJ sygjeron ndërtimin e faqes edhe në gjuhën angleze të jetë sa më shpejt e disponueshme.</i></u> <i>Vizita në institucion;</i>			
Konkluzione	<i>GVJ bazuar në RVB, dokumentat e vëna në dispozicion si dhe guidën në institucion mendon se UST, disponon një sistem të brendshëm të menaxhimit institucional dhe e vë atë në dispozicion të administrimit, informimit dhe monitorimit të aktivitetit akademik, financiar e administrativ për programin e studimit. GVJ mendon se ky standard përmbushet plotësisht.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Përmbushet plotësisht	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht X




Standardi IV.5

Institucioni i arsimit të lartë garanton financimin dhe mbështetjen financiare të nevojshme për realizimin e procesit mësimor-kërkimor, mbarëvajtjen e programit të studimit dhe mbështetjen e studentëve.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni harton një raport financiar të kostove të njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit dhe planin për mbështetjen financiare të nevojshme për mbarëvajtjen e programeve të studimit për të paktën një cikël të plotë studimi.</p>	<p>GVJ bazuar në dokumentat e vëna në dispozicion, RVB, takimi me drejtues të njësisë kryesore dhe takimi me punonjësit e zyrës ekonomike, konstatoi se ekziston një raport financiar për mbulimin e shpenzimeve në nivel institucional i cili hartohet mbi bazën e kostove dhe financimeve. Tek financimet hyjnë granti i akorduar nga pushteti qendror dhe fondet jopublike. Granti i akorduar është i plotë dhe siguron financim për të gjithë programin e studimit BA, duke mbuluar kostot deri në përfundim të programit. Institucioni bazuar dhe në udhëzimet e MAS, garanton bursa për studentët ekselentë, po ashtu për studentët me prindër invalid ose ndihmë ekonomike. Shpenzimet për program të dytë studimi mbulohen nga tarifat e shkollimit. Të ardhurat e gjeneruara nga institucioni në formë tarifash shkollimi, donacionesh, sponsorizimesh, etj., shkojnë gjithashtu në mbështetje të programit të studimit duke siguruar infrastrukturë mbështetëse për procesin mësimor, si hapësira, mjete, pajisje e të tjera si këto. Institucioni bazuar dhe në udhëzimet e MAS, garanton bursa për studentët ekselentë, po ashtu për studentët me prindër invalid ose ndihmë ekonomike. Institucioni po ashtu mbështet financiarisht dhe pedagogët për kërkim shkencor edhe/ose publikim artikujsh dhe pjesmarrje në konferenca shkencore.</p> <p><i>Ref. 11. Tabela përmbledhëse për RVB (Tabela. Nr. 18);</i></p> <p><i>Vizita në institucion;</i></p> <p><i>Dok. Shtesë: Nje procedure rimbursimi pagese fee-je per publikim artikulli.pdf (Nr. 1);</i></p>
<p>Kriteri 2. Plani i financimit të njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit duhet të përmbajë financimin e burimeve njerëzore në shërbim të realizimit të programeve, shpenzimet operative për mirëmbajtjen e mjediseve dhe teknologjive mbështetëse të procesit mësimor,</p>	<p>Bazuar në RVB dhe refencat përkatëse, takimin me drejtuesit e njësisë kryesore GVJ, u informua se në çdo fillim viti financiar bëhet plani i financimit i njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit. Ky plan financiar duhet të përmbajë financimin e burimeve njerëzore për realizimin e programeve, shpenzimet operative për mirëmbajtjen e mjediseve dhe teknologjive mbështetëse të procesit mësimor, shpenzimet për bibliotekën dhe pasurimin e literaturës e aksesin në bibliotekat online, materiale dhe pajisje laboratorike etj. Ky plan financiar i dërgohet senatit të universitetit nga njësia kryesore, Senati Akademik miraton propozimin e Rektoratit, dhe ia kalon më pas Bordit të Administrimit për miratim. Bordi i Administrimit</p>




<p>shpenzimet për bibliotekën dhe pasurimin e literaturës e aksesin në bibliotekat online, detyrimet financiare, grantet vendase apo të huaja të përfituara dhe kontratat e shërbimeve të lidhura në funksion të realizimit të programeve të studimit, projektet dhe zëra të tjerë.</p>	<p>nga ana e tij miraton planin financiar dhe ngarkon Administratorin dhe Drejtorinë e Financës dhe Buxhetit për zbatimin e tij. Në takimin me përfaqësues të institucionit si dhe zyrën e finances GVJ u informua se aktualisht plani i financimit hartohet në nivel institucional. Është duke u punuar që në të ardhmen të hartohen plane financimi në rang programi studimi.</p> <p><u>GVJ sygjeron që të hartohen plane financimi në rang programi studimi.</u></p> <p><i>Ref. 11. Tabela përmbledhëse për RVB (Tabela. Nr. 18); Vizita në institucion;</i></p>
<p>Kriteri 3. Institucioni kryen auditim periodik, vlerëson dhe dokumenton gjendjen e financimit dhe efektivitetin financiar të tij.</p>	<p>GVJ në takimin me drejtuesit e institucionit u informua se institucioni harton pasqyra financiare të hollësishme brenda afateve të parashikuara dhe i gjithë ky aktivitet dokumentohet dhe i dërgohen për miratim MAS. I gjithë aktiviteti financiar i institucionit, është subjekt auditimi nga MAS. Institucioni bën auditim të brendshëm çdo fund viti dhe po ashtu pret auditim nga jashtë institucionit. Auditimi i brendshëm apo i jashtëm konsiston në zbatimin e sygjërimeve apo rekomandimeve të mëparshme. Raporti i auditit i përcillet edhe Bordit të Administrimit. Auditet në përgjithësi bëhen nga MAS, pothuaj çdo vit për infrastrukturën dhe financat. Audit i jashtëm është dhe vlerësimi nga ASCAL.</p> <p><i>Vizita në institucion;</i></p> <p><i>Dok. Shtesë: Dokument auditit.pdf (Nr. 7);</i></p>
<p>Kriteri 4. Institucioni raporton deri në nivelin e njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit mbi realizimin e buxhetit të miratuar të vitit paraardhës.</p>	<p>GVJ u informua në takimin me drejtuesit e institucionit se institucioni dorëzon në mënyrë periodike pasqyrat financiare në nivel institucional, por jo sipas programit të studimit. Plani financiar i hartuar parashikon financat që të garantojë vazhdimësinë e programeve të studimit.</p> <p>GVJ u informua se, në fund të çdo programi studimi, institucioni rishikon koston e një programi studimi, që mund të rezultojë në një ndryshim eventual të financimit. GVJ u informua se institucioni çdo fund viti pasi vlerëson koston e studimit dhe në bazë të vitit të mëparshëm propozon kuotat e studimeve për çdo program si dhe koston e studimeve përkatëse. Këto kuota dhe kosto propozohen nga njësitë bazë, dërgohen në njësinë kryesore dhe miratohen në senatin akademik.</p> <p><i>Vizita në institucion;</i></p>

<p>Kriteri 5. Institucioni garanton qëndrueshmërinë financiare për zhvillimin e programeve të studimit të njësisë bazë dhe kapacitetet financiare të mjaftueshme për ecurinë normale të këtyre programeve. Në rastet e nevojave të përmirësimit të situatës financiare institucioni planifikon ndërhyrje të posaçme dhe diversifikimin eventual të financimit të programeve të studimeve.</p>	<p>GVJ bazuar në RVB, referencat përkatëse si dhe takimin me drejtuesit e institucionit konstaton se institucioni garanton qëndrueshmërinë financiare për zhvillimin e programeve të studimit të njësisë bazë dhe kapacitetet financiare të mjaftueshme për ecurinë normale të këtyre programeve. Financat e institucionit varen nga buxheti i shtetit por dhe nga të ardhurat dytësore institucionale si, tarifa të ndryshme të studentëve, të cilat ndihmojnë në mbarëvajtjen e procesit mësimor si dhe në përmirësimin e infrastrukturës institucionale. GVJ në takimin me zyrën e financës u informua se institucioni garanton qëndrueshmëri financiare gjatë zhvillimit të programit të studimit.</p> <p><i>Vizita në institucion;</i></p>			
<p>Konkluzione</p>	<p><i>GVJ bazuar në RVB, guidën në institucion dhe referencat përkatëse mendon se institucioni i arsimit të lartë garanton financimin dhe mbështetjen financiare të nevojshme për realizimin e procesit mësimor-kërkimor, mbarëvajtjen e programit të studimit dhe mbështetjen e studentëve. GVJ mendon se ky standard përmbushet plotësisht.</i></p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p> <p style="text-align: center;">X</p>

<p>Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës IV</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p> <p style="text-align: center;">X</p>
---	-----------------------	------------------------------	-----------------------------	---


V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE

<p>Standardi V.1</p> <p>Institucioni i arsimit të lartë harton, ndjek dhe zbaton politika dhe procedura për pranimin, përzgjedhjen, përparimin e studentëve, transferimin, njohjen, vlerësimin e dijeve dhe diplomimin në programin e studimit.</p>	
<p>Kriteret</p>	<p>Vlerësimi i ekspertëve</p>
<p>Kriteri 1. Institucioni harton dhe zbaton politika dhe procedura që</p>	<p>GVJ gjatë bashkëbisedimit me drejtues të institucionit, studentët, koordinatorin e programit, sekretarinë mësimore, RVB, konstatoi se ky institucion harton politika dhe procedura</p>

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel: +355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al




mbulojnë ciklin e plotë akademik të studentëve nga hyrja në dalje, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe aktet e veta rregullatore.

të sakta gjatë vitit akademik të studentëve (në hyrje dhe në përfundim të studimeve), në përputhshmëri me legjislacionin në fuqi. Ndiqet një radhë pune si më poshtë: në bazë të udhëzimeve të nxjerra çdo vit nga Ministria e Arsimit dhe Sportit procesi i pranimeve në UST organizohet në përputhje me parashikimet e legjislacionit në fuqi. Pranimi në këtë program studimi është me numër të caktuar kuotash. Çdo vit senati i UST miraton kuotat e pranimit, kriteret e pranimit, vendet e disponueshme, për të gjitha kategoritë dhe publikohen në faqen e internetit të institucionit. Për sa më sipër kuotat për çdo kategori studentësh caktohen çdo vit dhe publikohen në faqen e internetit nëpërmjet njoftimeve të pranimit sipas Ligjit të Arsimit të Lartë në Shqipëri Nr. 80/2015 si dhe dhe udhëzimeve e vendimeve të nxjerra çdo vit nga Ministria Shqiptare e Arsimit dhe Sportit të cilat përcaktojnë procedura të regjistrimit dhe afatet përkatëse. Një kopje e këtyre vendimeve të Senatit Akademik në formë shkresore-letër dhe në formë elektronike dërgohet në MASR.

Procedurat e pranimit bëhen të njohura në faqen zyrtare të UST me anë të shpalljeve dhe njoftimeve të pranimit, të cilat përmbajnë informacione të hollësishme për vendet e disponueshme dhe kriteret e pranimit. Po ashtu në kuotat e pranimit, ka kuota të caktuara jo vetëm për shtetas të Shqipërisë dhe vendeve jo nga BE, kuota për transferime, të gjithë studentët të cilët duan të rregjistrohen në UST paracaktohen dhe miratohen nga senati. Kriter që duhet të plotësoj studentit është që të jetë me maturën shtetërore dhe not mesatare sa më të lartë, aktualisht nota më e ulët e pranimeve është 6.5 dhe më e larta 9.33. Studentët nga hyrja deri tek diplomimi i tyre është i rregulluar në bazë të akteve ligjore e nënligjore në fuqi të ardhura nga MAS, rregullores dhe statutit të institucionit, rregullores së fakultetit dhe rregullores së programit të studimit, të hartuara e të përditësuara vazhdimisht në përputhje të këtij legjislacioni. Institucioni dhe njësia përgjegjëse për ofrimin e programit kujdeset që të ndjekë ecurinë e studentit gjatë gjithë procesit, duke hartuar dhe zbatuar politika dhe procedura përkatëse.

Ref. 7. Statuti i UST-së;

Ref. 8. Rregullore e UST;

Ref. 10. Rregullorja e FSHR;

Vizita në institucion;

Kriteri 2. Politikat dhe procedurat nga hyrja në

Gjatë vizitës në institucion, në sekretarinë mësimore GVJ vuri re se ky institucion bazuar në Ligjin e Arsimit të Lartë

<p>dalje garantojnë barazinë dhe të drejta të njëjta për të gjithë kandidatët për studentë dhe studentët e programit të studimit.</p>	<p>Shqiptar, nr. 80/2015, statutin e UST siguron barazinë bazuar mbi kriteret dhe procedurat për të gjithë kandidatët për tu rregjistruar në Programin e Studimit të Diplomës “Bachelor” në “Shkenca të Rehabilitimit. Në takimin me sekretarinë konstatoam se ekzistonin rregjistra të cilat tregonin të gjithë praktikën e rregjistrimit apo të çrregjistrimit të studentëve fitues sipas kriterëve dhe portalit të studentit, pa bërë dallime se kujt i përkisnin këto kuota (student shqipëtar, Kosovës, Malit të Zi, Maqedonisë së Veriut). Pavarësisht këtyre kuotave të miratuara, në këto 3 vite nuk ka patur rregjistrime, po ashtu ka dhe kuota të miratuara dhe për personat me aftësi ndryshe, por përsëri nuk ka patur rregjistrime. Kjo tregon barazi institucionale për çdo student.</p> <p><i>Ref. 7. Statuti i UST-së;</i></p> <p><i>Ref.16.Kriteret e pranimit të studentëve. Vendim senati nr.21;</i></p> <p><i>Vizita në institucion;</i></p>
<p>Kriteri 3. Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kriteret të veçanta për përzgjedhjen e kandidatëve për t’u pranuar në programin e studimeve. Institucioni bashkëpunon me strukturat e ngritura në zbatim të maturës shtetërore, sipas ligjit dhe udhëzimeve përkatëse. Kriteret parashikojnë edhe regjistrimin e studentëve të huaj.</p>	<p>GVJ në takimin me stafin pedagogjik dhe studentet si dhe dokumentat e vena në dispozicion, u informua dhe konstatoi se para çdo viti akademik, në afatet e përcaktuara nga MASR organizohen “ditët e informimit të maturantëve” në gjimnazet kryesore të qarkut Tiranë dhe qarqet fqinje të cilat përbëjnë burimin kryesor të studentëve që ndjekin studimet në Fakultet. Stafi i ngarkuar për informim organizon takime, shpërndan fletëpalosje ku sqarohen të interesuarit me informacionin e nevojshëm për kriteret e pranimit apo për çështje të tjera të lidhura me të.</p> <p>Nga ana tjetër kriteret e përgjithshme dhe ato specifike janë lehtësisht të aksesueshme në web-in e UST. Kriteret dhe procedurat përkatëse për ofrimin e programit të studimit janë hartuar në mënyrë që të jenë të kuptueshme, dhe njëkohësisht të aksesueshme, çka i jep procesit transparencë të plotë. Kriteret dhe procedurat janë të aksesueshme online, i bëhen të ditura të interesuarve në zyrën e sekretarisë mësimore në oraret e përcaktuara për sqarime dhe shërbime dhe gjatë këshillimit e orientimit të ofruar nga zyra përgjegjëse në rang fakulteti e institucioni. Në fillim të çdo viti akademik realizohet procedura e regjistrimit dhe transferimit të studentëve sipas udhëzimeve dhe legjislacionit në fuqi.</p> <p><i>Website i programit të studimit. Bachelor – UST.</i></p> <p><i>Ref. 7. Statuti i UST-së;</i></p> <p><i>Ref. 8. Rregullore e UST;</i></p> <p><i>Ref. 10. Rregullorja e FSHR;</i></p>

<p>Kriteri 4. Kriteret, procedurat e pranimit dhe përzgjedhjes së studentëve, përparimit përgjatë kursit të studimit, të transferimit, njohjes së studimeve të mëparshme ose të pjeshme, të vlerësimit të dijeve dhe të diplomimit janë lehtësisht të kuptueshme dhe të aksesueshme nga publiku.</p>	<p><i>Vizita në institucion;</i></p> <p>GVJ bazuar në dokumentat e dorëzuar nga institucioni vëren se kriteret, procedurat e përzgjedhjes dhe pranimit të studentëve, përparimi përgjatë kursit të studimit, transferimi, njohja e studimeve të mëparshme ose të pjeshme, vlerësimi i dijeve dhe diplomimit janë lehtësisht të kuptueshme dhe të aksesueshme nga publiku pasi janë të përcaktuara në rregulloret e studimit të Fakultetit dhe departamentit si dhe online në <i>website i programit të studimit. Bachelor – UST.</i> Gjatë intervistës me studentët u konfirmua se institucioni ndjek një politikë të orientimit dhe këshillimit të tyre. Informacioni është i aksesueshëm nga burime si: sekretaria mësimore, faqja zyrtare (sistemi EMS) dhe QSHA, që japin informacione për çështje të ndryshme: procedurat e pranimit, transferimit, njohjes së studimeve të mëparshme, vlerësimit të diplomimit.</p> <p><i>Ref. 7. Statuti i UST-së;</i></p> <p><i>Ref. 8. Rregullore e UST;</i></p> <p><i>Ref. 10. Rregullorja e FSHR;</i></p> <p><i>Vizita në institucion</i></p>
<p>Kriteri 5. Përpara fillimit të çdo viti akademik, institucioni informon publikun dhe të interesuarit në lidhje me kërkesat e kriteret e përgjithshme e të veçanta të programit të studimit.</p>	<p>Përpara fillimit të çdo viti akademik institucioni merr pjesë në fushatat e informimit të organizuara nga Ministria e Arsimit dhe Sportit (open day), fletushka të ndryshme, marketing në studio dhe media të ndryshme, duke bërë informimin e publikut dhe të maturantëve të interesuar për diplomat që menaxhon UST-ja, programet, kuotat, kritret përkatëse, për çdo program studimi, përmes portalit U albania dhe faqes zyrtare të univesitetit</p> <p>GVJ u informua se, e gjithë procedura që nga aplikimi deri te pranimi i studentëve është publike dhe realizohet në mënyrë elektronike sipas vendimeve të MAS për pranimet e studentëve në nivel bachelor, bazuar në programet e maturës shtetërore, sipas raundeve përkatëse. Sistemi elektronik është i aksesueshëm për të gjithë të interesuarit. Informimi i të interesuarve për këtë program studimi duket qartë dhe në rritjen vit pas viti të studentëve të rregjistruar në programin e studimit Bsc “Shkenca të Rehabilitimit” në UST.</p> <p>Viti akademik 2020-2021 , 24 student.</p> <p>viti akademik 2021-2022 , 78 student.</p> <p>viti akademik 2022-2023 , 83 student.</p> <p><i>Ref. 8. Rregullore e UST;</i></p> <p><i>Ref. 10. Rregullorja e FSHR;</i></p>




	<i>Ref.16 .Vendimi i Senatit Akademik për kapacitetet 2022-2023 Vizita në institucion;</i>		
Kriteri 6. Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kriteret për përzgjedhjen e kandidatëve me aftësi të veçanta, të pakicave dhe shtresave të marginalizuara.	Bazuar në dokumentacionin e vënë në dispozicion nga institucioni, GVJ konkludon se institucioni parashikon kuota të posaçme dhe kriteret për përzgjedhjen e kandidatëve me aftësi të veçanta, të pakicave dhe shtresave të marginalizuara. <i>Ref. 8. Rregullore e UST; Ref. 10. Rregullorja e FSHR; Vizita në institucion;</i>		
Kriteri 7. Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kriteret për përzgjedhjen e kandidatëve nga shtete të tjera.	GVJ, gjatë vlerësimit konstatoi se UST harton dhe publikon kriteret dhe kuotat dhe përzgjedhjen për kandidatët nga shtetet e tjera. Institucioni informon përmes faqes zyrtare kriteret për përzgjedhjen e kandidatëve nga shtete të tjera përmes kuotave të vecanta. Institucioni para çdo viti akademik planifikon kuotat, kriteret sipas programit, infrastrukturës së institucionit, nr të stafit akademik pas propozimeve nga dekanati, kalojnë në rektorat dhe miratohen në senat dhe dërgohen për miratim në MAS . Propozimet e institucionit në vite janë :		
	Viti akademik 2021-2022	Viti akademik 2022-2023	Viti akademik 2023-2024
Kapaciteti pritëse	100	120	120
Shuma e Kuota	100	120	120
Shqiptar Brenda vendit	89	107	107
Program i II	2	2	1
Transferim studimesh	-	2	3
Të huaj	-	-	-
Status jetim	1	1	1
Persona me aftësi të kufizuar	1	1	1
Romë egjyptian	1	1	1
Kosovë	1	1	1
Mali I zi	1	1	1

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

Web site: www.ascal.al

E-mail: info@ascal.al

Maqedoni	1	1	1	
Preshevë	1	1	1	
Bujanovc	1	1	1	
Medvegjë	1	1	1	

Student të rregjistruar sipas viteve: Vrehet se kuotat nuk janë plotësuar sipas propozimeve të institucionit

Kuotat në vite akademike	Të rregjistruar	Nota mesatare	Të rregjistruar	Totali
2020-2021	25	7.77	1	24
2021-2022	87	7.31	4	83
2022-2023	80	7.31	2	78
Totali për 3 vite	192		7	185

Sygjerohet Të punohet më shumë me marketingun e kësaj diplome për plotësim të kuotave të propozuara

Ref.11. Tabelat përmbledhëse për aneks RVB. Cilësia në hyrje dhe në dalje të studentëve Tab.21;

Ref.16. Vendimi i Senatit Akademik për kapacitetet 2022-2023; Vizita në sekretari (rregjistrat themeltar të studentëve);

Kriteri 8. Institucioni harton politika të ndihmës/bursave për shtresa në nevojë dhe për të rritur cilësinë e pranimit në programe me përparësi për institucionin dhe për zhvillimin ekonomik të vendit.

GVJ bazuar në dokumentat e dorëzuar nga institucioni, takimi me stafin, sekretarinë mësimore, zyrën e burimeve njerëzore, konkludon se në fillimin e çdo viti akademik, realizohen procedurat përkatëse të ndihmës ekonomike dhe bursave për shtresat në nevojë, sipas udhëzimeve të ardhura nga MAS si dhe me vendim të Bordit të Administrimit UST.

Ref. 8. Rregullore e UST;

Ref. 10. Rregullorja e FSHR;

Vizita në institucion;

Konkluzione

GVJ bazuar në RVB, guidën në institucion mendon se UST harton, ndjek dhe zbaton politika dhe procedura për pranimin, përzgjedhjen, përparimin e studentëve, transferimin, njohjen, vlerësimin e dijeve dhe diplomimin në programin e studimit të Ciklit të Parë Bachelor në "Shkencat e Rehabilitimit"

	<i>(Fizioterapi)”. GVJ mendon se ky standard përmbushet plotësisht.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit		Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X


Standardi V.2	
Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve të programit të studimit, informacion të plotë e të hollësishëm mbi përparimin akademik, njohjen, vlerësimin e dijeve deri në përfundim të studimeve dhe diplomimit në atë program.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni vë në dispozicion informacion të plotë dhe të hollësishëm në lidhje me kriteret e procedurat e përparimit akademik të studentëve dhe kalimit nga një vit akademik në tjetrin.	<p>GVJ, referuar dokumentacionit të dorëzuar, rregullores së programit të studimit, faqes zyrtare të web si dhe takimit me përfaqësues të tij, konkludon se i gjithë informacioni i plotë dhe i hollësishëm gjendet në rregulloren mësimore të programit të studimit dhe aktet e tjera rregullatore. Gjatë takimit me studentët GVJ konstatoi se ata njihen me rezultatet e tyre nëpërmjet platformës online Pitagora.</p> <p>Studentët informohen në mënyrë të hollësishme për kohëzgjatjen e programit të studimeve si dhe mundësinë e transferimit të studimeve, instrumentat e realizimit të vlerësimit të njohurive për lëndë të ndryshme, komponentët përbërës të vlerësimit total të lëndës, organizimi i provimeve, realizimi i praktikave, diplomimi, ndërpreja dhe rifillimi i studimeve, etj. Studentët informohen edhe nëpërmjet posterave dhe takimet në ditët e hapura me maturanët. Po ashtu në ditën e parë të fillimit të vitit akademik studentët realizojnë takim me drejtues të fakultetit si dhe pedagogë ku ata kanë mundësinë të njohin infrastrukturën, auditorët, të drejtat dhe përgjegjësië, programin e studimit dhe modulet përkatëse etj. Institucioni vë në dispozicion sekretarinë mësimore, studenti akseson ecurinë akademike përmes llogarisë së tij në platformën Pitagora, ku ruhen të dhënat akademike ndër vite dhe studenti informohet për procedurat e përparimit akademik dhe kalimin nga një vit akademik në tjetrin.</p> <p><i>Ref. 8. Rregullore e Universitetit të Sporteve, Neni 60, pika 1);</i> <i>Ref. 7. Statuti i UST-së;</i> <i>Ref. 8. Rregullore e UST;</i> <i>Ref. 10. Rregullorja e FSHR;</i></p>

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel: +355 (04) 222-43423

Web site: www.ascal.al

E-mail: info@ascal.al

<p>Kriteri 2. Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e njohjeve të kualifikimeve të mëparshme ose studimeve të pjesshme.</p>	<p><i>Vizita në institucion</i></p> <p>U vlerësua nga GVJ se UST informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e njohjeve të kualifikimeve të mëparshme ose studimeve të pjesshme. Kjo realizohet nëpërmjet Drejtorisë së Kurrikulave dhe Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë. Sekretaria mësimore pranë njësisë kryesore (fakultetit) dhe Drejtoria e Kurrikulave dhe Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë informojnë studentët në lidhje me procedurat e njohjeve të kualifikimeve të mëparshme ose studimeve të pjesshme.</p> <p>Institucioni për të bërë të mundur ekuivalentimin e programeve të studimeve për studentët që duan të transferojnë studimet në UST, ngre një komision i cili bën ekuivalentimin e lëndëve bazuar në programin e studimit “Shkenca të Rehabilitimit” në UST. Studenti i cili dëshiron të transferojë studimet në UST, informohet për të gjitha procedurat, kriteret që ndiqen në rastin e transferimit të studimeve, ekuivalentimin dhe vitin në të cilin ky student i transferohen studimet.</p> <p><i>Ref. 8. Rregullore e UST;</i> <i>Ref. 8. Ibid. neni 78. pika 6. Mbi transferimet e studimeve)</i></p> <p><i>Vizita në institucion</i></p>
<p>Kriteri 3. Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e vlerësimit të dijeve e aftësive të studentëve në programin e studimit.</p>	<p>GVJ, gjatë vizitës në sekretarinë mësimore konstatoi se institucioni disponon dosjen personale (regjistrin) të çdo studentit, në të cilën janë të detajuara informacionet nga dita e regjistrimit deri te procedurat e vlerësimit të dijeve. Po ashtu rregullorja e institucionit parashikon elementet përbërës të vlerësimit dhe peshën specifike të tyre në raport me vlerësimin total, të cilat janë të reflektuara në programin dhe silabusin e lëndëve si vlerësimi për lëndët teorike: vlerësimi i detyrimeve të lëndës 10%, provimi i ndërmjetëm 20%, provimi përfundimtar 70%, vlerësimi për lëndët praktike: vlerësimi i detyrimeve të lëndës 30%, provimi praktik 35%, provimi përfundimtar 35%. Në fillim të vitit akademik, që ditën e parë pedagogu spjegon përmbajtjen e syllabusit të lëndës dhe studentëve u vihet në dispozicion, duke patur parasyshtemat, seminarët, provime të ndërmjetëme, provime praktike, detyrime lëndore dhe provimi përfundimtar.</p> <p><i>Ref. 8. Ibid., Neni 82, pika 1;</i> <i>Ref. 8. Rregullore e Universitetit të Sporteve, Neni 60, pika 1;</i> <i>Ref. 7. Statuti i UST-së;</i> <i>Ref. 8. Rregullore e UST;</i> <i>Ref. 10. Rregullorja e FSHR;</i></p>

	<p><i>Ref 32. Model program lende. Lenda Mjekësi fizike rehabilitim;</i></p> <p><i>Ref syllabusit sipas lëndëve nga 62-103;</i></p> <p><i>Vizita në institucion;</i></p>
<p>Kriteri 4. Institucioni i arsimit të lartë informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e punimit të diplomës dhe diplomimit në programin e studimit.</p>	<p>GVJ gjatë shqyrtimit të dokumentacionit të dorëzuar, RVB, guidës në institucion, konstatoi se UST ka hartuar rregulloren e studimeve. Programi i studimit "Bachelor në "Shkencat e Rehabilitimit" përfundon me provim përfundimtar në fund të vitit të tretë , pasi ka përmbyllur të gjitha detyrimet akademike dhe ekonomike. Provimi përfundimtar është i ndarë në një pjesë teorike dhe në një pjesë praktike. Në përputhje me afatet e përcaktuara në rregulloren e UST-së, departamenti përgjegjës në bashkërendim me Zyrën e Këshillimit, Informimit dhe Orientimit të Studentëve informon studentët për modalitetet e Provimit të Përgjithshëm Përfundimtar. Rregullorja e diplomimit, përcakton në mënyrë të detajuar procesin e diplomimit. Provimi përfundimtar bëhet për pjesën praktike dhe pjesën teorike. Provimi me shkrim (teorik) për lëndët mjekësore zë 30% dhe studentit i jepen paraprakisht temat e provimit. Ky provim bëhet me quize dhe korrigjohet me anë të sistemit Clean Score. 70% e provimit përfundimtar bëhet me gojë dhe përfshin pyetje nga lëndët profesionale dhe praktikat profesionale. Dhe për këto lëndë vendosen në dispozicion të studentëve temat përkatëse nga lëndët profesionale. Provimi përfundimtar bëhet përpara një komisioni të propozuar nga drejtuesi i departamentit dhe miratimin e dekanit. Nga vizita në institucion si dhe RVB konstatojmë se për herë të parë provimi i diplomës do të bëhet në korrik pasi është është diplomë e re dhe për herë të parë është hapur në vitin akademik 2020-2021.</p> <p><i>Ref. 7. Statuti i UST-së;</i></p> <p><i>Ref. 8. Rregullore e UST;</i></p> <p><i>Ref. 10. Rregullorja e FSHR;</i></p> <p><i>Ref. 8. Rregullore e Universitetit të Sporteve, Diplomi, neni 107;</i></p> <p><i>Ref.34. Model teze provimi përfundimtar;</i></p> <p><i>Ref.34/1 Temat e provimit të përgjithshëm përfundimtar;</i></p> <p><i>Ref.33/1 Për korrigjimin e provimeve me Clean Score. Vendim senati nr 25, date 16/02/2023;</i></p> <p><i>Vizita në institucion;</i></p>




<p>Kriteri 5. Përpara fillimit të çdo viti akademik dhe në mënyrë periodike, institucioni i arsimit të lartë publikon udhëzues të posaçëm dhe organizon takime të hapura për informimin e të interesuarve e studentëve të ardhshëm mbi programin e studimit.</p>	<p>GVJ konstatoi nga dokumentacioni se UST organizon takime të hapura për informimin e maturantëve për programin e studimit "Bachelor në "Shkenca të Rehabilitimit" "po ashtu ka publikuar një spot promovues për programin e studimit dhe fletëpalosje promovuese.</p> <p>Gjatë vizitave në institucion GVJ konstatoi se UST ka strukturë (Drejtoria juridike, Këshillimit të Karrierës dhe ALUMNI) që merret me gjurmimin e studentëve dhe organizimin e ditëve të hapura për informimin e studentëve të ardhshëm mbi programet e studimit. Takimet janë të organizuara (open day) dhe marrin pjesë pedagogët e njësisë bazë, anëtarë të personelit akademik, të cilët organizojnë takime periodike me nxënësit e shkollave të mesme. Përgjatë ditëve të regjistrimit, njësia kryesore vë në dispozicion të studentave të interesuar për të vazhduar studimet në programin e studimit Bachelor, grupe pedagogësh që japin informacionin e nevojshëm në lidhje me organizimin e programit të studimeve, kohëzgjatjen, rregulloren, mundësitë e punësimit dhe mundësitë e transferimit të studimeve në UST dhe nga UST tek universitetet me programe të ngjashme brënda dhe jashtë shtetit.</p> <p><i>Ref. 7. Statuti i UST-së;</i> <i>Ref. 8. Rregullore e UST;</i> <i>Ref. 10. Rregullorja e FSHR;</i> <i>Ref. 8. Rregullore e Universitetit të Sporteve, Diplomi, neni 107.</i> <i>Vizita në institucion</i></p>
---	---

Konkluzione GVJ bazuar në informacionin e vënë në dispozicion nga UST, konkludon se UST vë në dispozicion të studentëve të programit të studimit, informacion të plotë e të hollësishëm mbi përparimin akademik, njohjen, vlerësimin e dijeve deri në përfundim të studimeve dhe diplomimit në programin e studimit "Bachelor në "Shkenca të Rehabilitimit". GVJ mendon se ky standard përmbushet plotësisht.

Shkalla e përmbushjes së standardit	Jo	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi V.3

Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve informacion të plotë e të hollësishëm për objektivat formuese, strukturën, organizimin, përmbajtjen e programit të studimit, rezultatet e pritshme të të nxënit dhe mundësitë e punësimit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve								
<p>Kriteri 1. Studentët informohen në mënyrë të hollësishme për strukturën, organizimin dhe kohëzgjatjen e programit të studimit.</p>	<p>GVJ në bazë të dokumentave referuese, planet mësimore, rregullore, sttusit, takimit me drejtues te institucionit, sekretarine mësimore, studentët konstaton se, UST vendos në dispozicion të studentëve informacionin e nevojshëm rreth strukturës, organizimit të programit mësimor dhe kohëzgjatjes së programit të studimit. Informacionin studentët e marrin nëpërmjet takimeve me stafin akademik që i pret në institucion në momentin që interesohen për programet e studimit, nëpërmjet kontakteve me Zyrën e Këshillimit, Informimit dhe Orientimit të Studentëve, si dhe vënies në dispozicion të studentëve të rregullores së brendshme dhe rregullores së programit të studimit. Bazuar në programin e studimit dhe rregulloret e UST që ndihmojnë dhe rregullojnë realizimin e programit mësimor, studentëve ju bëhet me dije që: Programi ka 180 kredite, të ndara në 60 kredite për çdo vit akademik dhe çdo vit akademik i ndarë në 2 semestre (sem I+II) me nga 15 javë mësimore çdo semestër. Në takimin me komisionin e kurrikulave, bazuar në udhëzimin të MAS si dhe Rregulloren e UST në program vihet re se 1 kredit ekuivalentohet në orë mësimore si më poshtë:</p> <table border="1" data-bbox="582 1182 1361 1422"> <tr> <td>1 kredit leksion</td> <td>10 orë në auditor</td> </tr> <tr> <td>1 kredit seminar</td> <td>5 orë në auditor</td> </tr> <tr> <td>1 kredit laborator</td> <td>12 orë në auditor</td> </tr> <tr> <td>1 kredit praktike</td> <td>20 orë në auditor</td> </tr> </table> <p>Ditën e parë bëhet takim informues e orientues për të gjithë studentët për aspektet e programit të studimit. Në vazhdim sigurohet asistencë e posçame nga personeli ndihmës mësimor për familjarizimin e studentëve me procesin mësimor. Informacionet e hollësishme studentët i gjejnë dhe në sistemin on-line të Pitagorës.</p> <p><i>Ref. 7. Statuti i UST-së;</i> <i>Ref. 8. Rregullore e UST;</i> <i>Ref. 10. Rregullorja e FSHR;</i></p>	1 kredit leksion	10 orë në auditor	1 kredit seminar	5 orë në auditor	1 kredit laborator	12 orë në auditor	1 kredit praktike	20 orë në auditor
1 kredit leksion	10 orë në auditor								
1 kredit seminar	5 orë në auditor								
1 kredit laborator	12 orë në auditor								
1 kredit praktike	20 orë në auditor								




	<p><i>Ref. 8. Rregullore e Universitetit të Sporteve, Diplomi, neni 107;</i></p> <p><i>Ref.18. Plani mësimor I ngjashëm me FSHMT, UMT;</i></p> <p><i>Ref.131. Plani mësimor FSHR;</i></p> <p><i>Vizita në institucion;</i></p>
<p>Kriteri 2. Institucioni vë në dispozicion të studentëve informacion dhe dokumentacion/ udhëzues të posaçëm për lëndët/modulet, përmbajtjen dhe veprimtaritë formuese.</p>	<p>GVJ Bazuar në RVB, refrencat e vëna në dispozicion, takimin me drejtues të institucionit, takimi me stafin akademik, sekretarinë mësimore si dhe takimi me studentët mendon se: UST informon studentët në mënyrë të hollësishme për strukturën, organizimin dhe kohëzgjatjen e programit të studimeve dhe ve në dispozicion të tyre, informacion të posaçëm për modulet, lëndët, përmbajtjen dhe veprimtaritë formuese të programit të studimit "Bachelor në "Shkenca të Rehabilitimit". Studentët informohen në mënyrë të hollësishme për kohëzgjatjen e programit të studimeve edhe nëpërmjet web-it.</p> <p>Çdo fillim viti akademik në faqen web të UST dhe FSHR, në hapësirën e fakultetit që ofron programin e studimit bëhet publike struktura e vitit akademik. Informacioni i nevojshëm publikohet në format letër, guida, rregullore dhe fletëpalosje, si dhe elektronikisht. Në formë të detajuar studentët kanë akses mbi ngarkesat, temat për çdo javë mësimore dhe literaturat e detyrueshme dhe ato të rekomanduara, detyrat apo diskutime të ndryshme, kreditet përkatëse, të cilat janë të shprehura qartë dhe në syllabuset e lëndëve të ndryshme. Studenti i akseson të gjitha të dhënat nëpërmjet llogarisë të dedikuar të sistemit të Pitagorës dhe faqes zyrtare on-line të UST. Studentët asistohen gjatë gjithë kohës nga stafi pedagogjik dhe sekretaria mësimore për çdo paqartësi. Institucioni vë në dispozicion të studentëve informacione nga sekretaria mësimore nga faqja zyrtare, nga pedagogët për lëndët/modulet, përmbajtjen dhe veprimtaritë formuese. Informacionet gjenden edhe të afishuara në stendat e holleve të universitetit. Në fillim të çdo semestri, studentëve u vihet në dispozicion orari dhe ngarkesa mësimore semestrale. Po ashtu në orën e parë studentët marrin info të detajuar nga pedagogët e lëndëve për syllabusin përkatës ku shprehen qartë: kreditet, kodi lëndor, raporti lexion/ seminar/ laborator/ praktik, temat, literaturë bazë dhe literaturën e rekomanduar, format e kontrollit dhe vlerësimit, detyrimet për lëndën (projekte, detyra kursi), niveli i detyrueshëm i frekuentimit të lëndës etj.</p> <p><i>Ref. 42. FSHR. Struktura Mësimore, 2022-2023. Bachelor;</i></p>




	<p><i>Ref. 41. Aksesi online në systemin PITAGORA) https://ust.pitagora.rash.al/login?fac_id=10000;</i></p> <p><i>Ref.131. Plani mësimor FSHR;</i></p> <p><i>Ref 32. Model program lende. Lenda Mjekësi fizike rehabilitim;</i></p> <p><i>Ref syllabuset sipas lëndëve nga 62-103;</i></p> <p><i>Ref.131. Plani mësimor FSHR;</i></p> <p><i>Vizita në institucion;</i></p>
<p>Kriteri 3. Institucioni informon studentët mbi mundësitë e punësimit, si dhe mbështetjen institucionale për orientimin drejt dhe në tregun e punës.</p>	<p>GVJ bazuar në dokumentacionin e vënë në dispozicion, dhe gjatë takimeve në institucion, konstaton se UST, informon studentët në mënyrë të vazhdueshme për tregun e punës dhe kriteret e tij. Institucioni i kushton një vëmendje të veçantë orientimit të studentëve drejt tregut të punës, si në rang universiteti nëpërmjet Drejtorisë së Koordinimit, Marrëdhënive me Jashtë, Këshillimit të Karrierës, Alumni, ashtu si edhe Zyrës së Këshillimit, Informimit dhe Orientimit të Studentëve. Zyra e Këshillimit të Karrierës dhe ALUMNI janë dy zyra të institucionit të cilat u japin studentëve informacione mbi mundësinë e punësimit. Nëpërmjet organizimit të praktikave mësimore në institucionet partnere, studentëve me performancën më të mirë u ofrohet mundësi punësimi reale ose projektet bashkëpunuese me UST. Përmes aktiviteteve të vazhdueshme të sektorit të alumnit, studentët kanë mundësi të marrin informacione dhe orjentim mbi tregun e punës.</p> <p><i>Ref. 24. Kalendari i Aktiviteteve FSHR për vitet 2020-2022 (Leksionet e hapura të zhvilluar nga pedagogë të huaj;</i></p> <p><i>Vizita në institucion;</i></p> <p><i>Dok. Shtesë: Liste te aktiviteteve te sektorit te alumnit.pdf (Nr. 6);</i></p>
<p>Kriteri 4. Studentëve u vihet në dispozicion informacion i gjerë dhe i përditësuar për zhvillimin dhe organizimin e procesit mësimor, logjistikën, infrastrukturën dhe shërbimet në funksion të realizimit të tij.</p>	<p>GVJ referuar dokumentacionit të dorëzuar, faqes zyrtare web të UST dhe FSHR, si dhe vizitës në institucion, konkludon se studentëve, nëpërmjet web-it, sekretarisë mësimore dhe stafit akademik, në mënyrë të vazhdueshme u vihet në dispozicion informacion i gjerë dhe i përditësuar mbi zhvillimin dhe organizimin e procesit mësimor. Këtë informacion studentëve ju prezantojnë që ditën e parë pedagogët e lëndëve në auditor, por jo vetëm, studentët marrin informacionin e nevojshëm në stendën informuese të institucionit, e cila gjendet në hollin kryesor në hyrje të godinës, në një pozicion lehtësisht të aksesueshëm nga ata. Informacioni i stendës përditësohet rregullisht me ndryshimet dhe njoftimet më të fundit. Faqja web dhe llogaritë në rrjetet sociale të universitetit dhe fakultetit</p>

	<p>janë një tjetër mjet për përditësimin e informacionit në kohë reale.</p> <p><i>Ref. 42. FSHR. Struktura Mësimore, 2022-2023. Bachelor;</i></p> <p><i>Ref. 41. Akses online në systemin PITAGORA)</i> https://ust.pitagora.rash.al/login?fac_id=10000;</p> <p><i>Vizita në institucion;</i></p>			
<p>Kriteri 5. Informacioni në lidhje me programin e studimit mundësohet përmes sistemit të menaxhimit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jetë lehtësisht i arritshëm nga studentët edhe në distancë.</p>	<p>Nga takimi me studentët GVJ konstanton se UST vë në dispozicion të studentëve informacionin, dokumentacionin dhe udhëzues të posaçëm për lëndët dhe veprimtarinë formuese të cilat shprehen qartë dhe në syllabuset e lëndëve të programit Bachelor në “Shkenca të Rehabilitimit”. Studenti i akseson të dhënat nëpërmjet llogarisë personale (portali i studentit) në platformën Pitagora, që ata marrin në momentin e regjistrimit në UST nga Zyra e IT, nga ku nga ku kanë të drejtë të futen në Sistemin e Menaxhimit të Informacionit. Edhe në distancë, online përmes platformës studentët mund të shohin të dhënat në lidhje me programin e studimit, si edhe të komunikojnë me mesazhe me pedagogët e lëndëve dhe moduleve.</p> <p><i>Ref. 41. Akses online në systemin PITAGORA)</i> https://ust.pitagora.rash.al/login?fac_id=10000;</p> <p><i>Vizita në institucion;</i></p>			
<p>Konkluzione</p>	<p><i>GVJ bazuar në RVB, guidën dhe takimet në institucion mendon se ky institucion vë në dispozicion të studentëve informacion të plotë e të hollësishëm për përmbajtjen e programit të studimit, objektivat, strukturën, organizimin, rezultatet e pritshme të të nxënit dhe mundësitë e punësimit. GVJ mendon se ky standard përmbushet plotësisht.</i></p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Plotërisht</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				<p>X</p>

Standardi V.4

Institucioni i arsimit të lartë mbledh, administron, përditëson dhe ruan të dhëna të hollësishme në lidhje me numrin e profilin e studentëve që ndjekin programin e studimit, nga pranimi deri në diplomim, si dhe të dhëna të punësimit të tyre.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni i arsimit të lartë disponon dhe mban statistika vjetore për numrin e studentëve e</p>	<p>GVJ gjatë takimit me punonjëset e sekretarisë mësimore, punonjësit e Këshillimit të Karrierës dhe ALUMNI-t, si dhe pas kqyrjes së dokumentacionit të vënë në dispozicion, konstatoi se, Institucioni me anë të zyrës së Këshillimit të</p>

të diplomuarve, në programin e studimit.

Karrierës dhe ALUMNI asiston në gjurmimin e studentëve dhe për këtë ka krijuar një databazë të të dhënave të gjurmimit të studentëve, e cila përditësohet me të dhëna çdo vit. Institucioni disponon dhe mban statistika të lidhura me numrin e studentëve që vendosin të ndjekin programin "Bachelor" në "Shkenca të Rehabilitimit, dhe sigurisht edhe për studentët që do të diplomohen përfshirë këtu edhe nivelin edhe cilësinë e tyre në përfundim të studimeve. Nga përpunimi i të dhënave për 3 vitet e fundit, konstatohet se numri i studentëve në hyrje praktikisht është në rritje për shkak të kuotave të propozuara në varësi të infrastrukturës. Pranë sekretarisë ne u informuam për ecurinë vjetore të studentëve nga rregjistrimi e deri në përfundim të studimeve, të dokumentuara edhe fizikisht (rregjistra) dhe elektronikisht. GVJ konstatoi se sipas viteve akademike nga 2020 deri në 2023 janë rregjistruar studentë si më poshtë:

Viti akademik	Të rregjistruar	Nota mesatare	Të rregjistruar	Totali
20 - 21	25	7.77	1	24
21 - 22	87	7.31	4	83
22 - 23	80	7.31	2	78
	192		7	185


Ref. 11. Të dhëna tabelore për cilësinë në hyrje dhe dalje të studentëve (Tabela Nr. 21);

Vizita ne institucion;

Kriteri 2. Institucioni disponon statistika vjetore për numrin e studentëve të regjistruar në programin e studimit, deri në diplomimin e tyre, tërheqjet nga programi, si dhe largimet para përfundimit të programit apo mospërfundimin me sukses të vitit akademik në të cilin zhvillohet programi i studimeve.

GVJ bazuar në referencat dhe vizitën në institucion konstatoi se, UST dhe respektivisht FSHR disponon statistika të sakta vjetore për numrin e studentëve të regjistruar në programin e studimit të ciklit të parë "Bachelor" në "Shkenca të Rehabilitimit, si dhe për të gjitha programet e studimit që ofron UST. GVJ nga vizita në sekretarinë mësimore, në vëzhgimin e rregjistrave themeltar të studentëve, vuri re se, UST dhe respektivisht FSHR disponon statistika të sakta vjetore për numrin e transferimeve, largimet para përfundimit të programit apo mospërfundimit me sukses të vitit akademik. Këto të dhëna ruhen edhe në sistem elektronik, Pitagora dhe menaxhohen nga sekretaria mësimore, nëpërmjet rregjistrave të programit të studimit. Gjithashtu sekretaria mësimore na vendosi në dispozicion dosjen personale të çdo studenti, e cila krijohet që në momentin e regjistrimit të tij dhe përditësohet me të dhëna të tjera përgjatë "jetës universitare" të tij në UST. Kjo dosje

	<p>përditësohet edhe me elementë të tjerë si: dokumentacioni i ndjekjes së praktikës profesionale, apo mospërfundimin me sukses të vitit akademik. GVJ gjatë inspektimit të dosjes dhe rregjistrave të studentëve konstaon se ka një rritje të numrit të studentëve vit pas viti, si dhe një rritje në nivelin e notës mesatare në hyrje.</p> <p><u>Rritja e numrit të studentëve vit pas viti, si dhe rritje e notës mesatare në hyrje përbën një pikë të fortë të këtij program studimi Bachelor në “Shkencat e Rehabilitimit”.</u></p> <p><i>Ref. 11. Të dhëna tabelore për cilësinë në hyrje dhe dalje të studentëve (Tabela Nr. 21);</i></p> <p><i>Vizita ne institucion (sekretari);</i></p>
<p>Kriteri 3. Të dhënat statistikore të studentëve duhet të menaxhohen përmes sistemit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jenë të sigurta dhe lehtësisht të verifikueshme nga personat e autorizuar.</p>	<p>GVJ gjatë vizitës në institucion, RVB, referncave përkatëse konstatoi se të dhënat statistikore të studentëve menaxhohen përmes një sistemi të brendshëm të informacionit nga Drejtoria e Kurrikulave dhe Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë si dhe nga sekretaria. Çdo student ka dosjen e tij, e cila na u vendos në dispozicion ku përmbahen të gjitha të dhënat; nga momenti i regjistrimit e deri në diplomim. GVJ konstatoi se këto të dhëna janë të disponueshme në sekretarinë mësimore, në formë shkresore dhe në sistemin Pitagora, të cilat janë të verifikueshme nga personat e autorizuar, duke respektuar kuadrin ligjor për mbrojtjen e të dhënave.</p> <p><i>Ref. 11. Të dhëna tabelore për cilësinë në hyrje dhe dalje të studentëve (Tabela Nr. 21);</i></p> <p><i>Vizita ne institucion;</i></p>
<p>Kriteri 4. Institucioni mbështet me akte, kontrollin periodik të përvitshëm pranë gjithë njësive përgjegjëse për menaxhimin (sekretaritë mësimore, sistemin e menaxhimit të brendshëm të informacionit, etj.), vlerëson dhe dokumenton gjendjen dhe saktësinë e informacionit dhe të dokumentacionit që lidhet me studentët, dhe me veprimtarinë e tyre përkatëse.</p>	<p>GVJ pas shqyrtimit të dokumentacionit referues, si dhe takimin me drejtues të institucionit, stafin akademik, sekretarine konstaton se UST bën kontrole periodike për procesin mësimor, kontrole periodike ose audit të brendshëm, harton raporte periodike mbi cilësinë në hyrje dhe dalje të studentëve, si dhe shkallës së cilësisë së punësimit të tyre, duke e shoqëruar me masat e duhura në drejtim të përmirësimit të këtyre treguesve. Në rregjistrat themeltar vërehet jo vetëm rritja në vazhdim vit pas viti i studentëve të rregjistruar në programin Bachelor në “Shkencat e Rehabilitimit”, por edhe rritja e cilësisë së këtyre studentëve (rritje e notës mesatare në hyrje). Në fund të vitit kalendarik departamenti përgjegjës për programin e studimit analizon dhe harton një raport analitik mbi arritjen e objektivave formuese të programeve të studimit dhe rezultateve të pritshme të të nxëniet dhe aftësimit profesional, me qëllim për të identifikuar nevojat për përmirësime në të ardhmen. Një kopje e raportit të kësaj</p>

	<p>analize i përcillet dekanatit, që nga ana e vet i përpunon këto edhe mbi bazën e raporteve të ardhura nga departamentet e tjera, për të hartuar një raport analitik vjetor në nivel njësie kryesore. Ky raport shërben si bazë për hartimin e objektivave për vitin pasues si për; kuotat, kriteret e pranimit apo të transferimit të studimeve.</p> <p><i>Ref. 12). FSHR, Analiza vjetore 2021-2022;</i> <i>Vizita në institucion;</i></p>								
<p>Kriteri 5. Njësia bazë duhet të hartojë raporte analitike, periodike mbi profilin dhe cilësinë në hyrje dhe dalje të studentëve, si dhe shkallën e cilësisë së punësimit të tyre, duke e shoqëruar me masat e duhura në drejtim të përmirësimit të këtyre treguesve.</p>	<p>GVJ bazuar në vizitën në institucion dhe në veçanti takimi me përfaqësues të zyrës së karrierës, vihet re se institucioni i kushton një rëndësi të veçantë mbledhjes së të dhënave të studentëve të diplomuar (pavarësisht se profesionistët e parë në programin Bachelor në “Shkencat e Rehabilitimit” janë sivjet 2022-2023). Kjo shërben edhe si një tregues i cilësisë dhe përdoret për punësimin e profesionistëve në fushat përkatëse. Këto të dhëna jepen në formë statistikore edhe në raportet vjetore që hartohen nga institucioni. Drejtuesit e njësive bazë këtë informacion vjetor, periodik të diskutuar më parë në departament e përcjellin në dekanat, për hartimin e objektivave, kuotave për vitin pasues</p> <p><i>(Ref. 12). FSHR, Analiza vjetore 2021-2022;</i> <i>Vizita në institucion;</i></p>								
<p>Konkluzione</p>	<p><i>GVJ bazuar në RVB, guidën dhe takimet në institucion mendon se ky institucion realizon një audit të brendshëm periodik, mbledh, administron, përditëson dhe ruan të dhëna të hollësishme në lidhje me numrin e profilin e studentëve që ndjekin programin e studimit, nga pranimi deri në diplomim, si dhe të dhëna të punësimit të tyre. GVJ mendon se ky standard përmbushet plotësisht.</i></p>								
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<table border="1"> <thead> <tr> <th>Plotësisht</th> <th>Përmbushet pjesërisht</th> <th>Përmbushet kryesisht</th> <th>Përmbushet plotësisht</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td></td> <td></td> <td></td> <td>X</td> </tr> </tbody> </table>	Plotësisht	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht				X
Plotësisht	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht						
			X						

<p>Standardi V.5</p> <p>Institucioni i arsimit të lartë përfshin dhe angazhon studentët në organet vendimmarrëse e këshilluese, në kuadër të hartimit, miratimit, rishikimit e përmirësimit të programeve të studimit, metodave të mësimdhënies dhe cilësisë së burimeve e shërbimeve ndaj tyre.</p>	
<p>Kriteret</p>	<p>Vlerësimi i ekspertëve</p>

<p>Kriteri 1. Institucioni parashikon përfshirjen dhe angazhimin e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në organet vendimmarrëse e këshilluese sipas akteve ligjore dhe atyre rregullatore të vetë institucionit.</p>	<p>GVJ, bazuar në rregulloret e institucionit të UST, statutin e institucionit, takimit me grupin e studentëve, konstaton se në të gjitha organet kolegjinale të UST, vërehet prania e përfaqësuesve të studentëve sipas rregulloreve të UST dhe Ligjit të Arsimit të Lartë. Gjithashtu në UST është i ngritur dhe funksionon edhe Këshilli Studentor i cili organizohet në nivel njësie kryesore dhe kryen aktivitetin në bazë të statudit të tij dhe koordinon përfaqësimin e studentëve në të gjitha organet kolegjinale ku ata janë të përfshirë. Organet kolegjinale të UST ku studentët janë të pranishëm janë:</p> <ul style="list-style-type: none"> ▪ Këshilli i Studentëve në rang njësie kryesore dhe univeristeteti; ▪ Senati Akademi; ▪ Këshilli Etikës; ▪ NJSBC; <p><i>Ref. 7. Statuti i Universitetit të Sporteve, Neni 96, pika 2;</i> <i>Ref. 7. Ibid., Neni 19, pika 3.ç;</i> <i>Ref. 7. Ibid., Neni 30, pika 2;</i> <i>Ref. 7. Ibid., Neni 29, pika 3;</i> <i>Vizita në institucion;</i> <i>Dok. Shtesë: Listen e Keshillit studentor te Institucionit Fakultetit.pdf (Nr. 8)</i> <i>Dok. Shtesë: Listen e anetareve te Senatit Akademik ku duken dhe studentet senator.pdf (Nr. 9);</i></p>
<p>Kriteri 2. Institucioni duhet të garantojë se përfshirja e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në vendimmarrje, këshillim apo vlerësimin mbi procesin akademik, të jetë reale, konkrete, frutdhënëse dhe me rezultate lehtësisht të verifikueshme e të matshme.</p>	<p>GVJ bazuar në statutin e UST neni 95, takimin me studentët konstaton se, studentët janë të përfshirë në organet kolegjinale si më poshtë, ashtu sic referuam edhe në kriterin e mësipërm (kriteri 1): Senati akademik; Këshilli i etikës; Komisionet e përhershme të lejuara me statut; Këshillat e studentëve;</p> <p>Gjithashtu, institucioni, përmes anketimeve, vlerësimeve periodike të studentëve për pedagogët (pyetësor anonim), lëndët dhe institucionin, mbledh dhe përpunon të dhëna të cilat përdoren nga organet vendimmarrëse për menaxhimin e vet institucionit. Të dhënat e mbledhura diskutohen në nivel institucional, me qëllim evidentimin e situatave dhe marrjen e masave për përmirësim të vazhdueshëm të problematikave të dala (nuk kishin ndonjë problematik të evidentuar apo të dokumentuar).</p> <p><i>Ref.22. Model pyetësori;</i> <i>Vizita në institucion;</i></p>




	<p><i>Dok. Shtesë: Listen e Keshillit studentor te Institucionit Fakultetit.pdf (Nr. 8)</i></p> <p><i>Dok. Shtesë: Listen e anetareve te Senatit Akademik ku duken dhe studentet senator.pdf (Nr. 9);</i></p>
<p>Kriteri 3. Njësia përgjegjëse garanton përfshirjen e studentëve në procesin e hartimit, rishikimit dhe përmirësimit të programit të studimit mbi baza të rregullta dhe reflekton sugjerimet e kontributin e tyre në to, në mbledhje të përbashkëta në departament, me pyetësorë, grupe fokusimi, etj.</p>	<p>GVJ bazuar në RVB, konsultimi me dokumentacionin e vënë në dispozicion si dhe takimet me studentët konstatuam se UST garanton përfshirjen e studentëve në procesin e hartimit, rishikimit dhe përmirësimit të programeve të studimit. Përfshirja e studentëve në procesin e hartimit, rishikimit dhe përmirësimit të programeve të studimit realizohet përmes një pyetësorit anonim me studentët dhe përmes fokus grupeve. Pyetësori organizohet dy herë në vit, në përfundim të çdo semestri, për të gjitha programet e studimit. Ndër rubrikat e pyetësorit është që të vlerësohet edhe sylabusi i lëndës. Takimet këshilluese të studentëve me përfaqësues të Zyrës së Këshillimit, Informimit dhe Orientimit të Studentëve, në disa raste edhe në praninë e koordinatorit të programit. Gjetjet e tyre, bëhen pjesë e diskutimeve, raporteve analitike semestrale e vjetore, dhe mund të shoqërohen me ndryshime në programin e studimit.</p> <p><i>Ref.22. Model pyetësori;</i></p> <p><i>Vizita në institucion;</i></p> <p><i>Dok. Shtesë: Listen e Keshillit studentor te Institucionit Fakultetit.pdf (Nr. 8)</i></p>
<p>Kriteri 4. Studentëve u mundësohet dhënia e mendimit mbi barazinë dhe ndershmërinë e kryerjes së procesit të vlerësimit dhe kontrollit të dijeve; përfshirë mundësinë e ankimimit të rezultatit, rishikimit dhe reflektimit nga ana e institucionit/ njësisë/pedagogut përgjegjës.</p>	<p>GVJ në takimin me stafin akademik si dhe takimet me studentët u informua se studentëve u jepet mundësia të informohen për procesin e vlerësimit dhe kontrollit të dijeve, u jepet mundësia e ankimimit të rezultatit, rishikimit të vlerësimit dhe reflektimit nga ana e institucionit, njësisë, pedagogut përgjegjës të lëndës. Mënyra e kontrollit dhe vlerësimit të dijeve është një proces transparent, i cili shprehet në rregulloret e brendshme të vlerësimit të studentëve dhe pasqyrohet në programin apo sylabusin e secilës lëndë.</p> <p>Pedagogu i lëndës përgatit tezat e provimit paraprakisht, miratohet nga shefi i departamentit dhe në provim tezat janë të sekretuara. Pedagogu ndërkoh ju ka bërë paraprakisht me dije studentëve vlerësimin e provimit të ndërmjetëm si shpjegimet për vlerësimin aktual, mundësinë e rishikimit të tezës dhe çelësit të përgjigjeve, dhe mundësia për rivlerësim nga një komision i posaçëm nëse ka ankimime ndaj vlerësimit të pedagogut. Të gjitha këto elemente të vlerësimit të studentit janë të parashikura në rregulloret e UST dhe janë tregues të transparencës dhe barazisë së procesit të vlerësimit. Studentët</p>

	<p>kanë mundësi të parashitrojnë kërkesat e tyre duke ndjekur procedurat e parashikuara në rregulloren e institucionit. Gjatë takimit me drejtuesit e institucionit dhe studentët nuk kishte një rast të dokumentuar ankimimi.</p> <p><i>Ref. 7. Statuti i UST-së;</i> <i>Ref. 8. Rregullore e UST;</i> <i>Ref. 10. Rregullorja e FSHR;</i> <i>Ref. 8. Rregullore e Universitetit të Sporteve, Diplomi, neni 107;</i> <i>Vizita në institucion;</i> <i>Dok. Shtesë: Listen e Keshillit studentor te Institucionit Fakultetit.pdf (Nr. 8)</i> <i>Dok. Shtesë: Listen e anetareve te Senatit Akademik ku duken dhe studentet senator.pdf (Nr. 9);</i></p>								
Konkluzione	<p><i>GVJ bazuar në RVB, vizitën në institucion, takimin me stafin akademik dhe studentët mendon se ky institucion angazhon studentët në organet vendimmarrëse e këshilluese, në kuadër të hartimit, miratimit, rishikimit e përmirësimit të programeve të studimit, metodave të mësimdhënies dhe ky anagazhim studentor rregullohet sipas legjislacionit në fuqi dhe rregulloreve, Statusit të UST. GVJ mendon se ky standard përmbushet plotësisht.</i></p>								
Shkalla e përmbushjes së standardit	<table border="1"> <thead> <tr> <th>Përmbushet</th> <th>Përmbushet pjesërisht</th> <th>Përmbushet kryesisht</th> <th>Përmbushet plotësisht</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td></td> <td></td> <td></td> <td>X</td> </tr> </tbody> </table>	Përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht				X
Përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht						
			X						

Standardi V.6	
<p>Institucioni i arsimit të lartë ka procedura e njësi të posaçme për pritjen, orientimin, këshillimin e studentëve, menaxhimin e ankimimeve e problematikave, të cilat ushtrojnë veprimtarinë në mënyrë të përhershme e janë lehtësisht të arritshme nga studentët.</p>	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni ka procedura e njësi të posaçme në shërbim të informimit e shërbimit të studentëve, në përputhje me parashikimet ligjore dhe aktet rregullatore të institucionit.</p>	<p>GVJ bazuar në rregulloret institucionale, guidën në institucion, takimin me stafin akademik dhe studentët konstaton se insitucioni siguron informim, këshillim e orientim për studentët e të gjithë programeve dhe të gjithë cikleve të studimit, si në nivel institucional dhe në nivel njësie kryesore. Informimi i studentëve nga stafi, sekretaria bëhet që në ditët e informimit (open day) për të zgjedhur këtë universitet, po ashtu të drejtën e informimit studentët e marrin fizikisht në</p>

	<p>institucion te sekretaria, drejtuesit e institucionit, me anë të posterave të afishuara në vende të dukshme të institucionit, apo në distancë nëpërmjet informimit on line me anë të sitemit të Pitagorës. GVJ konstaton se këto të drejta të informimit studentor janë të shprehura dhe në rregullore të ndryshme dhe Statutin e UST-së të cilat janë aksesueshme (fizikisht dhe online) nga të gjithë grupet e interesuara për programin e studimit Bachelor’’ Shkencat e Rehabilitimit’’.</p> <p><i>Ref. 7. Statuti i UST-së;</i></p> <p><i>Ref. 8. Rregullore e UST;</i></p> <p><i>Ref. 10. Rregullorja e F.SHR;</i></p> <p><i>Ref. 8. Rregullore e Universitetit të Sporteve, Diplomi, neni 107;</i></p> <p><i>Ref. 41. Aksesi online në systemin PITAGORA)</i> https://ust.pitagora.rash.al/login?fac_id=10000;</p> <p><i>Vizita në institucion;</i></p>
<p>Kriteri 2. Institucioni ka ngritur dhe ka bërë funksional një sistem të posaçëm për informimin, këshillimin, ndjekjen e përparimit të studentëve dhe asistimin e tyre për çështje që kanë të bëjnë me procesin mësimor dhe programin e studimit.</p>	<p>GVJ gjatë vizitës në institucion, takimet e realizuara me stafin, drejtuesit, sekretarinë, studentët ka një sistem të mire organizuar për informimin, këshillimin, ndjekjen e përparimit të studentëve dhe asistimin e tyre për çështje që kanë të bëjnë me procesin mësimor nga dita e regjistrimit deri në përfundim të studimeve. GVJ gjatë vizitës në sekretarinë mësimore të institucioni konstatoi edhe fizikisht (rregjistrat themeltar të studentëve) dhe në formë elektronike sistemi i Pitagorës ishin të hedhura të gjitha të dhënat për procesin mësimor nga dita e regjistrimit deri në përfundim të studimeve Gjithashtu në takimin me studentët, GVJ konstaton se atyre u ofrohet shërbim i vazhdueshëm i këshillimit të karrierës me ndihmën e Drejtorisë së Koordinimit, Drejtorisë së Marrëdhënieve me Jashtë, Këshillimit të Karrierës, ALUMNI etj. Koordinimi dhe bashkëpunimi i aktivitetit të zyrave të mësipërme në rang Universiteti është tregues i një sistemi të menaxhimit shumë të mirë të asistencës ndaj studentëve.</p> <p><i>Ref. 7. Statuti i UST-së;</i></p> <p><i>Ref. 8. Rregullore e UST;</i></p> <p><i>Ref. 10. Rregullorja e F.SHR;</i></p> <p><i>Ref. 41. Aksesi online në systemin PITAGORA)</i> https://ust.pitagora.rash.al/login?fac_id=10000;</p> <p><i>Vizita në institucion;</i></p>
<p>Kriteri 3. Institucioni u ofron studentëve shërbimin e këshillimit të</p>	<p>GVJ siç e përmendëm dhe në kriterin 2, konstaton se UST u ofron studentëve shërbimin e këshillimit të karrierës. Studentëve u ofrohet këshillimi i karrierës, me anë të disa</p>




<p>karrierës. Zyra/njësia për këshillimin e karrierës mirëpret studentët në mënyrë të vazhduar dhe periodike, duke ofruar informacion dhe orientim të posaçëm, në lidhje me kompletimin e procesit mësimor, zgjedhjen dhe orientimin për praktikën profesionale në institucione të tjera dhe orientimin në tregun e punës.</p>	<p>zyrave dhe drejtorive si, zyra e këshillimit të karrierës, drejtoria e koordinimit, marrëdhënieve me jashtë, ALUMNI. Këto zyra janë në shërbim të studentëve duke ofruar informacion në lidhje me, aktivitete të ndryshme studentore që zhvillohen brenda ose jashtë vendit, projekte të ndryshme, mundësi punësimi duke ofruar njëkohësisht asistencë për kryerjen e aplikimeve apo këshillimin e nevojshëm. Gjithashtu UST ka krijuar kontakte me kompani private dhe institucione shtetërore dhe bashkëpunon ngushtë jo vetëm në funksion të zhvillimit të praktikave profesionale / intershipeve të studentëve, por edhe të punësimit të ardhshëm të studentëve në këto kompani e organizata.</p> <p><i>Ref. 35. Marrëveshjet me Spitalet dhe Klinikat per realizimin e praktikave;</i></p> <p><i>Ref. 39. Marreveshje bashkepunimi me Universitete dhe organizata Shqiptare;</i></p> <p><i>Ref. 40. Marreveshje bashkepunimi me Universitete të huaja; Vizita në institucion;</i></p>
<p>Kriteri 4. Zyra/njësia e karrierës ndjek studentët pas diplomimit, mbledh, përpunon e mban të dhëna mbi shkallën dhe cilësinë e punësimit të studentëve të programit të studimit dhe ua vë ato në dispozicion studentëve dhe organeve e autoriteteve drejtuese përkatëse.</p>	<p>Gjatë vizitës në institucion, takimet e realizuara me stafin, drejtuesit, sekretarinë, studentët GVJ konstatoi se UST ka një sistem të mirë organizuar për informimin, këshillimin e studentëve dhe ka disa zyra dhe drejtori të cilat ndjekin në mënyrë periodike studentët jo vetëm gjatë viteve akademike, por edhe pas punësimit të tyre për programet e tjera, pasi profesionistët e parë të programit Bachelor në Shkencat e Rehabilitimit diplomohen këtë vit akademik 2022-2023.</p> <p>Drejtoritë dhe zyrat përkatëse si, Drejtoria e Koordinimit, Marrëdhënieve me Jashtë, Këshillimit të Karrierës, ALUMNI mban kontakte për pjesëmarrje në trajnime pasuniversitare brenda apo jashtë vendit si dhe mban kontakte me studentët e diplomuar duke krijuar një bazë të dhënash në lidhje me punësimin e tyre apo vazhdimin e studimeve në UST (aktualisht për këtë program studimi nuk data baze për punësimin apo vazhdimin e studimeve në UST, pasi brezi i parë i të diplomuarve është sivjet, korrik 2023).</p> <p><i>Ref. 43. Website i UST për ALUMNI, http://alumni.ust.edu.al/; Vizita në institucion;</i></p>
<p>Konkluzione</p>	<p><i>GVJ mendon si konkluzion se UST ka procedura, zyra, drejtori, e njësi të posaçme për pritjen, orientimin, këshillimin e studentëve, menaxhimin e ankimimeve e problematikave, e janë lehtësisht të arritshme nga studentët .UST falë këtyre zyrave bën të mundur ndjekjen e punesimin e tyre edhe pas</i></p>

	<i>mbarimit të studimeve. GVJ mendon se ky standard përmbushet plotësisht.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht	
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës V	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht	
				X

VI. SIGURIMI I CILËSISË SË PROGRAMIT TË STUDIMIT BACHELOR


Standardi VI.1	
Institucioni i arsimit të lartë ndjek një politikë të qartë për garantimin dhe promovimin e cilësisë së mësimdhënies dhe harton udhëzues të posaçëm të zhvillimit të metodeve dhe monitorimit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni harton udhëzues në nivel institucional për zhvillimin dhe përdorimin e metodave të ndryshme dhe inovative të mësimdhënies në bazë të fushës së studimeve, lëndëve/moduleve.	<p>GVJ në takimin me drejtuesit e institucionit, stafin, studentët, NJSBC, referencat e vëna në dispozicion, mendon se, UST, e ka të ngritur dhe funksional, Sistemin e Brendshëm të Sigurimit të Cilësisë dhe nëpërmjet NJSBC-së, siguron zbatimin e një strategjie institucionale për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë. NJSBC, funksionon plotësisht në formën e një njësie të përhershme në strukturën organizative të institucionit dhe veprimtaria e tij bazohet dhe zbatohet sipas një rregulloreje të miratuar institucionale, <i>Ref. 47. Politika për Sigurimin e cilësisë; Ref. 48. Rregullore për Sigurimin e Cilësisë.</i></p> <p>NJSBC vlerëson në mënyrë të vazhdueshme dhe periodike funksionalitetin, efikasitetin dhe produktivitetin e stafit të IAL në lidhje me veprimtarinë mësimore dhe kërkimore shkencore nëpërmjet pyetësorëve anonim dy herë në vit që ju bëhen studentëve mbi aktivitetin mësimor, aktivitetin shkencor, infrastrukturën e institucionit, komunikimin me sekretarinë, administratën etj. NJSBC ka të drejtë të ketë akses dhe të kontrollojë në të gjitha materialet dhe të dhënat e institucionit në bazë të plani strategjik të zhvillimit të UST. Mësimdhënia bëhet gjithmonë në përmirësim bazuar dhe në përmirësimin në vazhdim të infrastrukturës. Përdorimi i Sistemit të Pitagorës që aplikohet, në përputhje me dispozitat e legjislacionit në fuqi,</p>

Adresa: "Rruga e Durrësit"
 Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
 Tel:+355 (04) 222-43423



Web site: www.asc.al

E-mail: info@asc.al

	<p>të statutit dhe të akteve të tjera të brendshme rregullatore duke vënë në dispozicion metoda kreative jo vetëm në auditor por dhe në distancë për tematika të ndryshme mësimore, laboratore, detyra kursi etj.</p> <p><i>Ref. 6. Plani Strategjik i Zhvillimit të UST, 2021-2026;</i></p> <p><i>Ref. 45. Per ngritjen e NJSBC;</i></p> <p><i>Ref. 47. Politika për Sigurimin e cilësisë;</i></p> <p><i>Ref. 48. Rregullore per Sigurimin e Cilesise;</i></p> <p><i>Vizita në institucion;</i></p>
<p>Kriteri 2. Strukturat përgjegjëse zhvillojnë mekanizma të monitorimit dhe vlerësojnë në mënyrë periodike aftësitë mësimdhënëse dhe inovative të personelit akademik dhe ndihmësakademik.</p>	<p>Gjatë guidës në institucion GVJ u informua se në mënyrë të vazhdueshme, 2 herë në vit, në fund të çdo semestri realizohet një pyetësor anonim me studentët, me disa rubrika për mësimdhënien, programin, korrektësinë e stafit, etj. Ky vlerësim menaxhohet nga, Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë (NJSBC).</p> <p>GVJ gjatë takimit me zyrën e NJSBC-së, u informua se NJSBC, ka filluar të funksionoj që në Mars 2018, por ka marrë formën e një njësie të përhershme institucionale në vitin 2021, me miratim dhe me Vendim të Senatit Akademik të UST. Aktiviteti i saj rregullohet me anë të rregullores së miratuar nga senati i institucionit.</p> <p>NJSBC ka ndryshuar strukturën e saj bazuar dhe në ligjshmërinë aktuale, rregulloret e funksionimit, Statutin e UST, duke bërë pjesë të NJSBC, përfaqësues nga të gjitha njësitë bazë (përfshirë këtu edhe FSHR), 1 përfaqësues nga studentët dhe 1 ekspert i jashtëm për konsulencë të ndryshme. Njësia vlerëson periodikisht efikasitetin dhe produktivitetin e veprimtarive mësimore e kërkimore shkencore të UST-së, duke u konsultuar edhe me ekspertë të jashtëm. Në përbërjen e NJSBC sipas Statutit të UST janë 7 anëtarë (1 Kryetari, 2 përfaqësues nga FSHL, 2 nga FVFR, 1 nga IKSHS dhe 1 përfaqësues i studentëve).</p> <p><i>Ref. 6. Plani Strategjik i Zhvillimit të UST, 2021-2026;</i></p> <p><i>Ref. 45. Per ngritjen e NJSBC;</i></p> <p><i>Ref. 47. Politika për Sigurimin e cilësisë;</i></p> <p><i>Ref. 48. Rregullore per Sigurimin e Cilesise;</i></p> <p><i>Vizita në institucion;</i></p>
<p>Kriteri 3. Institucioni garanton përfshirjen e</p>	<p>GVJ siç është shprehur edhe në kriteret e mësipërme, si dhe në takimin e realizuar me studentët konfirmoi se UST garanton</p>




<p>studentëve në vlerësimin periodik të formave e metodave të mësimdhënies, të vlerësimit të dijeve, përfshirë mundësinë e trajtimit të ankimeve.</p>	<p>përfshirjen e studentëve në vlerësimin periodik të formave e metodave të mësimdhënies. Studentët referojnë se gjatë vititeve akademike, ata në formë elektronike plotësojnë një pyetësor anonim dy herë në vit (çdo semestër) para sezonit. Pyetësi ka disa rubrika të cilat lidhen kryesisht me, programin e lëndës, syllabuset, mësimdhënia, performanca e stafit akademik, ndihmës akademik, infrastrukturën etj. Studentët shprehin pa ndikim apo presion mendimin e tyre të lirë mbi rubrikat që ka pyetësi. Studentët janë pjesë e vlerësimit periodik institucional, jo vetëm me anë të pyetësorëve anonim on-line në përputhje kjo me pikat 3 & 4 të nenit 103 të Ligjit 80/2015, por edhe me anë të takimeve formale dhe informale yë studentëve me koordinatorin e programit, takimit me përfaqësues të stafit akademik dhe administrativ. Pas mbledhjes së informacioneve përkatëse të këtyre vlerësimeve, NJSBC bën një raport që ja prezanton drejtuesit të institucionit, për problematikat e dala, dhe për ti zgjidhur ato. GVJ gjatë guidës në institucion dhe referencave të vëna në dispozicion, nuk konstatoi ndonjë rast konkret problematike, që mund të kishte dalë nga ky vlerësim periodik institucional me anë të studentëve.</p> <p><i>Ref. 21. FSHR, BA, Model pyetësor i studenteve për të vlerësuar stafin;</i></p>
<p>Kriteri 4. Strukturat përgjegjëse për monitorimin dhe sigurimin e cilësisë në mësimdhënie bëjnë publike rezultatet e vlerësimit.</p>	<p>GVJ konstatoi se, të gjitha të dhënat e grumbulluara nga vlerësimi periodik institucional, në lidhje me rezultatet e shprehura nga studentët, për format dhe metodat e mësimdhënies, programit mësimor, infrastrukturën etj, mbledhen nga NJSBC-ja, përpunohen nga ana statistikore, ruhen dhe krijohet një raport vjetor, i cili i paraqitet Rektorit dhe Senatit Akademik, mbi veprimtaritë e mësimdhënies, të kërkimit shkencor, mbi shërbimet e kryera nga UST si efiasiteti i sekretarisë, bibliotekës etj.</p> <p>Në raportin vjetor, që i paraqitet Rektorit dhe Senatit, paraqiten dhe rekomandimet për vitin e ardhshëm akademik (të tipit SWOT).</p> <p><i>Ref. 21. FSHR, BA, Model pyetësor i studenteve për të vlerësuar stafin;</i></p> <p><i>Ref. 22. Model pyetesori per vleresimin e stafit akademik nga pergjegjesi i departamentit;</i></p>
<p>Kriteri 5. Institucioni, nëpërmjet mekanizmave të vlerësimit dhe rezultateve të marra, promovon</p>	<p>GVJ në takimin me drejtuesit e institucionit, përgjegjës in e departamentit, NJSBC , u informua se informacioni i mbledhur i bëhet një përpunim statistikor nga NJSBC dhe i paraqitet Rektorit dhe Senatit, me rekomandimet për vitin akademik</p>





<p>shembuj të praktikave të mira, nxit personelin akademik për përmirësimin e mëtejshëm të mësimdhënies.</p>	<p>pasardhës nëpërmjet rekomandimeve të tipit SWOT, duke nxjerr në pah mangësitë në këtë raport të vlerësimit institucional.</p> <p>GVJ u informua se në vlerësimet periodike institucionale nuk ka hasur dhe nuk ka konstatuar ndonjë problematik.</p> <p>GVJ në takimin me stafin akademik, konstaton se punonjësit promovohen me anë të suportit që institucioni ju jep për nxitjen përse i përket, kërkimit shkencor në përputhje me legjislacionin në fuqi si dhe rregulloret e brendshme të UST. Institucioni në mënyrë të vazhdueshme stafit akademik ju mbulon fee-në e publikimeve në revista të kërkimit shkencor të indeksuara, ne PubMed etj, si dhe ju mbulon fee-në e pjesmarrjes në konferenca ndërkombëtare. Stafi akademik gjithashtu motivohet nga institucioni edhe në projekte të ndryshme që ata apikojnë si ERASMUS etj.</p> <p><i>Ref. 46. NJSBC Raportim rektorit per periudhen shtator 2021 - qershor 2022;</i></p> <p><i>Ref. 46.1. NJSBC Raportim rektorit per periudhen shtator 2021 - qershor 2022;</i></p> <p><i>Vizita në institucion;</i></p> <p><i>Dok. Shtesë: Liste te konferencave shkencore te organizuara bashkeorganizuar edhe ose aktivite shkencore.pdf (Nr. 5);</i></p>			
<p>Konkluzione</p>	<p><i>GVJ konstaton se UST ka një politikë të qartë për garantimin dhe promovimin e cilësisë së mësimdhënies dhe harton udhëzues të posaçëm të zhvillimit të metodave dhe monitorimit të cilat ndihmojnë institucionin për mbarëvajtjen e procesit mësimor dhe performancën e stafit. GVJ mendon se ky standard përmbushet plotësisht.</i></p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p> <p style="text-align: center;">X</p>

Standardi VI.2

Institucioni i arsimit të lartë harton dhe zbaton politika e procedura transparente të posaçme për sigurimin e cilësisë së programit të studimit, në kuadër të strukturave e sistemit të brendshëm të sigurimit të cilësisë.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni i arsimit të lartë ka politika, struktura dhe procedura</p>	<p>Gjatë guidës në institucion GVJ u informua se në mënyrë të vazhdueshme, realizohet një pyetësor anonim me studentët, me disa rubrika për mësimdhënien, programin, korrektësinë</p>





<p>për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë (SBC), në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore në fuqi dhe me aktet rregullatore institucionale.</p>	<p>e stafit, ky vlerësim menaxhohet nga, Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë (NJSEC), e cila ka filluar të funksionoj që në mars 2018 , dhe është riorganizuar nga ana strukturale, përsa i përket anëtarëve të NJSBC në vitin 2021, me Vendim të Senatit Akademik të UST, ku është e përcaktuar ashtu sic e parashikon dhe legjislacioni në fuqi, Ligji 80/2015 të IAL si dhe rregulloret e brendëshme të UST dhe Statutit të UST që NJSBC përbëhet nga 7 anëtar (1 Kryetari, 2 përfaqësues nga FSHL, 2 nga FVFR, 1 nga IKSHS dhe 1 përfaqësues i studentëve) dhe një ekspert i jashtëm.</p> <p>Përbërja e NJSBC është arritja e objektivave strategjike në përputhje me vizionin dhe misionin e institucionit. NJSBC funksionon në bazë të Rregullores për Sigurimin e Cilësisë; legjislacionit në fuqi, si dhe rregulloret e brendëshme të UST dhe Statutit të UST.</p> <p><i>Ref. 6. Plani Strategjik i Zhvillimit të UST, 2021-2026;</i></p> <p><i>Ref. 45. Per ngritjen e NJSBC);</i></p> <p><i>Ref. 47. Politika për Sigurimin e cilësisë;</i></p> <p><i>Ref. 48. Rregullore per Sigurimin e Cilesise;</i></p> <p><i>Vizita në institucion;</i></p>
<p>Kriteri 2. Institucioni ka të ngritur, mban në funksion Sistemin e Brendshëm të Sigurimit të Cilësisë dhe zbaton një strategji institucionale për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë, ku përfshihen studentët dhe bashkëpunëtorë e ekspertë të jashtëm.</p>	<p>GVJ mendon se UST ka një strukturë të NJSBC e cila përmbush kriteret ligjore, dhe përbëhet nga 7 anëtarë, sipas Statutit të UST ku përfshihen studentët dhe bashkëpunëtorë apo ekspertë të jashtëm (1 Kryetari, 2 përfaqësues nga FSHL, 2 nga FVFR, 1 nga IKSHS dhe 1 përfaqësues i studentëve).</p> <p>NJSBC kontrollon në mënyrë periodike dhe përpunon një raport vjetor mbi aktivitetin mësimor, kërkimor dhe mbi shërbimet e ofruara nga IAL-ja, të cilin ja paraqet Rektorit. NJSBC-ja njëkohësisht është përgjegjëse për aplikimin e pyetësorëve anonim të studentëve që bëhet dy herë në vit, mbledhjen, menaxhimin, ruajtjen dhe komunikimin e mendimeve të studentëve për mësimdhënien ,programin e studimit, korrektësinë e stafit, funksionimin e bibliotekës, sekretarisë, infrastrukturës etj. Funksioni i NJSBC bazohet, menaxhohet me anë të një rregulloreje të funksionimit të Njësies së Vlerësimit dhe ka të drejtën e aksesit në të gjitha dokumentet, dhe informacionet e tjera të Universitetit duke ruajtur në të njëjtën kohë konfidencialitetin e dokumenteve të mbledhura.</p> <p><i>Ref. 45. Per ngritjen e NJSBC;</i></p>

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

Web site: www.ascal.al

Email: info@ascal.al

	<p><i>Ref. 6. Plani Strategjik i Zhvillimit të UST, 2021-2026;</i></p> <p><i>Ref. 47. Politika për Sigurimin e cilësisë;</i></p> <p><i>Ref. 48. Rregullore për Sigurimin e Cilesise;</i></p> <p><i>Dok. Shtesë: Organigrama e UST-së.pdf (Nr. 4);</i></p>
<p>Kriteri 3. Institucioni përdor instrumentet dhe treguesit e duhur për sigurimin e cilësisë. Sigurimi i jashtëm i cilësisë në arsimin e lartë realizohet përmes proceseve të vlerësimit të jashtëm të akreditimit, vlerësimeve analitike e krahasuese, si dhe proceseve të tjera që promovojnë e përmirësojnë cilësinë në programin e studimit.</p>	<p>GVJ bazuar në, guidën në institucion, dokumentat e vëna në dispozicion konstaton se, institucioni përdor instrumentet dhe treguesit e duhur për sigurimin e cilësisë.</p> <p>NJSBC ka rolin kryesor në monitorimin e cilësisë. NJSBC monitoron procesin e vlerësimit të jashtëm të akreditimit, vlerësimeve analitike periodike, si dhe proceseve të tjera që promovojnë e përmirësojnë cilësinë në programin e studimit.</p> <p>GVJ gjatë guidës në institucion dhe takimin me drejtues të institucionit konstaton se institucioni për sigurimin e cilësisë përdor pyetësorët anonim tek studentët për aspekte të ndryshme të veprimtarisë mësimore e asaj administrative, sipas Ligjit 80/2015 të IALP; takime formale dhe informale me studentët dhe koordinatorin e programit të studimit; takime me stafin akademik dhe administrativ, kontakte nëpërmjet e-mail-it ose takime të drejtpërdrejta.</p> <p>NJSBC pas mbledhjes së të gjitha informacioneve nga metodat e përdorura, siç referuam më lartë bën raportime periodike vjetore tek drejtuesi i institucionit.</p> <p>Të dhënat e këtij monitorimi të mbledhura nga NJSBC diskutohen në njësitë bazë, dekanat, rektorat, senat dhe shohin mundësitë për përmirësimin e problematikave (nuk ka patur ndonjë rast konkret problematik).</p> <p><i>Ref. 21. FSHR, BA, Model pyetësor i studenteve për të vlerësuar stafin;</i></p> <p><i>Ref. 22. Model pyetesori për vlerësimin e stafit akademik nga përgjegjësi i departamentit;</i></p> <p><i>Ref. 49. Model Raportimi-i-NJSBC-per-muajin-Shtator-28.09.2022;</i></p> <p><i>Vizita në institucion;</i></p>
<p>Kriteri 4. Institucioni përdor tregues të qartë, të matshëm në mësimdhënie dhe kërkim, për pasqyrimin gjendjes, arritjeve dhe dobësive, të parashikuara dhe në aktet rregullatore institucionale.</p>	<p>GVJ mendon se UST përgatit në mënyrë periodike analizat vjetore në bazë institucionale, në çdo njësi bazë. Aty përshkruhet pjesa më e madhe e informacionit mbi ngarkesën mësimore, aktivitetin shkencor, cilësinë e leksioneve të miratuara më parë në departament, të dhënat e dala nga monitorimi i vazhdueshëm i stafit. Ky raport më pas u dërgohet dhe vihet në dispozicion edhe stafit akademik dhe administratës.</p>

Mbi bazën e treguesve cilësorë, institucioni bën promovime nxitëse për arritjet më të mira r.e programin e studimit.	<i>Ref. 50. DSHBH, Raporti vjetor 2021-2022;</i> <i>Ref. 12. FSHR. Analiza Vjetore 2021-2022;</i> <i>Vizita në institucion;</i> <i>Dok. Shtesë: Liste te konferencave shkencore te organizuara bashkeorganizuar edhe ose aktiviteie shkencore.pdf (Nr. 5);</i>			
Konkluzione	<i>GVJ pas shqyrtimit të RVB, dokumentave të vëna në dispozicion, guidës në UST mendon se UST, zbaton politika e procedura transparente të posaçme për sigurimin e cilësisë së programit të studimit, në kuadër të strukturave e sistemit të brendshëm të sigurimit të cilësisë, bazuar në legjislacionin në fuqi si dhe rregulloret e brendshme të UST. GVJ mendon se ky standard përmbushet plotësisht.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	K	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi VI.3	
Institucioni i arsimit të lartë monitoron dhe vlerëson përmes njësive të posaçme e në mënyrë periodike programin e studimit, për të garantuar arritjen e objektivave formuese dhe rezultateve të synuara të të nxënit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni i arsimit të lartë përdor mekanizma e procese formale e të dokumentuara për shqyrtimin, miratimin dhe mbikëqyrjen periodike të programit të studimit të ciklit të parë, që i shërbejnë akreditimit të tij. Në këtë proces realizon evidentimin e arritjeve dhe dobësive, motivimin e praktikave dhe arritjeve më të mira, dhe planin e masave për përmirësim.	GVJ nga takimi me përfaqësues të institucionit konkludon se në mënyrë periodike institucioni është kujdesur për vlerësimin e brendshëm si në nivel fakulteti ashtu dhe departamenti duke hartuar raporte përkatëse të veprimtarisë. Ky raport vjetor i monitoruar dhe përpiluar nga NJSBC i paraqitet drejtuesit të njësis kryësor dhe prezantohet më pas në senatin e Institucionit. GVJ në numrin e madh të referencave të vëna në dispozicionin nga ASCAL, një prej tyre është dhe raporti vjetor <i>Ref. 12. FSHR. Analiza Vjetore 2021-2022</i> <i>Ref. 31.1 NJSBC. Plani vjetor 2021-2022;</i> Në këto raporte evidentohen arritjet institucionale dhe plani i masave për përmirësim institucional në vitin pasardhës akademik. Informacioni, raporti, rezultatet e këtyre vlerësimeve periodike dokumentohen, ruhen dhe u bëhen të njohura autoriteteve përgjegjëse dhe vendimmarrëse për programin e studimit. <i>Ref. 31.1 NJSBC. Plani vjetor 2021-2022;</i>
Rezultatet e këtyre vlerësimeve dokumentohen dhe u bëhen të njohura autoriteteve përgjegjëse	

dhe vendimmarrëse për programin e studimit.	<i>Ref. 12. FSHR. Analiza Vjetore 2021--2022;</i> <i>Vizita në institucion;</i>
Kriteri 2. Raportet e vlerësimit duhet të përfshijnë rezultatet e pritshme, rezultatet e vlerësimit, motivimin e praktikave dhe arritjeve më të mira, dhe masat e marra për adresimin e mangësive dhe përmirësimin në vijim të cilësisë, si dhe motivimin e arritjeve më të mira në mësim dhe kërkim nga personeli akademik dhe studentët.	<p>Në takimin me përfaqësues të institucionit dhe dokumentat e vëna në dispozicion GVJ mendon se NJSBC përgatit dhe shpërndan një analizë të vlerësimeve periodike institucionale përmes anketimeve me pyetësorë dhe fokus grupe, i cili u vihet në dispozicion Rektorit si raport vjetor.</p> <p>Në përpilimin e këtij raporti vjetor çdo struktur drejtuese institucionale shpreh dhe raporton mbi aktivitetin e tij, në nivel departamenti, në nivel fakulteti dhe në nivel rektorati dhe më pas paraqitet në senat. Raportet e vlerësimit të NJSBC përfshijnë rezultatet e vlerësimit, motivimin e praktikave dhe arritjeve më të mira, dhe masat e marra për adresimin e mangësive dhe përmirësimin në vijim të cilësisë, si dhe motivimin e arritjeve më të mira në mësim dhe kërkim shkencor për stafin akademik dhe studentët. Studentët shprehin mendimin e tyre në sondazhe, intervista të ndryshme të realizuara nga Zyra e Karrierës dhe Alumni, apo nga ana e punëdhënësve të ndryshëm. Instrumentet kryesor që përdoren për përfshirjen e studentëve janë edhe zhvillimi i pyetësorëve online, fokus grupet, mbledhjet e hapura të departamenteve, takimet etj.</p> <p><i>Ref. 46. NJSBC Raportim rektorit per periudhen shtator 2021 - qershor 2022;</i></p> <p><i>Ref. 46.1. NJSBC Raportim rektorit per periudhen shtator 2021 - qershor 2022;</i></p>
Kriteri 3. Institucioni, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit përdor, metoda të drejtpërdrejta, si vlerësim i cilësisë së mësimdhënies, vlerësim të didaktikës, kurrikulës, të mësuarit, vlerësime paralele të provimeve apo detyrave të studentëve, vëzhgime në auditor gjatë kryerjes së ushtrimeve/praktikës, testime lokale apo të standardizuara, rezultatet e arritura në testime	<p>GVJ konston se UST ka në përdorim dhe funksionon në bazë të legjislacionit në fuqi dhe rregulloreve të brendshme institucionale, rregullore e funksionimit të senatit, rregullore programeve të studimit, rregullore e funksionimit të NJSBC, sekretarisë, bibliotekës etj. Në aktet e brendshme rregullatore, ka të përcaktuar qartë metodat kryesore që përdoren për vlerësimin e zhvillimit të programit të studimit dhe ecurinë e studentëve nga regjistrimi deri në diplomimin e tyre dhe në fund, daljen në tregun e punës. Në rregulloren e programit të studimit, rregulloren e fakultetit shprehet qartë se në vlerësimin e studentëve institucioni përdor:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Teste të standardizuara; - Dëgjime në auditor; - Vlerësimi me pikë (në provimet e ndërmjetëme dhe provimin përfundimtar) korrigjimi elektronik për pyetjet me alternativa (clean score); - Testime paraprake dhe përfundimtare;

ndërinstitucionale apo kombëtare, si: provimi i shtetit për profesionet e rregulluara dhe të tjera.

- Provime për module sipas programit të studimit dhe syllabuseve të lëndëve;

Vlerësimi praktik me gojë dhe me shkrim, vlerësimi i detyrave të kryera nga studentët që përbëjnë detyrim të vlerësimit të lëndës sipas syllabusit; mbikqyrja e studentëve gjatë kryerjes së ushtrimeve, praktikës laboratorike. Kontrollë të herë pas herë të zbatimit të kurrikulës dhe për realizimin e programeve, syllabuseve sipas modelit të miratuar

Për stafin akademik të kategorisë Lektor dhe Asistent Lektor, zhvillohen dhe vëzhgime në auditor nga eprori (Përgjegjës departamenti /Dekani) gjatë zhvillimit të një ore mësimi. Ky proces përfundon me plotësimin e një raporti vlerësimi. Në kushtet e përdorimit të platformave on line si Sistemi i Pitagorës, UST monitoron zhvillimin e leksioneve dhe seminareve, praktikave etj, e cila është mundësuar nga Zyra e IT në UST. IT në mënyrë të periodike nëpërmjet raporteve paraqet prezencën në mësim, mbi kohëzgjatjen e orëve mësimore, etj. Lidhur me cilësinë dhe metodologjitë e mësimdhënies, orët mësimore monitorohen nga Përgjegjësi i Departamentit në auditore, laboratore.

GVJ konstaton se këto metoda të drejtpërdrejta, si vlerësim i cilësisë së mësimdhënies, vlerësim të didaktikës bëhen dy herë në vit edhe me pyetësorët anonim. Për çdo konstatim ka një raport mbi këto vlerësime. Nga mbledhja e të dhënave nuk ka ndonjë rast konkret për tu tërhequr vëmendje.

Ref. 46. NJSBC Raportim rektorit per periudhen shtator 2021 - qershor 2022;

Ref. 46.1. NJSBC Raportim rektorit per periudhen shtator 2021 - qershor 2022;

Vizita në institucion;

Kriteri 4. Institucioni, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit përdor metoda e instrumente të tërthorta vlerësimi, si: sondazhe e intervista të studentëve, të atyre të diplomuar (alumni), të personelit akademik, ndihmës akademik e administrativ,

GVJ sic është shprehur edhe në kriteret e mësipërme konstaton se UST, ka zhvilluar auditim të brendshëm periodik të institucionit me anë të pyetësorëve anketues me studentë me qëllim përmirësimin e procesit të vlerësimit të studentëve në programe specifike. Metodën e përdorura përfshijnë: Sondazhe të fokus grupeve të studentëve që ndjekin programet e studimeve Bachelor në “Shkencat e Rehabilitimit”; vlerësimi me anë të pyetësorëve anonim të didaktikës mesimdhënëse, kurrikulës etj. Provime me pyetje konceptuale dhe alternativa. Vlerësimi me pikë me anë testimeve dhe të sistemit CleanScore; Teste të ndërmjetëm dhe përfundimtar; provime për module, praktikë 1, 2, 3; Vlerësimi i të detyrave të kursit, punëve individuale dhe punëve në grup/detyrave/projekteve që

<p>punëdhënësit e institucionet që bashkëpunojnë në realizimin e programit të studimit dhe palëve të tjera që përfshihen në realizimin apo që shërbejnë për vlerësimin e dijeve e kompetencave të përfuara nga ky program.</p>	<p>kryhen nga studentët. Të gjitha këto metoda të vlerësimit sondazhe e intervista të studentëve etj. bazohen në rregullore të brendshme institucionale dhe syllabuset e lëndëve përkatëse të programit të studimit Bachelor në "Shkenca të Rehabilitimit".</p> <p>Metoda të vlerësimit për stafin akademik janë zhvilluar kontrolle të ndryshme në mënyrë periodike dhe sistematike nga eprori përgjegjësi njësisë bazë, dekani, zv. dekani, observim i një ore mësimore në auditor, orëve praktike në laborator dhe orëve të lëndës praktikë që zhvillohen jashtë institucionit me institucionet me të cilat ka marrëveshje bashkëpunimi. Rezultatet e tyre i vë në dispozicion të drejtuesëve të institucionit, të fakulteteve si dhe reflektohen në vlerësimin e performancës vjetore të çdo pedagogu në përfundim të vitit akademik. Kujdes i kushtohet intervistave me studentët, gjatë shqyrtimit të performancës së stafit akademik dhe ndihmës akademik.</p> <p><i>Ref. 21. FSHR, BA, Model pyetësor i studenteve për të vlerësuar stafin;</i></p> <p><i>Ref. 22. Model pyetesori per vleresimin e stafit akademik nga pergjegjesi i departamentit;</i></p> <p><i>Ref. 49. Model Raportimi-i-NJSBC-per-muajin-Shtator-28.09.2022)(Ref. 8. Rregullore e UST, Neni 81, 82, 83;</i></p> <p><i>Vizita në institucion;</i></p>			
	<p><i>GVJ mendon se ky institucion e plotëson këtë standart pasi vlerëson në mënyrë periodike programin e studimit, për të garantuar arritjen e objektivave formuese dhe rezultateve të synuara të të nxëniet dhe disponon raporte periodike të vlerësimit. GVJ mendon se ky standard përmbushet plotësisht.</i></p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				<p>X</p>

<p>Standardi VI.4</p>	
<p>Institucioni i arsimit të lartë përfshin njësitë akademike, personelin akademik e studentët në proceset e SBC-së të programit të studimit dhe informon palët e interesuara në lidhje me rezultatet dhe masat e marra në vijim të tyre.</p>	
<p>Kriteret</p>	<p>Vlerësimi i ekspertëve</p>
<p>Kriteri 1. Institucioni duhet të parashikojë dhe të</p>	<p>GVJ referuar dokumentacionit të vënë në dispozicion si rregulloreve të brendshme institucionale, rregullore e</p>

<p>garantojë në politikat dhe procedurat e brendshme të cilësisë përfshirjen e aktorëve të brendshëm dhe të jashtëm të interesuara për sigurimin dhe përmirësimin e vazhduar të cilësisë së programit të studimit.</p>	<p>funksionimit të senatit, rregullore e programeve të studimit, rregullore e funksionimit të NJSBC, sekretarisë, bibliotekës konstaton se me anë të tyre përcaktohet roli i strukturave akademike dhe administrative si dhe roli i Senatit Akademik lidhur me sigurimin e Cilësisë. Një nga këto politika, është ngritja pranë departamenteve e organeve këshilluese të Bordeve të Tregut të Punës. Po ashtu, përfshirja dhe angazhimi në NJSBC i një eksperti të jashtëm, i cili i përgjigjet nevojës së Universitetit për t'u konsultuar me aktorë të jashtëm.</p> <p>Gjatë periudhës 2018-2022, UST ka arritur të sigurojë përfshirjen si partner në projekte europiane që kanë në fokus sigurimin e brendshëm të cilësisë në institucionet e arsimit të lartë. Aspektet pozitive në këto projekte lidhen me shkëmbimin e përvojave, trajnimet dhe vizitat studimore, sikurse dhe me rishikimin e akteve rregullatore, metodologjisë dhe instrumenteve për monitorimin dhe vlerësimin e proceseve në funksion të brendshëm të cilësisë në UST. GVJ në takimin me stafin akademik dhe drejtues të institucionit u informua se UST, ka patur shkëmbime të stafit akademik dhe administrativ me focus në mësimdhënie, kërkim shkencor dhe trajnime të ndryshme, në kuadër të projektit Erasmus+.</p> <p>Në këtë kuadër mund të përmendim nënshkrimin e marrëveshjes së bashkëpunimit midis UST dhe Universitetit "Foro Italico" të Romës, marrëveshje në bazë të së cilës po punohet për arritjen e ofrimit të një program studimi të përbashkë që ka lidhje me fëmijët që vuajnë nga autizmi dhe përfshirjen e tyre në aktivitetet fizik.</p> <p><i>Ref. 19. UST-Universiteti Foro Italico, Rome, Itali;</i></p> <p><i>Ref. 39. Marrëveshje bashkëpunimi me Universitete dhe organizata Shqiptare;</i></p> <p><i>Ref. 40. Marrëveshje bashkëpunimi me Universitete të huaja;</i></p> <p><i>Ref. 35. Marrëveshjet me Spitalet dhe Klinikat për realizimin e praktikave;</i></p>
<p>Kriteri 2. Institucioni përcakton përgjegjësi dhe detyra konkrete për njësitë, individët, studentët dhe palë të tjera të angazhuara në sigurimin e brendshëm të cilësisë së programit të studimit dhe garanton ushtrimin me</p>	<p>Në takimin e realizuar me stafin dhe Studentët, GVJ u informua se studentët përfshihen në vlerësimin periodik institucional përmes anketimit, dhe forumeve të debatit me koordinatoren e programit të studimit apo me stafin pedagogjik.</p> <p>Stafi akademik dhe studentët me anë të senatorit të tyre të zgjedhur nga qeveria studentore në UST, janë pjesë aktive dhe përfshihen në vendimmarrje të ndryshme institucionale të UST, përmes përfaqësuesve të tyre në Senatit Akademik, dhe në Komisionin e Etikës, si dhe përfaqësisë në NJSBC.</p>

<p>përgjegjësi të këtyre detyrave.</p>	<p>Gjithashtu, përgjegjësitë, detyrat e NJSBC janë të përcaktuara në aktet rregullatore të institucionit.</p> <p><i>Ref. 45. Per ngritjen e NJSBC;</i></p> <p><i>Ref. 47. Politika për Sigurimin e cilësisë;</i></p> <p><i>Ref. 48. Rregullore per Sigurimin e Cilesise;</i></p> <p><i>Vizita në institucion;</i></p>
<p>Kriteri 3. Në vlerësimin dhe sigurimin e cilësisë së programit të studimit duhet të garantohet përfshirja e njësisë bazë dhe kryesore, përgjegjëse për programin e studimit, anëtarëve të personelit akademik, ndihmës akademik e administrative dhe studentëve e programit të studimit.</p>	<p>GVJ, gjatë vizitës në institucion dhe bisedave të zhvilluara, me drejtues, stafin akademik, studentët konstaton dhe mund të pohojmë një gjithëpërfshirje në procesin e veprimtarisë së NJSBC të pedagogëve, stafit administrativ, të cilët organizohen në mbledhje të vazhdueshme mujore të Departamentit si hallka e parë e shprehjes së nevojave për përmirësime apo ndryshime në programet e studimit, të cilat më pas paraqiten në dekanat dhe dekanati më pas i përcjell në Rektorat dhe Senat. Gjatë takimeve të realizuara në UST, GVJ vëren një frymë bashkëpunimi dhe mirëkuptimi midis drejtuesve institucional dhe midis stafit akademik dhe bashkëpunimit me qeverinë studentore, për mbarëvajtjen e procesit mësimorë, përmirësimin e tij dhe rritjen, motivimin e kërkimit shkencor në bazë të institucioneit. Struktura e NJSBC-së, në UST tregon gjithëpërfshirjen e instancave përkatëse për sigurimin e cilësisë. Aktualisht si përfaqesues i FSHR-së është një anëtar, i cili është përgjegjës për mbarëvajtjen e sigurimit të cilësisë, për përgatitjen e raporteve dhe bashkëpunimin me NJSBC-në e UST.</p> <p><i>Ref. 45. Per ngritjen e NJSBC;</i></p> <p><i>Ref. 47. Politika për Sigurimin e cilësisë;</i></p> <p><i>Ref. 48. Rregullore per Sigurimin e Cilesise;</i></p> <p><i>Vizita në institucion;</i></p>
<p>Kriteri 4. Përfshirja dhe aktivizimi i aktorëve të brendshëm në proceset ciklike të vlerësimit duhet të respektojë integritetin akademik dhe të shmangë çdo lloj diskriminimi apo pabarazie kundrejt personelit dhe studentëve.</p>	<p>GVJ mendon se UST është i angazhuar në respektimin e integritetit akademik dhe në shmangien e çdo diskriminimi apo pabarazie të të gjithë palëve në këtë proces vlerësimi. Përzgjedhje e aktorëve të brendshëm në proceset periodike të vlerësimit bëhet nga personeli akademik ku merren parasysh disa kriteret: të përfshirjes si, performanca akademike, integriteti, kompetencat profesionale; mundësitë për grumbullimin e informacionit dhe përpunimin e tij me qëllim realizimin e vlerësimeve të ndryshme. Procesi i vlerësimit zhvillohet duke respektuar Kodin e Etikës. Për të siguruar përfshirjen e plotë të stafit në përmirësimin e cilësisë së programit, UST ka krijuar grupet e punës për mbarëvajtjen në drejtim të kurrikulës, veprimtarisë shkencore dhe</p>

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423



Web site: www.ascal.al

E-mail: info@ascal.al



	<p>vëmendjes ndaj studentëve. Në raportet e vlerësimit akademik GVJ nuk vuri re ndonje pabarazi apo diskriminim të stafit akademik, ndihmës akademik apo të studentëve.</p> <p><i>Ref. 45. Per ngritjen e NJSBC;</i></p> <p><i>Ref. 47. Politika për Sigurimin e cilësisë;</i></p> <p><i>Ref. 48. Rregullore per Sigurimin e Cilesise;</i></p> <p><i>Vizita në institucion;</i></p>
<p>Kriteri 5. Pjesë aktive e proceseve të vlerësimit dhe sigurimit të brendshëm të cilësisë, duhet të bëhen edhe bashkëpunëtorë dhe/ose ekspertë të jashtëm që kanë lidhje me programin e studimit apo mund të japin ekspertizë e mendime të vyera në lidhje me cilësinë e programit dhe përmirësimin e saj.</p>	<p>GVJ bazuar në referencat e vëna në dispozicion si dhe takimin me drejtues të institucionit si dhe NJSBC, konstoi se struktura e NJSBC është ndryshuar në vitin 2021 me vendim Senati duke patur në përbërje 7 anëtar (1 Kryetari, 2 përfaqësues nga FSHL, 2 nga FVFR, 1 nga IKSHS dhe 1 përfaqësues i studentëve) dhe një ekspert i jashtëm.</p> <p>Qëllimi i NJSBC është arritja e objektivave strategjike në përputhje me vizionin dhe misionin e institucionit. NJSBC funksionon me bazë Rregulloren për Sigurimin e Cilësisë; legjislacionit në fuqi, si dhe rregulloreve të brendshme të UST dhe Statutit të UST.</p> <p>Nisur nga struktura dhe Rregullore për Sigurimin e Cilësisë, GVJ mendon se UST, përveç vlerësimit të brendshëm periodik, element tjetër i sigurimit të cilësisë është dhe prania e ekspertit të jashtëm si konsulent, po ashtu dhe vlerësimi i jashtëm i cili koordinohet nga ASCAL shërben për sigurimin të cilësisë, në lidhje me programin e studimit. Ky vlerësim kryhet nëpërmjet hartimit të raporteve të vlerësimit të brendshëm, dhe më pas nga GVJ me anë të RVJ, pasqyrohet gjendja aktuale dhe jepen rekomandime me qëllim përmirësim të përmbushjes së standardeve të cilësisë.</p> <p>Po ashtu UST është e hapur dhe shumë aktive për angazhimin e ekspertëve të jashtëm të cilët mund të japin ekspertizën dhe mendimet e tyre në bashkëpunim me strukturën e NJSBC-së, por edhe takime me partnerët kombëtarë dhe ndërkombëtare janë element që lidhen ngushtë me sigurimin e brendshëm të cilësisë.</p> <p><i>Ref. 48. Rregullore per Sigurimin e Cilesise;</i></p> <p><i>Vizita në institucion;</i></p>
<p>Konkluzione</p>	<p><i>GVJ pas shqyrtimit të RVB, dokumentave të ndryshme të vëna në dispozicion si guidës në institucion mendon se UST përfshin njësitë akademike, personelin akademik e studentët në proceset e NJSBC-së të programit të studimit dhe informon institucionin</i></p>




	në lidhje me rezultatet dhe masat e marra në vijim të tyre. GVJ mendon se ky standard përmbushet plotësisht.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X


Standardi VI.5

Politikat, proceset dhe veprimtaritë për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit, duhet të jenë publike, transparente dhe efektive, dhe të synojnë krijimin e Kulturës së Brendshme të Cilësisë.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Politika, strategjia, organizimi dhe veprimtaritë në kuadër të sistemit të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit janë transparente dhe bëhen publike për studentët dhe të gjithë të interesuarit.</p>	<p>GVJ konstatoi se aktiviteti, programi, rregullore të ndryshme të funksionimit të UST janë të aksesueshëm nga i gjithë stafi akademik, ndihmës-akademik dhe studentët si dhe çdo informacion në lidhje me politikat dhe praktikrat që lidhen me sigurimin e Cilësisë në UST. Këto të dhëna janë transparente dhe publike për të gjithë palët e interesuara. https://ust.edu.al/veprimtaria-dhe-aktivitetet-njesia-a-sigurimit-te-brendshem-te-cilesise/</p> <p>NJSBC-ja në bashkëpunim edhe me Zyrë e Këshillimit dhe Karrierës zhvillon sipas një planifikimi periodik, të përvitshëm, monitorimet në sektorët apo proceset që i nënshtrohen vlerësimit e që shoqërohen me raportet e detajuara vjetore dhe raportet përmbledhëse me gjetjet përkatëse dhe planin e masave dhe të rekomandimeve për përmirësim në vitet pasardhëse akademike.</p> <p><i>Ref. 48. Rregullore per Sigurimin e Cilesise;</i> <i>Vizita në institucion;</i></p> <p>https://ust.edu.al/veprimtaria-dhe-aktivitetet-njesia-a-sigurimit-te-brendshem-te-cilesise/</p>
<p>Kriteri 2. Institucioni i arsimit të lartë publikon rezultatet e vlerësimeve të programit të studimit, duke respektuar lirinë dhe etikën akademike, si dhe legjislacionin për të dhënat personale.</p>	<p>GVJ nga kontakti me përfaqësues të institucionit dhe shqyrtimi i dokumentacionit të dorëzuar prej UST konstaton se institucioni respekton lirinë dhe etikën akademike dhe po ashtu të dhënat personale. UST ka të miratuara rregullore të funksionimit të programeve si dhe për ruajtjen e të dhënave ku përcaktohet detyrimi për mbrojtjen e të dhënave. Në faqen web publikohen të gjitha politikat dhe praktikrat e sigurimit të cilësisë të cilat janë të aksesueshme për të gjithë. Në takim me drejtues të institucionit sic jemi shprehur dhe në standartet e mësipërme, GVJ u informuam se, NJSBC kryhen në mënyrë periodike shpërndarjen e pyetësorëve për të cilët është punuar</p>

	<p>edhe menduar që të jenë të personalizuar dhe të detajuar për secilën lëndë, modul dhe me emër mbiemër të lektorit përkatës. Ato shpërndahen në mënyrë elektronike anonime me link për secilin semester përpara fillimit të sezonit të provimeve. Informacioni i mbledhur i vihet në dispozicion drejtuesve të njësive bazë. Institucioni me qëllim respektimin e lirisë dhe etikës akademike, bazuar në legjislaconin në fuqi, kujdeset për ruajtjen e të dhënave personale garanton të drejtat njëkohësisht edhe detyrimet e palëve. Në çdo rast publikimet mbi rezultatet e vlerësimeve të programit të studimit monitorohen nga përfaqësuesi i Komisionerit për të dhënat personale.</p> <p><i>Politikat e privatesise – UST;</i></p> <p><i>Ref. 21. FSHR, BA, Model pyetësor i studenteve për të vlerësuar stafin;</i></p> <p><i>Ref. 53. Rregullore për mbrojtjen e të dhënave personale;</i></p> <p><i>Ref. 8. Rregullore e Universitetit të Sporteve, Këshilli i Etikës, Neni 13;</i></p> <p><i>Vizita në institucion;</i></p>
<p>Kriteri 3. Rezultatet e vlerësimit duhet të shoqërohen me një plan masash, që adresojnë dhe synojnë përmirësimin e mangësive e dobësive të evidentuara.</p>	<p>Analiza e raporteve vjetore të vlerësimit krahas konstatimeve që vihen re përcaktohet dhe plani për plotësimin e rekomandimeve dhe ndjekjen e udhëzimeve për veprimet e marra. GVJ, në raportin vjetor të vlerësimit vëren se masat, që synojnë përmirësimin e elementëve të evidentuara për rishikim, dokumentohen në formën e planeve të masave me qëllim përmirësimin e mangësive e dobësive të evidentuara sigurimin dhe përmirësimin e cilësisë. Në zbatim të rekomandimeve angazhohet stafi akademik dhe ai ndihmës akademik. Disa nga aktivitetet e realizuara nga UST, që GVJ konstatoi në takimin me stafin dhe dokumentat e vëna në dispozicion dhe që ne mendojmë se ndihmojnë për përmirësimin e cilësisë janë:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Pjesëmarrja dhe bashkëorganizim i aktiviteteve, konferencave shkencore me partnerë ndërkombëtarë; - Zhvillimin e trajnimeve të vazhdueshme kryesisht në aspektet didaktike të mësimdhënies dhe kërkimin shkencor; - Mbështetja e stafit akademik, studentëve në aktivitete të ndryshme kërkimore shkencore, projekte brenda dhe jashtë vendit duke ju mbuluar institucioni Fee -në e pjesmarrjes; - Leksionet e hapura nga ekspertë të fushës së rehabilitimit të realizuara në institucion; - Workshope të shumta me studentët e UST;

	<ul style="list-style-type: none"> - Seminaret e hapura mbi integrimin e gjithëpërfshirjen e personave me aftësi ndryshe (Bashkëpunimi me Shoqatën “Progetto Filippide” për angazhimin në sport dhe aktivitet fizik të fëmijëve që vuajnë nga Autizmi, ku një pjesë e stafit akademik të UST/FSHR ku u certifikuan dhe trainerë të fëmijëve që vuajnë nga Autizmi për më shumë se: 3 muaj të cilët janë studentët e FSHR); - Mbajtja e takimeve periodike orientuese dhe me diskutime të hapura për studentët (Orientim mbi praktikën profesionale, metodat e fizioterapisë nga staf akademik profesionist për rehabilitimin.); <p><i>Ref. 43. “Për pjesëmarrjen e UST si bashkëorganizator në Konferencën e 8-të Ndërkombëtare me Universitetin Shtetëror të Tetovës;</i></p> <p><i>Ref. 19.1. UST-Shoqata, Progetto Filippide);</i></p> <p><i>Vizita në institucion;</i></p>
<p>Kriteri 4. Institucioni vlerëson dhe siguron efektivitetin dhe ndikimin e veprimtarive në kuadër të monitorimit e vlerësimit të cilësisë në përmirësimin në vijim të cilësisë së programit të studimit.</p>	<p>GVJ konkludon në bazë të dokumentacionit të vënë në dispozicion nga institucioni se, UST vlerëson dhe përpaket për efektivitetin dhe impaktin e veprimtarive të ndryshme në UST, për monitorimin e cilësisë me qëllim përmirësimin e programit të studimit Bachelor në “Shkenca të Rehabilitimit”. Konkretisht, GVJ u informua në takimin me drejtues të institucionit se çdo vit realizohet analiza e punës mësimore e cila shoqërohet nëpërmjet “kontrollit të kryqëzuar” (cross-check) që implementohet nga struktura dhe aktorë të brendshëm në UST, duke filluar nga njësitë bazë nëpërmjet drejtuesit të departamentit, përgjegjësit të grup-lëndëve, koordinatorit të programit, të strukturat e sigurimit të brendshëm të cilësisë në nivel institucional, Zyra e Kurrikulave, Zyra e Standardeve dhe Cilësisë e Komisioni i Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë.</p> <p><i>Ref. 48. Rregullore per Sigurimin e Cilesise;</i></p> <p><i>Ref. 31.1. NJSBC. Plani vjetor 2021-2022;</i></p>
<p>Kriteri 5. Institucioni organizon veprimtari periodike me personelin dhe studentët për informimin dhe ndërgjegjësimin e tyre për sigurimin dhe përmirësimin afatgjatë të cilësisë së programit të studimit.</p>	<p>Institucioni i UST, siç GVJ është shprehur dhe në kriteret e mësipërme, në mënyrë periodike, vjetore apo semestrale, organizon veprimtarin informuese si për studentët ashtu edhe për personelin akademik në kuadër të rritjes së cilësisë në mësimdhënie, kërkimit shkencor, përmirësimin të programit të studimit, përmirësimin e infrastrukturës mësimore dhe në tërësi për të gjitha shërbimet e ofruara nga UST.</p> <p><i>Ref. 48. Rregullore per Sigurimin e Cilesise;</i></p> <p><i>Ref. 31.1. NJSBC. Plani vjetor 2021-2022;</i></p>

	<i>Vizita në institucion;</i>			
Konkluzione	<i>GVJ gjatë takimit me drejtues të UST konstatoi se UST organizon politika të ndryshme të vlerësimit, dhe veprimtari për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit, të cilat janë publike dhe transparente për të gjitha grupet e interesit. GVJ mendon se ky standard përmbushet plotësisht.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Na	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardevë të fushës VI	Na	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Përfundime të Vlerësimit të programit të studimit të ciklit të parë Bachelor në “Shkencat e Rehabilitimit (Fizioterapi)”

a. Pikat e forta dhe afirmime:

1. Mësimdhënia e mbështetur në metoda bashkëkohore dhe sistem e-learning në shërbim të studentëve dhe personelit akademik;
2. Personeli akademik cilësor i angazhuar në mësimdhënie ka grada e tituj, konform përcaktimeve ligjore, dhe përfaqësohet nga anëtarë me eksperiencë në mësimdhënie dhe përvojë profesionale në fusha të ndryshme të shkencave mjekësore;
3. Infrastruktura e laboratorëve të rehabilitimit me paisje rehabilituse të kohëve të fundit;
4. Marrëveshjet bashkëpunimi me institucionet shëndetësore për realizimin e praktikave pranë dy qendrave universitare spitalore më të mëdha dhe më të specializuara në vend, në poliklinika dhe klinikat private të fizioterapisë dhe rehabilitimit ku asistohen nga profesionistë të specializuar të fushës;
5. Marrëveshjet e me institucionet shëndetësore, qendra spitalore si brenda dhe jashtë vendit, ofrojnë mundësinë e trajnimit dhe kualifikimit të mëtejshëm dhe i bën ata të jenë të gatshëm për tregun e punës menjëherë pas diplomimit: Universitetin e Romës “Foro Italico” me të cilin po punohet që na bashkëpunim edhe me shoqatën “Progetto Filippide”, ku fokus kryesor do të jenë fëmijët me autizëm;

b. Pika të dobta:

Adresa: “Rruga e Durrësit”
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

Web site: www.ascal.al

E-mail: info@ascal.al

1. Mungesa e programit të diplomës "Bachelor" në "Shkenca të Rehabilitimit (Fizioterapi)" në listën e diplomave që "Urdhëri i Infermierit" njeh, për tu lejuar studentëve të diplomuar të kenë mundësi të fitojnë licencën e profesionit të rregulluar të fizioterapistit;
2. Mungesa e një plan veprimi mbi rezultatet e pyetësorit të vlerësimit të pedagogëve nga studentët; (*Standardi III.2, kriteri 4*)
3. Mungesa e mobilitetit të studentëve në kuadër të programeve Europiane në këtë program studimi; (*Standardi II.4, kriteri 4*)
4. Mungesa e një plani specifik edhe/ose udhëzuesi për përmirësimin e kompetencave didaktike të personelit akademik. (*Standardi III.1, kriteri 3*)


Rekomandime:

1. Rritje e mundësisë për tu përfshirë në projekte ndërkombëtare, për shkëmbim eksperience dhe zhvillim kapacitetesh në kuadër të bashkëpunimit me institucionet partnere ndërkombëtare rekomandojmë që përqindja e studentëve ose anëtarëve të stafit akademik pjesëmarrës në mobilitete të rritet;
2. Rritja e numrit të personelit ndihmës akademik;
3. GVJ rekomandon që të punohet që programi i diplomës "Bachelor" në "Shkenca të Rehabilitimit (Fizioterapi)" të jetë në listën e diplomave që "Urdhëri i Infermierit" njeh, për licensim të të diplomuarve;
4. Të bëhet përpjekje që maturantët që do aplikojnë për të vazhduar studimet në FSHR të kenë mesatare më të lartë;
5. Të punohet për të lidhur marrveshje bashkëpunimi me institucionet shëndetësore të kujdesit terciar dhe sekondar për të rritur cilësinë e zhvillimit të praktikave dhe përfitimet e studentëve;
6. Të punohet për ndërtimin e faqes zyrtare të Institucionit edhe në gjuhën angleze;
7. Të punohet më shumë me marketingun e kësaj diplome për plotësim të kuotave të propozuara;

Evaluation's conclusions for the first cycle study program Bachelor "Rehabilitation Sciences (Physiotherapy)"

a. Strengths and affirmations:

1. Teaching activities are carried on based on contemporary methods and an e-learning system is available for both students and academic staff;
2. The academic staff engaged in this study program is of high quality, has academic titles in accordance with legal obligations, and have experience in teaching in various fields of medical sciences;
3. Sufficient and temporary infrastructure/equipment of the laboratories;

4. Memorandum of understanding with health institutions for the implementation of internships including here the two largest and most specialized university hospital centers in the country, in polyclinics and private physiotherapy and rehabilitation clinics where students are assisted by specialized professionals in the field;
5. Memorandum of understanding with health institutions, hospital centers both inside and outside the country, offer the possibility of further training and qualification and makes them ready for the labor market immediately after graduation: the University of Rome "Foro Italico" with which we are working on cooperation with the "Progetto Filippide" association, where the focus is children with autism.

b. Weaknesses:

1. The absence of the "Bachelor" degree program in "Rehabilitation Sciences (Physiotherapy)" in the list of degrees that the "Nursing Association" recognizes, to allow graduate students to have the opportunity to obtain the license of the regulated profession of physiotherapist;
2. The lack of a specific action plan on the results of the questionnaire of evaluation of academic staff by the students;
3. The lack of student mobility in EU countries within European programs in this study program;
4. Lack of a specific plan and/or guide for improving the didactic competences of the academic staff.

Recommendation

1. Higher involvement in international projects, for the exchange of experience and capacity building within the framework of cooperation with international partner institutions. We strongly recommend that the percentage of students and/or members of the academic staff participating in mobility to increase;
2. Increasing the number of administrative staff is strongly recommended;
3. We recommend that the "Bachelor" degree program in "Rehabilitation Sciences (Physiotherapy)" as soon as possible to be included in the list of degrees that the "Nursing Association" recognizes, for the licensing of graduates;
4. More efforts are needed to increase the average marks of those enrolled in this study program;
5. Efforts are needed to establish agreements with secondary and tertiary healthcare institutions to increase the quality of internships and the student benefits;
6. Official website of the Institution to be available also in the English language;
7. Marketing of this study program in order to fulfill the proposed student quotas.



Shkalla e përmbushjes së standardeve të cilësisë së programit

FUSHAT E VLERËSIMIT	SHKALLA E PËRMBUSHJES SË STANDARDEVE TË FUSHËS			
		Përmbushen pjesërisht	Përmbushen kryesisht	Përmbushen plotësisht
I. OFRIMI, I PROGRAMIT TË STUDIMIT				X
II. ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMIT TË STUDIMIT TË CIKLIT TË PARË BACHELOR				X
III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT				X
IV. BURIMET NJERËZORE, FINANCIARE, INFRASTRUKTURA, LOGJISTIKA PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT				X
V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE				X
VI. SIGURIMI I CILËSISË SË PROGRAMIT TË STUDIMIT BACHELOR				X
VLERËSIMI TËRËSOR				X

